

Shqyrtimi i përbërësve gjinorë të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri

Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Shqipëri







Shqyrtimi i përbërësve gjinorë të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri

Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Shqipëri

Dhjetor 2020





Shënim

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës së Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Shqipëri dhe jo domosdoshmërisht paraqet opinionet e Qendrës Ndërkombëtare të Ekselencës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm-Hedayah apo opinionet e Bashkimit Evropian.

Mirënjohje

Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Shqipëri i shpreh mirënjohjen Qendrës Ndërkombëtare të Ekselencës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm-Hedayah për mbështetjen e vazhdueshme në hartimin e këtij raporti. Falenderojmë për mbështetjen Koordinatorin Kombëtar KEDH në Shqipëri, institucionet shtetërore, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës në nivel kombëtar e vendor për përvojat dhe opinionet e shprehura. Gjithashtu, falënderime të veçanta u shprehen dhe ekspertëve kryesorë në hartimin e këtij raporti (sipas rendit alfabetik): Aleka Papa, Elona Dhëmbo, Ergys Muzhaqi, Rudina Çollaku.

Konsulentë kryesorë:

Dr. Melinda Holmes
Dr. Dalina Jashari
Mrs. Irene Belmonte
Mr. Galen Lamphere - Englund

LISTA E SHKURTIMEVE

DRR - De-radikalizimit, Ri-integrimit dhe Rehabilitimit
EDH - Ektremizmi i dhunshëm
ODHE - Organizata të dhunshme ekstremiste
LEK - Vlera monetare Shqipëtare
PEDH - Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm
INSTAT - Instituti i Statistikave
OSHC - Organizata të Shoqërisë Civile
EDHRT- Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm
KMSH - Komuniteti Musliman Shqipëtar
KOASH - Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë



Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
PËRMBLEDHJE: REKOMANDIME	11
METODOLOGJIA	13
- Qëllimet kryesore dhe pyetjet kërkimore	13
- Kuadri teorik dhe hartimi i hulumtimit	13
- Metodat e kërkimit dhe mbledhja e të dhënave	14
- Intervistat	14
- Diskutime në fokus grupe (DFG)	15
- Sondazhi kombëtar	16
- Analiza e të dhënave	17
- Konsiderata etike	17
- Demografia e të anketuarve në sondazh	17
FAKTORËT UDHËHEQËS SPECIFIKË TË GRAVE NË EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM	19
- Gjetjet mbi faktorët në nivelin makro	19
- Pabarazia gjinore dhe patriarkalizmi si faktor kulturor	24
- Analiza e faktorëve në nivel mikro	27
- Individi dhe familja bërthamë	27
BESIMI FETAR DHE IDEOLOGJIA	29
- Indoktrinimi fetar ekstremist, si nxitësi kryesor i shkuarjes së grave shqiptare në Siri dhe Irak	29
DE-RADIKALIZIMI, RI-INTEGRIMI DHE REHABILITIMI I GRAVE NË SHQIPËRI, NDËRMJET FRIKËS DHE SHPRESËS	33
- Vështirësitë me të cilat gratë mund të përballen në kthimin e tyre dhe perceptime mbi rrezikun që mund të shfaqin ato në Shqipëri	35
- Rekomandime për përfshirjen e shoqërisë në DRR	41
ROLI I MEDIAS	43
QASJA INSTITUCIONALE	47
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	52
ANEKSI I	55
ANEKSI II	64
Pyetësor për gratë e kthyer	64
Lista e intervistave	67
Bibliografia	68
Lista e grafikëve	71



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë pesë viteve të fundit, parandalimi dhe kundërshtimi i ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDH) ka qenë një çështje prioritare në Shqipëri, e cila tashmë po adresohet nga një gamë e gjerë palësh të interesuara. Raporti i paraqitur, nxjerr përfundimin që këta aktorë pranojnë rëndësinë e rolit që gratë luajnë në parandalimin dhe kundërshtimin e EDH. Megjithatë, ende duhet punuar mbi të kuptuarit dhe të analizuarit e angazhimit të grave në ekstremizmin e dhunshëm (EDH) dhe rolet e tyre specifike në parandalimin dhe kundërshtimin e EDH. Në këtë konspekt, kur adresojmë EDH, është thelbësore që çështjet specifike të grave shqiptare të hulumtohen dhe të adresohen në mënyrë të duhur.

Si një nga tematikat e munguara në literaturën ekzistuese në Shqipëri mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, ky raport ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të tri çështjeve kryesore:

1. Faktorët që kanë shtyrë gratë shqiptare të largohen në Siri gjatë konfliktit të ISIS;
2. De-radikalizimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i grave në Shqipëri; dhe,
3. Roli i medias në raportimin e çështjeve të EDH së bashku me qasjet institucionale në lidhje me rolin e grave në P/KEDH në Shqipëri.

Në përgjithësi, analiza e paraqitur sugjeron që, ashtu sikurse edhe tek burrat, nuk ka një faktor të vetëm i cili ndikon në mënyrë të pavarur tek pjesëmarrja e grave shqiptare në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, porse ekziston një përzierje faktorësh, të ndarë në nivelin makro dhe mikro. Faktorët në nivelin makro, nën kategorinë e faktorëve socio-ekonomikë dhe politikë, përfshijnë nivele të larta marginalizimi shoqëror, të tilla si: zona të keq- qeverisura, shkelje e të drejtave të njeriut dhe të grave të tilla: si diskriminimi me baza fetare, dhuna në familje, diskriminimi me baza gjinore në vendin e punës dhe pabarazia gjinore. Këto, të kombinuara me nevoja të paplotësuara shoqërore dhe ekonomike dhe nivele të larta të korrupsionit, kanë rëndësinë e tyre në nxitjen e grave për të udhëtuar drejt zonave të luftës, por nuk mund të konsiderohen si thelbësore në angazhimin e këtyre grave në EDH.

Opinionin publik, aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë të intervistuar në këtë studim, nxjerrin në pah tre faktorë kryesorë që kanë nxitur gratë shqiptare të udhëtojnë drejt Sirisë dhe Irakut. Faktori i parë renditet: “bashkimi me burrat e tyre” (59.1% e të anketuarve), pasuar nga faktorë që lidhen me “mungesën e mundësive ekonomike” (52.6% të popullsisë së përgjithshme të anketuar) dhe faktorët ideologjikë (45.6% e të gjithë popullsisë së anketuar). Në analizën e faktorëve në nivelin makro, në këtë raport duket të jenë shqetësuese edhe çështje të tjera të larta në përqindje, të tilla si: papunësia e të rinjve, e cila zë nivelin më të lartë me 63.9%, e ndjekur nga nivele të larta të korrupsionit (53.7%) dhe pabarazia midis të pasurve dhe të varfërve (51.5%).

Përtej faktorëve “tradicionale” të nxitjes dhe tërheqjes që çojnë në EDH dhe mendimit të përgjithshëm se “ekstremizmi i dhunshëm i përket vetëm burrave”, është shumë e rëndësishme të kuptohen dhe adresohen faktorët specifikë gjinorë. Në fund të analizës, ky raport nxjerr në pah se faktorët mbizotërues specifikë që kanë nxitur gratë shqiptare të udhëtojnë drejt zonave të luftës përfshijnë:

- Normat patriarkale në shoqëri dhe në familje, veçanërisht në zonat rurale të vendit;
- Mungesa e pavarësisë ekonomike të grave dhe “varësia” ekonomike ndaj burrave;
- Arsye personale ngushtësisht të lidhura me ndjenjën e frikës për të ardhmen pas largimit



të bashkëshortëve të tyre. Ndjenja dhe emocione të lidhura me paragjykimet shoqërore dhe strukturën e martesës, pasi burrat e tyre kanë udhëtuar drejt Sirisë dhe gratë duhet të qëndrojnë afër burrave të tyre. Nën këtë kategori janë vërejtur nivele të larta të presionit dhe paragjykimet shoqëror, të cilat kanë bërë që disa gra të ndihen të përjashtuara nga shoqëria për shkak të praktikimit të fesë muslimane dhe veshjes së tyre; dhe,

- Mungesa e një komuniteti të konsoliduar të grave brenda komunitetit Musliman në Shqipëri, ç'ka ka bërë që gratë tu besojnë verbërisht interpretimeve fetare të bashkëshortëve të tyre - sërisht çështje e lidhur me mbizotërimin e normave patriarkale në vend.

Analiza në këtë raport nxjerr në pah se faktorët më të rëndësishëm që ka nxitur gratë shqiptare të udhëtojnë në Siri / Irak janë ato në nivelin personal, të ndërlidhur me normat tradicionale patriarkale të shoqërisë shqipëtare dhe të familjeve kryesisht në zonat rurale të vendit, si një çështje e kategorizuar tek faktorët kulturorë.

Nën nivelin personal (mikro), motivet individuale të grave shqiptare lidhen me perspektivën / strukturën e martesës së tyre, ku martesa shihet si qëllimi kryesor i një gruaje. Kjo është e lidhur ngushtë me normat patriarkale, veçanërisht në zonat rurale të vendit. Gjithashtu, nën këtë kontekst patriarkal, shumica e grave shqiptare që kanë udhëtuar në Shtetin Islamik kanë “legjitimuar” arsyet pse burrat e tyre u larguan “për të fituar para dhe për t’i siguruar familjes të ardhura më të mira për një jetesë më të mirë”.

Në analizën e faktorëve nxitës, një faktor i rëndësishëm është pabarazia gjinore (kryesisht e lidhur me pabarazinë në punësim, arsimim dhe pagesë) dhe dhunës në familje, të cilat, sipas literaturës ekzistuese, shpesh ndërlidhen për të mbështetur ekstremizmin e dhunshëm. 47.3% e burrave dhe 70.4% e grave të anketuara në këtë raport pohojnë se pabarazia midis burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare është e dukshme dhe nivelet e larta të dhunës ndaj grave, veçanërisht vitet e fundit, janë çështje shqetësuese që duhet të adresohen më shumë. Bazuar në literaturën ekzistuese dhe gjithashtu edhe në përvojat e shteteve të tjera, edhe për Shqipërinë, analiza tregon se ndërlidhja midis pabarazisë gjinore, dhunës në familje dhe ekstremizmit të dhunshëm, duhet të hulumtohet më tej. Në kontekstin e raportit të paraqitur, këto dy çështje janë të lidhura ngushtë me qëndrimet patriarkale, duke kontribuar kështu në pabarazitë gjinore në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe ekonomike dhe përhapjen e dhunës ndaj grave. Këto çështje mund të krijojnë efekte anësore socio-psikologjike të tilla si: tjetërsimi dhe përjashtimi, zemërimi dhe zhgënjimi, një ndjenjë e fortë e padrejtësisë, ndjenjat e poshtërimit dhe një ndjenjë viktimizimi e cila, kombinuar me faktorë të tjerë të përmendur më lart, i bën gratë të pambrojtura ndaj ideologjive të EDH.

Përveç normave patriarkale si faktor specifik i rëndësishëm për gratë e Shqipërisë, faktori ideologjik është gjithashtu mjaft dominues. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se ideologjia fetare dhe patriarkalizmi janë të lidhur fort me njëri-tjetrin për shkak të faktit se gratë u besojnë verbërisht interpretimeve të burrave të tyre. Prandaj, niveli i përgatitjes dhe i komunikimit të klerit është mjaft i rëndësishëm edhe në rastin e grave dhe vajzave besimtare. Në këtë kontekst, rëndësi të madhe merr rritja e rolit të grave brenda bashkësive fetare, si të fesë islame ashtu edhe të asaj ortodokse e katolike.

Analiza e faktorëve personalë që çuan gratë shqiptare drejt zonave të luftës sugjeron që bashkëveprimi i ngushtë familjar (prindërit, vjehrrat, motrat dhe vëllezërit) dhe anëtarët e familjes luajnë një rol vendimtar si gjatë parandalimit të EDH, ashtu edhe në De-Radikalizimin, Rehabilitimin dhe proceset e ri-integrimit (DRR). Nga informacionet e marra nga intervistat e të afërmeve dhe të njohurve të personave të larguar në Siri e Irak, pothuajse asnjë nga prindërit, motrat apo vëllezërit nuk kanë qenë në dijeni të faktit që meshkujt e familjes në fillim dhe bashkëshortet e tyre në vazhdim do të largoheshin për t’iu bashkuar Shtetit Islamik. Kontrolli ndaj radikalizmit si proces dhe roli i familjes bërthamë në ndalimin e këtij fenomeni janë çështje



të cilat së fundmi kanë filluar gjithashtu të jenë në vëmendje të aktorëve që trajtojnë ekstremizmin e dhunshëm; megjithatë, deri më tani në Shqipëri, nuk ka asnjë dëshmi të rasteve të familjeve që parandalojnë udhëtimin e fëmijëve të tyre në Siri / Irak.

Gjetjet e raportit sugjerojnë që adresimi i faktorëve nxitës që i çojnë gratë shqiptare drejt EDH kërkon një ndërhyrje të përbashkët nga një gamë e gjerë e palëve të interesuara si në nivel kombëtar ashtu dhe lokal. Në këtë drejtim, kontributi aktiv i aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë, veçanërisht në nivelin lokal, është një çështje themelore që do të ndihmojë përpjekjet e shtetit për të parandaluar më mirë dhe për të kundërshtuar EDH. Një qasje shumë-sektoriale duhet të përfshijë hartimin e programeve dhe aktiviteteve specifike për gratë, të tilla si: 1) programet e punësimit të grave, 2) aktivitete të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore, 3) aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve dhe që synojnë të rrisin rolin udhëheqës të grave brenda komuniteteve fetare, 4) aktivitete që synojnë të rrisin rezistencën e komunitetit për të parandaluar EDH, 5) përmirësimin e mbështetjes psiko-sociologjike për familjet dhe fëmijët në mjediset e shkollës dhe më gjerë.

Lidhur me temën e dytë kryesore të marrë në analizën tonë: De-radikalizimi, Rehabilitimi dhe Ri-integrimi shihen si çështje fillestare dhe të pa-hulumtuara për vendin. Të gjithë palët e interesuara në raportit theksojnë faktin që qeveria shqiptare duhet të ndërmarrë veprime konkrete për kthimin e grave dhe fëmijëve aktualisht në kampin e ISIS dhe DRR-në e tyre. Sidoqoftë, ky raport thekson disa nevoja dhe sfida që duhen adresuar shumë shpejt si: hartimi i strategjisë së DRR-së i udhëhequr nga një qasje shumë-aktoriale, rritja e njohurive dhe kapacitetet e institucioneve qendrore dhe vendore për mënyrën e adresimit të çështjeve të DRR-së për gratë dhe fëmijët. Nga ana tjetër, vetë komunitetet në të gjithë vendin “duhet të jenë të përgatitur” për qasjen ndaj grave dhe fëmijëve të kthyer. Në këtë drejtim, komunitetet vendore në Shqipëri në këtë moment kanë nivele të larta të frikës dhe paragjykimeve ndaj të kthyerve, siç edhe tregohet nga të dhënat e perceptimit të publikut në këtë raport ku 21.6% e të gjithë të anketuarve ndajnë mendimin se të kthyerit nuk janë të mirëpritur nga komunitetet e tyre lokale ku ata jetojnë, krahasuar me 18% të atyre që besojnë se ata do të mirëpritën. Për më tepër, 20% e popullsisë së anketuar i konsideron të kthyerit si një rrezik për sigurinë e komunitetit. Sidoqoftë, në të dy rastet, vërehet se ka përqindje të lartë (më shumë se 40%) të popullsisë së anketuar që nuk përgjigjen ndaj këtyre pyetjeve. Kjo, sipas organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të medias, ka të bëjë me mungesën e informacionit të komuniteteve për gratë dhe fëmijët e kthyer si dhe me mungesën e ndërgjegjësimit për DRR për të kthyerit.

Ky raport zbulon se niveli i lartë i paragjykimeve dhe frika e komunitetit janë të lidhura me mungesën e të kuptuarit të përvojave dhe rolit të grave dhe fëmijëve në kampe burgu, për ish-anëtarë të ISIS dhe në veçanti në kampin Al-Hol (një nga dy kampet në Siri ku ishin vendosur familjarë të luftëtarëve ose familjeve të luftëtarëve të huaj pas rënies së ISIS në 2019). Në këtë kamp aktualisht ka afërsisht 50 gra dhe fëmijë nga Shqipëria (Kasapi, 2020). Shumica dërrmuese e të intervistuarve, përfshirë përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, organizatat lokale të shoqërisë civile, përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe të anketuarit e anketës, i konsiderojnë gratë si “viktima” të burrave të tyre. Ata deklarojnë se këto gra kanë luajtur rolin e “shtëpiakeve” brenda kampit Al-Hol, duke mos qenë aktive as në rekrutime, as në kryerjen e akteve terroriste. Ky rol “shtëpiak” shpjegohet gjithashtu nga gazetarët shqiptarë të cilët kanë hyrë në kampin Al-Hol në vitin 2019. Nga informacioni i marrë brenda këtij kampi, gazetari Julian Kasapi argumenton se gratë shqiptare gjithmonë kanë dashur të ndahen sa më shumë që të jetë e mundur nga gratë e kombësive të tjera që ishin luftëtare dhe rekrutuese aktive, apo edhe të ishin sa më larg të jetë e mundur nga rreziqet e vetë kampit. Duke vepruar kështu, ato ishin të detyruar të lëviznin pak nga pak drejt skajit më të largët të kampit. Një ndarje e tillë ka qenë si një “mjet mbrojtjeje” për të mbajtur rolin familjar (Kasapi, 2020). Sidoqoftë, ky informacion nuk përbën një argument që këto gra të mos paraqesin rrezik gjatë kthimit të tyre në shoqëri ose se ato nuk janë radikalizuar.



Përkundrazi, shqyrtimi i së kaluarës dhe nivelit të tyre të përfshirjes / radikalizimit në kampet e ISIS mund të zvogëlojë frikën tek komunitetet, siç u përmend edhe më lart. Në këtë drejtim, një rol i rëndësishëm në informimin, ndërgjegjësimin dhe rritjen e qëndrueshmërisë së komunitetit duhet të behët nga media dhe organizatat e shoqërisë civile.

Gjetjet në hulumtimin e paraqitur theksojnë rëndësinë e një “qasjeje e gjithë shoqërisë” në PEDH duke u përqëndruar tek gratë. Një qasje e tillë duhet t’i konsiderojë gratë jo vetëm si një grup i ekspozuar ndaj EDH por edhe si agjente të ndryshimit brenda familjeve dhe komuniteteve vendore. Palët e interesuara të përfshira në këtë raport theksojnë rolin e një game të gjerë aktorësh shtetërorë dhe jo-shtetërorë dhe sugjerojnë që (përtej iniciativave të ndërmarra deri më tani në vend), ekziston nevoja për një koordinim dhe bashkëpunim afatgjatë dhe të qëndrueshëm midis të gjithë aktorëve. Për më tepër, vëmendja duhet t’i kushtohet monitorimit të progresit të këtyre ndërhyrjeve si mjeti kryesor për vazhdimësinë e përpjekjeve në parandalimin e EDH si dhe për të adresuar më mirë proceset e DRR.



PËRMBLEDHJE: REKOMANDIME

Eksperiencat dhe dëshmitë e mbledhura për qëllim të këtij raporti studimor, të parin në Shqipëri në adresimin e çështjeve gjinore për parandalimin dhe kundërshtimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, nxorren në pah një sërë rekomandimesh drejtuar institucioneve të ndryshme shtetërore dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë si më poshtë:

1. **Institucionet shtetërore të nivelit qendror**, përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare KEDH- nën koordinimin e Qendrës Rajonale KEDH, siç janë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes duhet të analizojnë dhe të vlerësojnë rolin e grave dhe vajzave në planet e tyre aktuale. Në këtë kuadër, dimensionin gjinor duhet të zërë vend të rëndësishëm duke trajtuar gratë jo vetëm si grup vulnerabël i shoqërisë ndaj fenomenit të EDH, por edhe si faktor ndryshimi. Për të bërë këtë, institucionet përkatëse duhet të marrin në analizë nevojat reale të grave dhe vajzave, faktorët udheheqës drejt EDH si dhe angazhimin konkret të tyre.
2. Edhe pse **arsimi** në vetvete nuk paraqitet si një nga faktorët që ka ndikuar mëvetësisht tek largimi i grave të Shqipërisë në zonat e luftës, institucionet e arsimit dhe institucioni përgjegjës në nivel qendror - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të vazhdojnë më tej trajnimet me stafet mësimore dhe prindërit, si punonjës të vijës të parë. Nga perspektiva gjinore, këto trajnime duhet të fokusohen në çështje si dhuna në familje, të drejtat e grave, barazia gjinore.
3. Nga ana tjetër, **komunitetet fetare** gjithashtu duhet të bëjnë një përpjekje për të forcuar rolin e grave brenda këtyre komuniteteve. Deri më tani, gratë kanë pasur një rol mbështetës ose dytësor në bashkësitë fetare. Në të njëjtën kohë, është veçanërisht e rëndësishme të trajnohen gratë klerike se si t'i qasen dhe riintegrohen në komunitetet përkatëse.
4. **Institucionet qendrore** duhet të fillojnë të marrin në konsideratë kthimin e grave dhe fëmijëve që ende ndodhen në Siri si dhe të hartojnë politika gjithëpërfshirëse për ri-integrimin dhe rehabilitimin e tyre.
5. **Institucionet në nivel qendror dhe vendor**, së bashku me komunitetet fetare duhet të angazhohen në hartimin e planeve të përbashkëta për adresimin e procesit të de-radikalizimit.
6. **Institucionet në nivel qendror e sidomos ato në nivel vendor, së bashku me aktorë të tjerë jo-shtetërorë** duhet të angazhohen në komunikimin me familjet e luftëtarëve të huaj dhe mbështetjen ndaj tyre. Trajtimi psikologjik i anëtarëve të familjes së grave të kthyera drejt prindërimit pozitiv mund të shihet si faktori kryesor në riintegrimin dhe përshtatjen e fëmijëve në shoqëri.
7. **Koordinatori Kombëtar KEDH**, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse dhe aktorë të shoqërisë civile duhet të nxisë ndërgjegjësimin e komuniteteve mbi rolin e grave në EDH dhe sidomos të rrisë informimin e tyre mbi DRR.
8. **Institucionet e qeverisjes vendore si dhe institucionet ligj-zbatuese** në nivel vendor rekomandohet se duhet të fokusohen në analizimin dhe hartimin e programeve specifike për kontekstet vendore përkatëse, duke bërë pjesë integrale të tyre nisma konkrete për gratë dhe vajzat e komuniteteve në DRR dhe parandalimin e EDH.
9. **Media**, si një nga aktorët kryesorë në ndërgjegjësimin dhe informimin e komunitetit duhet të angazhohet më tepër në promovimin e modeleve të suksesshme në shoqëri, përfshirë dhe gratë e rikthyera, me qëllim shmangien e paragjykimëve të larta ekzistuese në komunitetet vendore.



10. **Zgjerim i ndërhyrjeve në rang kombëtar**, jo vetëm në zona të caktuara si “zona të nxehta”, sidomos në zonat e thella rurale, aty ku izolimi i grave dhe vajzave është më i madh dhe strukturat patriarkale janë më të forta.
11. **Institucionet përkatëse dhe komuniteti i biznesit** duhet të promovojnë nisma punësimi për fuqizimin ekonomik të grave, veçanërisht duke u përqëndruar në nivelin lokal dhe zonat rurale.

Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që luajnë organizatat e shoqërisë civile me fokus çështjet gjinore, këto të fundut duhet të ndërtojnë kapacitete në metodat se si të ndërthurrin çështjet e grave në kuadrin e PEDH, me një fokus të veçantë në nivelin vendor. Sugjerohet gjithashtu që këto organizata, si dhe ato të tjera, duhet të zgjerojnë aktivitetet e tyre në të gjithë vendin (duke mos u përqëndruar në të ashtuquajturat zonat e nxehta) dhe duhet të angazhohen më shumë në monitorimin e nivelit të zbatimit të këtyre iniciativave.



METODOLOGJIA

Qëllimet kryesore dhe pyetjet kërkimore

Ky hulumtim është ndërmarrë me qëllimin shqyrtimin dhe të kuptuarit më të thellë të rolit të grave dhe përfshirjen e tyre në ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri si dhe në ofrimin e rekomandimeve drejtuar një sërë aktorësh në vend, të cilat mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave aktuale në PEDH si dhe në nxitjen e hartimit të hulumtimeve të mëtejshme mbi këtë çështje. Hulumtimi për qëllim të këtij raporti u bazua në dy objektiva specifike si më poshtë:

1. Të shqyrtojë dhe të kuptojë arsyet përse gratë në Shqipëri janë larguar drejt vendeve të luftës Siri e Irak; dhe,
2. Të identifikojë rekomandime të bazuara në përvoja me qëllim hartimin e programeve të duhura për angazhimin e grave në PEDH, si dhe programe e ndërhyrje nga ana e institucioneve shtetërore për të adresuar De-radikalizimin, Rehabilitimin dhe Ri-integrimin me fokus të veçantë tek gratë.

Për të përmbushur këto objektiva, pyetjet kryesore kërkimore ishin:

1. Cilët janë faktorët kryesorë (faktorët shtytës dhe tërheqës) që ndikojnë në rolet e grave shqiptare dhe përfshirjen e tyre në EDH?
2. Cilat programe mund të jenë më efektive për ri-integrimin dhe de-radikalizimin e grave që janë kthyer nga zonat e konfliktit?

Kuadri teorik dhe hartimi i hulumtimit

Në lidhje me të ashtuquajturit “faktorë të jashtëm” në nxitjen e EDH, është përdorur kuadri teorik i cili identifikon tre kategori të ndryshme: socio-ekonomik, politik dhe kulturor. Niveli i demokracisë së një vendi dhe niveli i zhvillimit socio-ekonomik të tij, në kombinim me faktorë individualë mund të krijojnë kontekste lehtësuese për grupe/individë të veçantë në shoqëri të cilët mund të bien pre e manipulimit nga ideologji ekstremiste (Vurmo. GJ, Sulstarova.E, 2018). Në këtë drejtim, në raportin e paraqitur është vlerësuar mjaft e rëndësishme që analiza të përqendrohet dhe gjithashtu në nivelin individual (në nivelin mikro).

Lidhja e faktorëve në nivelin mikro me ato në nivelin makro sugjerohet nga literatura të kryera sëfundmi të cilat sugjerojnë se: “faktorët e jashtëm ndikojnë tek individë i cili ka mjaft pakënaqësi, duke e bërë atë të ndjeshëm ndaj rekrutimit” (Holmer, G., Bauman, P., 2018). Për këtë qëllim, analiza e faktorëve nxitës e shtytës është e rëndësishme për të kuptuar më tej grupet / individët më të rrezikuar nga organizatat esktrmiste apo nga pjesëmarrja në aktivitete esktrmiste. Analiza e këtyre faktorëve ndihmon gjithashtu në realizimin e ndërhyrjeve të herëshme me përfshirjen e familjeve, komuniteteve vendore, institucioneve arsimore e të tjerë persona apo institucioneve pranë këtyre grupeve / individëve më të rrezikuar (Holmer, G., Bauman, P., 2018).

Përkundër këtij sfondi teorik dhe për të adresuar sa më mirë pyetjet kërkimore, grupi hulumtues u bazua në zbatimin e metodave kërkimore si cilësore ashtu edhe sasore.

Komponenti cilësor i përbërë nga rishikimi i literaturës, intervista gjysmë të strukturuar, diskutime në fokus grupe dhe intervista të thelluara me një grua të kthyer dhe të afërm të grave të tjera dhe burra luftëtarë të huaj, u përdor për të kuptuar rrugëtimin e mënyrën e përfshirjes sëgrave shqiptare dhe rolin e tyre përtej vendimeve të burrave të tyre për të udhëtuar drejt vendeve të luftës. Më tej, komponenti cilësor është përdorur gjithashtu për të kuptuar rolin e institucioneve



shtetëtores në PEDH dhe rolin e grave në ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme. Instrumentet e hulumtimit cilësor u përdorën gjithashtu dhe si një hap i parë i cili i dha udhë instrumentit sasior në këtë studim me në fokus popullatën e përgjithshme të Shqipërisë, të moshës +18. Objektivat e hulumtimit u fokusuan në faktorët kryesorë në nivelin makro dhe mikro, që influencuan rolin e grave dhe vajzave shqiptare dhe përfshirjen e tyre në EDH.

Komponenti sasior u përdor për të thelluar në shtytësit kryesorë duke analizuar pyetje më komplekse në lidhje me bashkëveprimin e faktorëve të ndryshëm socialë, politikë dhe ekonomikë. Me tej, gjetjet cilësore u integruan me rezultatet sasore nga sondazhi i perceptimit të publikut për të përshkruar një kornizë konceptuale të mekanizmave dhe rrugëve të radikalizimit.

Metodat e kërkimit dhe mbledhja e të dhënave

Sa i përket përbërësit cilësor të këtij studimi, metodat e mbledhjes së të dhënave të përdorura përfshinin intervista dhe diskutime në fokus grupe. Mbledhja e dëshmime mbështetej në një qasje sipas teknisë së “topit të dëborës” duke filluar me personat e identifikuar paraprakisht nga brenda rrjetit të Qendrës së Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Shqipëri, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse. Deri më tani, dëshmitë ose intervistat me gratë që kanë qenë në vendet e luftës kanë munguar në literaturën shqiptare mbi ekstremizmin e dhunshëm, për shkak të sfidave të kontaktimit të kësaj kategorie të grave. Prandaj, ky studim mundohet të plotësojë këtë boshllëk informacioni duke përfshirë dëshmitë e para të këtij lloji nga një grua e kthyer si dhe disa të afërm të grave dhe burrave të tjerë që aktualisht jetojnë në Siri.

Intervistat

Së pari, për të dokumentuar historinë e jetës së të kthyerve në Shqipëri si dhe për të krijuar një panoramë sa më të plotë të përjetimeve, botëkuptimit, eksperiencave të kategorisë së grave që kanë udhëtuar në Siri e Irak, u kryen në total 13 intervista të thelluara me një grua të rikthyer në Shqipëri, me gra dhe të afërm të të kthyerve meshkuj dhe familjeve të tyre. Instrumenti i intervistave të thelluara u bazua në praktikën e përdorur më herët mbi të njëjtën çështje nga Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe të përshtatura për kontekstin shqiptar (Jakupi, R., Kelmendi, V., 2017). Për këtë instrument u përdor korniza e kodifikimit të sjelljes, e njohur dhe si korniza e kodimit “ORBIT” (Alison, L., Alison, E., Noone, G., Elntib, S., Christiansen, P., 2013).

Së dyti, 15 intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të komuniteteve fetare (myslimane, ortodokse, katolike, bektashiane) si dhe gratë përfaqësuese të forumeve/ departamenteve të grave të këtyre komuniteteve.

Së treti, 15 intervista gjysmë të strukturuar u kryen me përfaqësuesit e institucioneve qeveritare në nivel kombëtar dhe vendor, të cilët, bazuar edhe në Strategjinë Kombëtare Shqiptare KEDH janë konsideruar si aktorë kryesorë për të adresuar çështjet e EDH. Këta aktorë përfshijnë: përfaqësues të institucioneve shtetërore përgjegjës për çështjet e sigurisë; institucionet shtetërore përgjegjëse për arsimin, çështjet sociale, ekonomike, institucionet / departamentet e qeverisjes vendore. Këto intervista synuan të mbledhin pikëpamjet e tyre mbi rolin e grave në ekstremizmin e dhunshëm dhe PEDH dhe të thellohen në mënyrën se si duhet adresuar roli i grave.



Më poshtë paraqiten të dhëna më të detajuara mbi intervistat e kryera:

Tabela 1. Lista e intervistave

Tipologjia popullsisë	Nr i intervistave	Lloji i intervistave	Data/periudha e intervistimit
Gra të kthyer	1	Intervistë e thelluar	Dhjetor 2019
Familje dhe të afërm të grave të kthyer	13	Intervistë e thelluar	Dhjetor 2019 - Mars 2020
Përfaqësues të komuniteteve fetare	15	Intervistë gjysmë-e strukturuar	Dhjetor 2019 - Mars 2020
Përfaqësues të institucioneve shtetërore përgjegjës për realizimin dhe zbatimin e politikave KEDH, agjencitë ligj-zbatuese, institucioneve shtetërore arsimore (mësues, përgjegjës për shkollën qendër komunitare ¹); përfaqësues të qeverisjes vendore, përfaqësues të këshillave bashkiakë, përgjegjës të departamenteve për ndihmën sociale dhe ekonomike në nivel vendor	15	Intervistë gjysmë-e strukturuar	Dhjetor 2019 - Mars 2020

Diskutime në fokus grupe (DFG)

Diskutimet në fokus grupe mbledhën afërsisht 75 përfaqësues nga komunitetet lokale të bashkive Shkodër, Bulqizë, Elbasan, Pogradec dhe Tiranë. Me qëllim krijimin e një kuadri sa më të plotëmbi rolin e grave në PEDH si dhe mbi faktorët kryesorë që mund të ndikojnë ose rrezikojnë përfshirjen e grave shqiptare në EDH, pjesëmarrësit përfaqësuan komunitetet lokale të njëjësive të ndryshme të qeverisjes vendore, drejtoritë / zyrat arsimore lokale / rajonale, agjencitë lokale të zbatimit të ligjit (komisariatet) si dhe përfaqësues të mediave lokale, mësues e prindër.

Tabela 2. Lista e diskutimeve në fokus grupe

Tipologjia e popullsisë	Nr i diskutimeve në fokus grupe	Vendndodhja	Nr i pjesëmarrësve meshkuj	Nr. i pjesëmarrësve femra	Nr total i pjesëmarrësve	Data/periudha e intervistimit
Aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë në nivel vendor	1	Pogradec	1	13	14	19 Janar 2020
Aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë në nivel vendor	1	Elbasan,	5	9	14	10 Janar 2020
Aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë në nivel vendor	1	Shkodër, Bulqizë	2	8	10	28 Dhjetor 2019
Aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë në nivel vendor	1	Tiranë	3	9	12	21 Shkurt 2020
Aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë në nivel vendor	1	Vlorë	9	6	15	24 Janar 2020
Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe aktivistë të shoqërisë civile	1	Tiranë	3	10	13	1 Shkurt 2020

1 "Shkolla si qendër komunitare" është një qasje dhe një model që po zbatohet në Shqipëri si një instrument që e bën shkollën një pjesë integrale të shoqërisë, rrit mundësitë e aktorëve lokalë për vendimmarrje të përbashkët dhe zhvillimin e komunitetit, respekt për diversitetin, dhe përdorimi i burimeve të komunitetit në rritjen e rezistencës së komunitetit (IDM, 2019).

Sondazhi kombëtar

Në kuadrin e këtij sondazhi u targetua popullsia e përgjithshme rezidente e Shqipërisë përmes një pyetësi të përbërë nga pesë seksione: të dhëna socio-demografike, besim fetar, perceptime mbi fenë, perceptime të përqendruara në pabarazi gjinore dhe diskriminim, dhe perceptime mbi ekstremizmin e dhunshëm.

Testimi paraprak (pilot) i studimit u krye për të përmirësuar instrumentin. Sondazhi u krye në popullatën e përgjithshme të qytetarëve, të moshës 18+, banorë të përhershëm ose shtetas të Shqipërisë. Kampionimi u bazua në të dhënat e fundit të regjistrimit të popullsisë CENSUS, I përditësuar me informacione administrative mbi popullsinë. Sipas të dhënave të INSTAT 2018, madhësia e popullsisë rezidente shqiptare ishte 2,870,324. Madhësia e kampionit për qëllim të këtij studimi përbëhej nga 1,000 të anketuar. Në një nivel besimi prej 95%, me një madhësi të popullsisë prej 2,870,324, intervali i besimit i vlerësimeve të kampionit ishte ± 3 . Nën mbulimin gjeografik të shpërndarjes së studimit:

Table 3 Shpërndarja e sondazhit

Rajoni	Bashkia	Total	Urban	Rural	Mashkull	Femër
Berat	Berat	25	16	9	13	12
	Kuçovë	15	7	8	7	8
	Ura Vajgurore	10	3	7	4	6
Dibër	Bulqizë	17	6	11	8	9
	Dibër	30	9	21	14	16
Durrës	Durrës	64	44	20	30	34
	Krujë	21	11	10	11	10
	Shijak	12	4	8	6	6
Elbasan	Cërrik	10	3	7	7	3
	Elbasan	57	31	26	27	30
	Librazhd	11	3	8	5	6
	Peqin	12	4	8	9	3
	Prrenjas	13	4	9	6	7
Fier	Divjakë	12	3	9	6	6
	Fier	51	21	30	24	27
	Lushnje	30	12	18	16	14
	Mallakastër	17	9	8	8	9
Gjirokastrë	Gjirokastrë	15	9	6	7	8
	Memaliaj	11	5	6	5	6
Korçë	Devoll	11	2	9	6	5
	Korçë	27	18	9	13	14
	Maliq	14	2	12	7	7
	Pogradec	23	9	14	10	13
Kukës	Kukës	17	7	10	9	8
	Tropojë	13	5	8	8	5
Lezhë	Kurbin	16	7	9	6	10
	Lezhë	23	7	16	7	16
	Mirditë	11	5	6	4	7
Shkodër	Malësi e Madhe	11	2	9	6	5
	Shkodër	52	29	23	27	25
	Vau i Dejës	11	3	8	6	5



Tiranë	Kamëz	38	25	13	17	21
	Kavajë	15	7	8	6	9
	Tiranë	212	176	36	105	107
	Vorë	12	7	5	8	4
Vlorë	Sarandë	11	7	4	6	5
	Selenicë	10	1	9	4	6
	Vlorë	40	27	13	18	22
Total		1000	550	450	486	514

Metoda e mbledhjes së të dhënave ishte intervistat ballë për ballë të realizuara nga ekipe i hulumtimit në terren, të cilët u trajnuan mbi mbledhjen e të dhënave në mënyrë profesionale dhe etike. Periudha e hulumtimit në terren ishte 4 dhjetor - 22 dhjetor 2019.

Analiza e të dhënave

Lidhur me të dhënat cilësore, intervistat dhe FGD-të u regjistruan dhe transkriptuan, duke ruajtur gjuhën origjinale duke ruajtur anonimin e të intervistuarve. Intervistat e transkriptuara u koduan dhe analizuan me programin kualitativ MAXqda, i krijuar për metoda cilësore të asistuar nga kompjuteri.


Të dhënat sasiore u analizuan duke përdorur SPSS, e kryer nga analiza univariante për të marrë një kuptim të përgjithshëm të pjesës shqyrtuar. Në të njëjtën kohë, u bë një analizë bivariate që përfshin ose varet nga dy ndryshore, në lidhje me gjininë dhe variablat e tjera për ta analizuar me dy variabla njëkohësisht.

Konsiderata etike


Ekipi i hulumtimit siguroi që studimi të hartohet në mënyrë etike duke marrë parasysh të pesë shtyllat e hulumtimit etik: pëlqimi i informuar dhe vullnetar, konfidencialiteti i informacionit të ndarë, anonimati i pjesëmarrësve në hulumtim, përfitimi ose mosdëmtimi i pjesëmarrësve, dhe reciprocitetit.

Demografia e të anketuarve në sondazh

Sikurse është përmendur më sipër, kampioni në këtë raport studimor ka karakter kombëtar dhe një rol të rëndësishëm i është dhënë raportit gjinor të të anketuarve, si në zonat rurale ashtu edhe ato urbane (*grafiku nr.1*). Konkretisht, të anketuarit në këtë studim janë 51.4 % femra dhe 48.6 % meshkuj, ku përqindjen më të madhe e zë grup-mosha 26-35 vjeç (26.6% meshkuj and 24.8 % femra), ndjekur më tej nga grup-mosha 18-25 vjeç (17.8% meshkuj dhe 23.4% femra), që grupmoshat e tjera paraqiten në nivelet 15% -18% (*grafiku nr.2*).




Graf. nr. 1




Graf. nr. 2

Sa i përket nivelit arsimor (grafiku nr 3.), pjesa më e madhe e të anketuarve paraqitet me shkollë të mesme (46.5% e tyre meshkuj dhe 32.9 % femra) dhe nivel i parë i studimeve universitare-bachelor (25.02 % e tyre femra dhe 18.2 %-meshkuj).



Graf. nr. 3

Nga pikëpamja fetare (grafiku nr 4), pjesa dërmuese e të anketuarve e konsiderojnë veten pjesë të besimit fetar mysliman (62.2 % meshkuj, 55.4% femra), ndjekur më tej me nivele më të ulta (mbi 10% e të anketuarve) të komunitetit ortodoks e katolik, ndërkohë që 10% e të anketuarve meshkuj dhe 8.2% e të anketuarve femra nuk e konsiderojnë veten pjesë të asnjë besimi fetar. Ndërkohë, për sa i përket praktikimit të besimit të tyre, 23.2% e të anketuarve meshkuj dhe 30.4% e grave të intervistuar janë praktikuese fetare. Kur u pyetën nëse ata ndajnë të njëjtin besim fetar si familja e tyre, mbi 90% e të anketuarve të anketuar të të dy gjinive pohuan se kanë të njëjtin besim fetar.



Graf. nr. 4



FAKTORËT UDHËHEQËS SPECIFIKË TË GRAVE NË EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM

Bazuar në literaturën ekzistuese për Shqipërinë, ekziston një mendim i përgjithshëm që EDH dhe terrorizmi janë çështje që u përkasin vetëm burrave. Sidoqoftë, të dhënat tregojnë se rreth 550 gra të vendeve perëndimore kanë udhëtuar në territorin e pushtuar nga ISIL / Daesh dhe që 17% e luftëtarëve të huaj evropianë janë gra (Orav, A., Shreeves, R., Radjenovic. A., 2018). Për më tepër, sipas Europol, një në katër persona të arrestuar në Europë për veprimtari terroriste në vitin 2016 ishte grua (Orav, A., Shreeves, R., Radjenovic. A., 2018). Gjithashtu, studimet e fundit theksojnë faktin se përfshirja e grave në organizatat ekstremiste dhe roli i tyre në vendet e konfliktit apo në situata të dhunshme janë shpesh më komplekse sesa supozohet (Eggert, 2018) dhe që gratë “mund të jenë njëherësh viktima, aktore të dhunshme dhe agjente të ndryshimit pozitiv” (Dufour-Genneson, S. Alam, M., 2014). Gratë mund të veprojnë si ndërtuese të paqes ndërmjet organizatave të grave, duke përdorur ndikimin e tyre në familje dhe komunitet për të vendosur zgjidhje unike për të mbështetur parandalimin, de-radikalizimin dhe rehabilitimin nga ekstremizmi (Dufour-Genneson, S. Alam, M., 2014). Nga ana tjetër, gratë nuk janë vetëm viktima të EDH. Ato mund të shërbejnë si mobilizuese dhe mbështetëse për organizatat terroriste, rekrutuesit, mbledhëse për fonde dhe madje edhe si realizuese të akteve terroriste (Bhulai, R., Peters, A., Nemr, C., 2016).

Përgjatë fazës së shqyrtimit të literaturës mbi faktorët “nxitës dhe shtytës të grave shqiptare në ekstremizmin e dhunshëm”, u vërejt se, ashtu sikurse dhe tek burrat, edhe për gratë e vajzat nuk ka një faktor të vetëm i cili ndikon tek procesi i radikalizimit të tyre dhe/apo pjesëmarrjes së tyre në grupe terroriste apo në udhëtimin e tyre në zonat e konfliktit Siri e Irak (Jakupi, R., Kelmendi, V., 2017). E njëjta dakortësi arrihet gjithashtu edhe ndërmjet studiuesve të fushës në Shqipëri. Bazuar në literaturën ekzistuese dhe analiza e informacioneve të marra nga një sërë aktorësh shtetërorë dhe jo-shtetërorë, intervistat e thelluara me gra të rikthyera nga Siria e Iraku dhe familjarë e të njohur të tyre, si dhe perceptimet e të anketuarve në anketën kombëtare për qëllim të këtij studimit, faktorët shtytës e nxitës janë kategorizuar në dy kategori kryesore të ndara përkatësisht në dy nivele: makro dhe mikro. Udhëhequr nga ndërveprimi i këtyre faktorëve dhe kompleksiteti i adresimit të tyre, nëpërmjet qasjes ndërvepruese të të gjithë aktorëve shtetërorë e jo-shtetërorë në nivel qendror e vendor (çështje të cilat shtjellohen në seksionin më tej në studim), faktorët udhëheqës të grave në ekstremizmin e dhunshëm në kontekstin shqiptar janë analizuar sipas dy shtyllave kryesore:


1. Faktorët në nivel makro, në të cilët përfshihet sistemi qeverisës, mirë-qeverisja, faktorë socio-ekonomikë, feja dhe besimi, dhuna ndaj grave, pabarazia gjinore dhe marginalizimi me bazë gjinore. Adresimi i këtyre faktorëve kërkon bashkërendim veprimesh ndërmjet institucioneve shtetërore në nivel qendror e vendor, me fokus të rëndësishëm në sjelljen dhe qendrueshmërinë e komuniteteve vendore.
2. Faktorët në nivel mikro, në të cilët përfshihen faktorë në nivel psiko-social e ideologjik, adresimi i të cilëve kërkon angazhim në nivel individual dhe mbështetje për familjet e kategorive të këtyre grave.

Gjetjet mbi faktorët në nivelin makro

Bazuar në dakortësinë akademike të deritanishme, në kategorinë e faktorëve makro përfshihen tre grupe kryesore të ndarë si *faktorë socio-ekonomikë, politikë dhe kulturorë*. Në brendësi të secilit prej këtyre faktorëve ndërveprojnë një sërë kushtesh si: ndërveprime të faktorëve socio-ekonomikë ku përfshihen

nivele të larta të marginalizimit shoqëror, zona të qeverisura keq/dobët, cënimi të drejtave të grave dhe njeriut, mungesa e përmbushjes së nevojave sociale dhe ekonomike; ndërveprime nën faktorë politikë ku përfshihen nivele të larta të korrupsionit, pandëshkueshmëria e elitave si dhe ndërveprime të faktorëve kulturorë ndër të cilët përfshihen ndikimi i klerit në komunitetet vendore dhe niveli i përgatitjes së klerit (Vurmo. GJ, Sulstarova.E, 2018). Këta faktorë, të ndërthurur me faktorë të tjerë në nivel personal (niveli mikro) mund të krijojnë “terrenin” e duhur për të krijuar persona/ grupe pesonash vulnerabël të cilët mund të jenë lehtësisht të manipulueshëm nga ideologji ekstremiste (Vurmo. GJ, Sulstarova.E, 2018). Analizimi i këtyre faktorëve si dhe identifikimi i faktorëve më specifikë për grate dhe vajzat është thelbësor, siç edhe theksohet nga ekspertët e fushës Holmes & Bauman në adresimin dhe hartimin më tej të ndërhyrjeve të duhura për familjet, komunitetet, dhe personave të tjerë që mund të jenë vulnerabël nga ky fenomen. (Holmer, G., Bauman, P., 2018)

Popullatës së anketuar në këtë studim iu parashtruan disa alternativa se cilat janë disa nga problemet më shqetësuese për Shqipërinë (grafiku nr.5). Sikurse dhe vërehet, të anketuarit listojnë tre çështje më problematike të cilat ata i shqetësojnë, ku, *papunësia e rinisë* zë përqindjen më të lartë me 63.9%² (64.2% meshkuj dhe 63.6% of femra), ndjekur nga *nivele të larta të korrupsionit* 53.7% e popullatës së anketuar (54.9% meshkuj dhe 52.5% femra) %) dhe më tej *pabarazia ndërmjet të pasurve dhe të varfërve* 51.5% e popullatës së anketuar (54.5% meshkuj and 48.6% femra).



Graf. nr. 5


Nga këndvështrimi gjinor, nuk ka asnjë ndryshim në përgjigjet midis të gjithë të anketuarve meshkuj dhe femra. Ndryshimet mund të shihen në lidhje me nivelin e lartë të korrupsionit, i cili renditet kryesisht si një çështje problematike midis të anketuarve në zonat urbane (58.7%), krahasuar me 47.6% të të anketuarve në zonat rurale. E lartë në përqindje (36.1%) paraqitet dhe situata e prania e krimit në vend, ashtu sikurse dhe “Rënia e vlerave morale të shoqërisë” (33.4%). Të dhënat e anketimit janë pasqyrim gjithashtu i situatës socio-ekonomike të popullatës shqiptare, sidomos të të rinjve shqiptarë, ku sipas të dhënave më të fundit të Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT), niveli i papunësisë tek grupmosha 15-29 vjeç është 21.4%(21.2% meshkuj e 21.5% femra) (De Bruijn, B., Filipi, Gj., Nesturi, M., Galanxhi, E., 2015), shifra këto që edhe pse e rendisin Shqipërinë në rend të parë ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për nivel të ulët papunësie ndërmjet të rinjve, përsëri shifrat e papunësisë mbeten dyfish më të larta se ato të vendeve të Bashkimit Evropian (World Bank Group, 2019) Gjithashtu papunësia dhe pasiguria për jetesën ka bërë që shumë të rinj gjatë viteve 2018 -2019 të largohen nga Shqipëria

2 Kjo është vlera mesatare



ku 40% e të rinjve duan të largohen nga vendi (Kamberi, G., Çela, A., 2019).

Situata ekonomike dhe polarizimi ekonomik zënë një peshë të rëndësishme në “shëndetin” e përgjithshëm të popullatës ashtu sikurse dhe në kuadër të çështjes së ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë kuadër, individët e përfshirë në EDH përgjatë viteve të fundit në vendet e Ballkanit Perëndimor (përfshirë dhe luftëtarët e huaj) kanë qenë më së shumti në situata të vështira ekonomike (Azinović, V, Storr. K, 2017). Edhe pse kushtet e vështira ekonomike mëvetësisht nuk mund të konsiderohet si faktor vendimtar për agazhimin në EDH, kur kombinohet me faktorë të tjerë si korrupsioni i lartë, mungesë e sigurisë dhe sistemit të drejtësisë, mund të shndërohet në një faktor të rëndësishëm për t’u shdrytëzuar nga grupet esktrmiste të cilët mund të ofrojnë rroga ose shërbime. Sidoqoftë nuk është varfëria që sjell mbështetje për VE por më tepër forma akute e përjashtimit social nga shteti dhe shoqëria (Vurmo, Gj., Sulstarova, E., 2018). Popullata e marrë në konsideratë në këtë anketim pohon se e ka të vështirë të përballojë jetesën me të ardhurat e tyre dhe në nivel përqindjeje, meshkujt dhe femrat e anketuara ndajnë pak a shumë të njëjtën problematikë sa i përket vështirësisë që ata kanë për të përballuar jetën, ku përqindja më e lartë gjendet tek niveli “shumë vështirë” dhe “vështirë” i paraqitur në *grafikun nr 6*.




Graf. nr. 6

Dhe në fakt, vështirësitë në përballimin e jetës lidhen ngushtë me shkallën e punësimit dhe të ardhurat mujore. Ndërmjet të anketuarve vërehet diferencë e lartë ndërmjet femrave “pa të ardhura” (31.6%) dhe 16.6% e meshkujve. Diferencë më e vogël vërehet ndërmjet meshkujve e femrave me të ardhura nën 23.000 lekë (21.4%- femra dhe 20.6%- meshkuj) ndërkohë kjo diferencë rritet në të ardhurat mbi 50.000 lekë në muaj. Nderkohë, kjo diferencë rritet për gratë dhe burrat që fitojnë mbi 50,000 lekë në muaj; kështu, ekziston një hendek i pagës gjinore me një përqindje më të lartë të burrave që marrin një pagë 50,000 lekë në krahasim me gratë.

Gjendja e vështirë ekonomike (e ndërthurur me faktorë të tjerë që trajtohen më tej në këtë raport studimor) përbën, për shumicën e të intervistuarve, të pjesëmarrësve në takimet diskutuese dhe për popullatën në anketim, një faktor të rëndësishëm në arsyet e largimit të grave shqiptare (kryesisht nga zonat rurale) në vendet e luftës apo në Shtetin Islamik. Siç është rasti i vajzës Besa³ (16 vjeçe) e martuar që në moshën 14 vjeçe e përballuar me gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale⁴.

³ Emri i përdorur nuk është emri i saj i vërtetë

⁴ Pjesëmarrësit në këtë diskutim në fokus grup ishin përfaqësues nga Bashkia e Pogradecit, mësues, nxënës të shkollave të mesme, përfaqësues të institucioneve të kujdesit shëndetësor, gazetarë, përfaqësues të komuniteteve fetare (Pogradec, 19 Janar 2020).



Pas largimit të bashkëshortit, gjendja e saj ekonomike rëndohet dhe për një periudhë të caktuar jeton në xhami pasi nuk kishte mundësi për pagimin e qerasë, derisa i bashkohet bashkëshortit te saj në Siri⁵.

Ndonëse është e vështirë të specifikohet që papunësia si një faktor i vetëm ka ndikuar në largimin e shqiptarëve në Siri dhe Irak, në kontekstin e çështjes së radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, papunësia përbën një burim të rëndësishëm nga individë apo grupe ekstremiste për të radikalizuar individë (meshkuj e femra), duke premtuar kështu një rrugë-zgjidhje drejt pasurimit dhe mundësive më të mëdha ekonomike, edhe pse në rrugë të jashtë-ligjshme.

Siç edhe raportohet nga intervistat me gruan e rikthyer edhe familjarë të të larguarve të tjerë, kryesisht familjet e këtyre grave kanë qenë në nivel mesatar jetese, me biznese të vogla, dhe jo në nivele të varfërisë⁶, ku pothuajse një pjesë e familjarëve të cilët i janë bashkangjitur djemëve të tyre luftëtarë kanë qenë në gjendje ekonomike mesatare dhe se shpenzimet e rrugës janë marrë prej tyre individualisht⁷. Një prej dëshmive të marra, tregon se personat e larguar dhe që aktualisht ndodhen në kampet e luftës (përfshirë dhe gra) “në fillim trajtoheshin mirë, u plotësoheshin kushtet minimale për jetesë dhe se buxheti ditor që shpenzohej për një familje arrinte qindra dollar në ditë⁸”. Janë pikërisht këto informacione që “joshin” kategorinë e personave të papunë, me vështirësi ekonomike dhe nga zona të thella rurale. Por në anën tjetër nga dëshmitë e marra sërish me familjarë që ende komunikojnë me pjesëtarët e mbetur të familjes, të cilët ndodhen në kampet e Al-holit, gjendja e tyre është e mjerueshme siç shprehet e intervistuar: “kohëve të fundit duan dëshpërimisht të kthehen, situatë është shumë e keqe dhe janë pa ngrënë...” duke pohuar se kërkojnë vazhdimisht ndihmë monetare.⁹

Nga ana tjetër, situatat e vështira ekonomike lidhen me nivelet e ulëta të punësimit të popullsisë; megjithatë, është e vështirë të thuash se papunësia është i vetmi faktor që ndikon tek shqiptarët për të udhëtuar në Siri dhe Irak. Në kontekstin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, papunësia përbën një burim thelbësor për individët ose grupet ekstremiste në radikalizimin e individëve (burra dhe gra) duke premtuar një zgjidhje për varfërinë e tyre dhe duke ofruar mundësi më fitim-prurëse ekonomike përmes mënyrave të paligjshme. Përfaqësuesit e shoqërisë civile në diskutimet me focus grupet deklarojnë se personat, veçanërisht ata nga zonat rurale, kanë qenë më “tërheqës” për rekrutuesit duke marrë parasysh situatat e tyre të vështira ekonomike. Niveli i lartë i korrupsionit është më i dukshëm në zonat rurale, i kombinuar me mungesën e arsimit të duhur fetar gjithashtu.¹⁰ Korrupsioni endemik është pjesë e grupit të nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm. Transparency International tregon se vendet me vlerësimin më të ulët në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (CPI) janë shpesh ato që përjetojnë konflikt ose luftë (UNDP, 2018). Po ashtu, Plani i Veprimit i Sekretarit të Përgjithshëm të KB për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm sugjeron që vendet që dështojnë të kontrollojnë korrupsionin (midis treguesve të tjerë si varfëria, papunësia, menaxhimi i diversitetit në përputhje me detyrimet e të drejtave të njeriut) priren të dëshmojnë për një numër më të konsiderueshëm të incidenteve të lidhura me ekstremizmin e dhunshëm (UNDP, 2018). Të anketuarit e sondazhit rendisin korrupsionin si një nga tre çështjet problematike që i shqetësojnë më shumë (shih grafikun nr. 5 më lart). I njëjti shqetësim në mesin e popullatës shqiptare është i dukshëm në sondazhin e opinionit, “Besimi në Qeverisjen 2019” ku shumica e qytetarëve shqiptarë e perceptojnë korrupsionin e vogël (87.5%)

5 Interviste me gjyshen e luftëtarit W, [16 Janar 2020]

6 Intervista me shoqen e gruas së rikthyer Mira, [5 Janar 2020]

7 Intervista me motrën dhe vajzen e familjes së luftëtarit Y [8 Nëntor 2019]


8 Intervista me motrën dhe vajzën e një luftëtari të vrarë, [8 Nëntor 2019]

9 Interviste me kumatën e luftëtarit Z, [1 Nëntor 2019].

10 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Vlorës si: Përfaqësues nga shkollat e mesme, mësues, studentë, OSHCE, përfaqësues nga qendrat e strehimit për jetimët, grupe rinore, dhe anëtarë të Këshillit të Sigurimit. [Vlorë, 24 janar 2020].


dhe korrupsionin e madh (85.2%) si një fenomen i përhapur ose shumë i përhapur në shoqërinë shqiptare. Për më tepër, i njëjti sondazh opinioni në vitin 2019 tregon se 15% e popullsisë shqiptare ka hasur personalisht korrupsionin qeveritar në nivelin qendror dhe 25.2% në nivelin lokal (Vrugtnan L, Bino, B, 2020).

Grafiku nr. 7 jep një përmbledhje të perceptimeve të të anketuarve mbi arsyet kryesore pse njerëzit (si gra ashtu edhe burra) janë larguar nga Shqipëria për t'u bashkuar me vendet ndërluftuese si Siria dhe Iraku. Ajo që vihet re është përqindja e lartë e të anketuarve që mendojnë se një nga arsyet kryesore janë “përfitimet financiare” nga (62.5% të anketuara femra dhe 59.7% të anketuarve meshkuj). Kjo përqindje pasohet nga një “mungesë e mundësive ekonomike” (58.0% e të anketuarve femra dhe 63.8% e të anketuarve meshkuj) dhe më pas “për besim ideologjik dhe fetar” (53.3% e të anketuarve femra dhe 54.7% e të anketuarve meshkuj).




Graf. nr. 7

Ndërkohë, sa i përket arsyeve përse *gratë* në Shqipëri janë larguar drejt vendeve të luftës Siri e Irak, perceptimet e publikut sa i përket kësaj çështjeje nuk tregojnë diferencë të madhe ndërmjet të anketuarve meshkuj e të anketuarve femra, por, siç vërehet nga figura nr.8, përqindjen më të lartë e ndër arsyet e renditura e zë “për të ndjekur bashkëshortin” (rreth 59.1% femra e 59.7% meshkuj), ndjekur më tej nga faktori ekonomik “mungesa e mundësive ekonomike dhe varfëria” (51.6% femra dhe 53.7% meshkuj) dhe faktori “Për përfitime ekonomike” (44.6% femra dhe 44.7% meshkuj).



Graf. nr. 8



Mbizotërimi i këtyre faktorëve nënvizohet gjithashtu edhe nga përfaqësues të shoqërisë civile të angazhuar në PEDH në Shqipëri, të cilët nga përvoja e tyre (me informacionin e pakët që zotërojnë lidhur me faktin se angazhimi i OSHC-ve në Shqipëri me personat e kthyer është ende shumë i vogël) tregojnë se shumica e grave shqiptare nuk kanë luajtur rol aktiv në Shtetin Islamik,¹¹ por kanë shkuar për të gjetur një jetë më të mirë, për t'i shpëtuar varfërisë ekstreme. Shumë prej tyre kanë menduar se do të gjejnë në vendet e luftës shtëpinë që nuk e kanë pasur dhe të drejtat që ata mendojnë se u janë mohuar (Ramkaj, 2019), apo do të mund të sigurojnë jetesë të mirë të fëmijëve, siç është rasti i gruas Moza¹², e cila shkoi pas bashkëshortit, për shkak të mungesës ekonomike për të rritur 3 fëmijë¹³.

Në të vërtetë dëshmitë tregojnë se vajzat dhe gratë shqiptare kanë qëndruar të izoluara nëpër shtëpi, në presionin e vazhdueshëm të grave me nën-shtetësi të huaja. “Në zonat e luftimit kishte mjaft gra jo-shqiptare të angazhuara. Kontaktet e tyre me familjen atje ishin të rralla për shkak të angazhimit në terren. Fëmijët nuk merrnin arsim normal por vetëm instruksione manipulative në qendra të përzgjedhura nga organizatat që u ishin bashkangjitur” (Gjinishi, 2020).

Edhe pse gratë përbëjnë prioritetet kryesore të disa politikave në Shqipëri (INSTAT, 2020) konteksti i dhënë më sipër, tregon edhe njëherë, se fuqizimi ekonomik i grave, pjesëmarrja e grave në forcën e punës, puna e papaguar në familje në zonat rurale, si dhe pozicioni i të rinjve dhe sidomos i vajzave në tregun e punës vazhdojnë të mbeten një sfidë në Shqipëri. Kjo gjë është është nënvizuar në “Raportin e Indeksit të Barazisë Gjinore për Shqipërinë 2020”. Në perspektivën e ekstremizmit të dhunshëm, ndërveprimi dhe adresimi i këtyre faktorëve është i rëndësishëm për ndërtimin e qëndrueshmërisë së grave dhe rritjen e rolit të tyre në ndërtimin e paqes dhe parandalimin e EDH (Coutur, 2014).

Pabarazia gjinore dhe patriarkalizmi si faktor kulturor

Parimi i barazisë gjinore dhe kundërshtia ndaj diskriminimit janë parime themelore të “Ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut”. Promovimi i barazisë gjinore është një përparësi dhe dakortësi e të gjitha vendeve anëtare të OSBE-së, të cilët angazhohen për promovimin e barazisë gjinore si pjesë përbërëse e politikave të secilit vend (OSCE, 2019). Edhe pse ekspertët dhe të dhënat në këtë studim sugjerojnë që gratë bashkohen njësoj si dhe burrat në lëvizjet ekstremiste për shkak të të njëjtëve faktorë socialë, ekonomikë dhe politikë, ekzistojnë disa shtytës të veçantë për gratë si: pabarazia dhe diskriminimi me bazë gjinore, dhuna kundër grave dhe mungesa e mundësive arsimore dhe ekonomike (Orav, A., Shreeves, R., Radjenovic. A., 2018).

Përtej “drejtuesve tradicionalë që çojnë në EDH”, analiza dhe lidhja e fortë midis pabarazisë gjinore dhe ekstremizmit të dhunshëm janë trajtuar nga Valerie Hudson dhe bashkautorët e saj në “Seksi dhe Paqja Botërore” të cilët thonë se parashikuesi më i mirë i paqes së një kombi nuk është niveli i tij i demokracisë apo pasurisë, por përkundrazi niveli i sigurisë fizike të grave (Hudson, Valerie M., Bonnie Ballif-Spanvill, Mary Caprioli, and Chad F. Emmett., 2012). Historikisht, gratë kanë bërë pjesë në kategorinë e grupeve të marginalizuara sa i përket aksesit në tregun e punës, mundësi të ulta në shkollim dhe nivele të ulëta pjesëmarrjeje në vendimmarrje. Përvoja e të jetuarit brenda një shoqërie që u mohon grave dhe vajzave të drejta të plota civile dhe mundësi ekonomike mund të bëjë që disa prej tyre të perceptojnë pjesëmarrjen në terrorizëm si një mënyrë për të fituar lirinë, emancipimin, respektin dhe barazinë. Shkelja e këtyre të drejtave mund të thellojnë ndjenjat e tjetërsimit, izolimit dhe përjashtimit që mund t'i bëjnë individët më të ndjeshëm ndaj radikalizmit (Orav, A., Shreeves, R., Radjenovic. A., 2018). Në kontekstin Shqiptar,


11 Fokus grup “Forumi I P/EDH” Tiranë (20 Shkurt 2020).

12 Ky emër përdoret për qëllim të këtij studimi.

13 Dëshmi e vjehrrës së gruas Y e cila ka humbur jetën në Siri (12 Janar 2020)

Indeksi i Përgjithshëm i Barazisë Gjinore për vitin 2017 shënoi 60.4 pikë, duke demonstruar një hendek gjinor të konsiderueshëm, 7 pikë më poshtë se mesatarja e BE-28 (67.4), me përjashtim të fushës së qeverisjes, ku Shqipëria ka nivele më të larta të barazisë gjinore sesa vendet e Bashkimit Evropian. Mangësitë më të mëdha në hendekun gjinor në Shqipëri hasen në fushat e njohurive, parasë dhe kohësë papaguar (INSTAT, 2020).

Pabarazia gjinore vërehet të jetë në nivele të larta edhe ndërmjet të anketuarve të këtij studimi, ku 47.3% e meshkujve dhe 70.4% e femrave pohojnë se në shoqërinë shqiptare ka pabarazi ndërmjet burrave e grave (grafiku.9.)




Graf. nr. 9

Nivele më të larta të pabarazisë gjinore sa i përket sidomos arsimimit vërehet në zonat rurale të vendit, ku ka më shumë meshkuj sesa femra me arsim të mesëm ose të lartë, kjo e lidhur dhe me faktorë si: mundësi e pakët arsimi parashkollor, frekuentim i ulët i shkollës së mesme dhe regjistrim më i ulët në shkolla profesionale. Vlerësimet e cilësisë (Censusi i Popullsisë dhe Banesave dhe studimi PISA) ngrenë shqetësime lidhur me përkeqësimin e sistemit arsimor në zonat rurale. Investimet e pakta në infrastrukturë dhe burime njerëzore, largësia nga zonat e banimit e institucioneve të Aftësimi të Formimit Profesional janë disa prej shkaqeve të kësaj situate të vështirë. Gjithashtu, shumë pak gra marrin pjesë në programe formuese, për shkak të kohës së pamjaftueshme dhe mënyrës së organizimit të programeve të formimit, të mbizotëruara nga meshkuj dhe pa planifikim të duhur për nxitjen e pjesëmarrjes së grave (Zhllima, E., Merkaj, E., Tahsini, I., Imami, D., Çela, E., 2016).

Nga një këndvështrim gjeografik, nuk ekziston një drejtues specifik ose një grup shkaqesh që ndikojnë ndryshe ndërmjet grave në vend të ndryshme të Ballkanit dhe vendeve evropiane. Sidoqoftë, disa nga nxitësit dhe tendencat e radikalizmit dhe pjesëmarrjes së grave në organizata terroriste / radikale janë të ekspozuara ndryshe në vendet e Ballkanit, krahasuar me vendet e tjera evropiane si Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar (Kelmendi, 2018). Kjo, për shkak të sfidave më të mëdha me të cilat ballafaqohen gratë në Ballkan për sa i përket dhunës në familje, niveleve të larta të diskriminimit në çështjet sociale-ekonomike dhe dominimit të shoqërive patriarkale (Kelmendi, 2018). Në kontekstin shqiptar, adresimi i dhunës në familje, mbrojtja e viktimave të dhunës në familje, garantimi i barazisë gjinore dhe ofrimi i shërbimeve minimale shëndetësore dhe sociale, veçanërisht në nivelin lokal është ende një sfidë (EC Albanian 2019 report, 2019), marrim shëmbull këtu faktin që vetëm në dy muajt e parë të vitit 2020 në Shqipëri janë vrarë nga bashkëshortët 5 gra (Tushi, 2020). Sipas të dhënave të siguruar nga INSTAT dhe sondazhi mbi dhunën kundër grave dhe Vajzave në vitin 2018, rezulton se 1 nga 2 ose 52.9% e grave midis moshave 18-74 vjet kanë përjetuar një ose më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës (dhuna intime e partnerit, takime me dhunë, dhuna nga dikush tjetër jo partneri,

ngacmimi seksual edhe / ose kërcënim) gjatë jetës së tyre (INSTAT, 2019). Për më tepër, sipas të njëjtit studim, qëndrimet tradicionale patriarkale mbeten të përhapura në të gjithë Shqipërinë dhe kontribuojnë në pabarazitë gjinore në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe ekonomike, si dhe në mbizotërimin e dhunës ndaj grave¹⁴. “Ligjitimitetin” e dhunës ndaj femrës, e vërejmë gjithashtu edhe ndërmjet të anketuarve në studim, ku siç vërehet nga grafiku nr.10, 7.6% e meshkujve dhe 3.5 % e femrave nga zonat rurale dakortësohen me faktin që dhuna ndaj grave është e justifikueshme në rrethana të caktuara.



Graf. nr. 10

Normat patriarkale, dominimi i figurës mashkullore në familjen shqiptare dhe “kontrolli” ndaj gruas vërehen se janë ndër faktorët më domethënës në largimin e grave shqiptare drejt zonave të luftës në Siri e Irak. Nga të dhënat e këtij raporti, identifikohet vetëm një rast kur gruaja ka qenë e dhunuar nga bashkëshorti dhe e detyruar që ta shoqërojë këtë të fundit për në Siri¹⁵ ndërkohë që shumica e të intervistuarve dhe dëshmitë e marra nga të afërm të grave dhe burrave që ende ndodhen në zonat e luftës, nuk mbështesin hipotezën që këto gra kanë qenë të forcuara për të ndjekur bashkëshortin, por e kanë ndjekur vullnetarisht për një jetë më mirë¹⁶, duke iu bashkangjitur bashkëshortëve për të qenë pranë tyre (edhe kur ata i kanë refuzuar për mos të udhëtuar drejt tyre) me ç’ka vërteton sidoqoftë dhe njëherë normat e thella patriarkale brenda familjes shqiptare, kryesisht në zonat rurale¹⁷ në bazë të “kudit familjar” (Kuko, 2020).

Megjithatë, edhe kur në një rast nëna ka refuzuar për t’iu bashkangjitur djalit luftëtar të larguar më parë, por vendimi i kryefamiljarit ka qenë dominues për t’iu bashkangjitur djalit duke marrë me vete bashkëshorten, dy vajzat e tjera dhe djalin, nxjerr ne pah se roli i mashkullit si kryefamiljar dhe përgjegjës mbështet faktorin patriarkal të shoqërisë¹⁸.

Faktori “patriarkal” mbështetet dhe nga të intervistuarit dhe pjesëmarrësit në takimet diskutuese nga zona të ndryshme të Shqipërisë, ku sipas tyre “Gratë shqiptare kanë ikur në vendet e luftës sepse nuk kanë dashur t’ia kthejnë fjalën bashkëshortit, i janë bindur atij, me apo jo bindje ideologjike,

14 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Tiranës si: mësues, punonjës socialë, psikologë, avokatë, anëtarë të Forumit Kombëtar të OShC-ve në PVE në Shqipëri. (Tiranë, 20 Shkurt 2020)

15 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Tiranës si: mësues, punonjës socialë, psikologë, avokatë, anëtarë të Forumit Kombëtar të OShC-ve në PVE në Shqipëri. (Tiranë, 20 shkurt 2020)

16 Intervista me shoqen e gruas së rikthyer X (5 Janar 2020)

17 Po aty

18 Intervista me motrën e luftëtarit Y të ndodhur momentalisht në Siri dhe njëkohëshit vajza e familjes (e cila ndodhet atje për t’i ndenjur pranë luftëtarit Y), (8 Nëntor 2019)



sidoqoftë nuk kanë ikur të luftojnë”¹⁹. Deklarata të tillë konfirmojnë kontekstin patriarkal që mbizotëron strukturën familjare në Shqipëri, ashtu sikurse dhe dëshmitë nga gratë e kthyer në vendet e tjera të Ballkanit ku normat patriarkale (veçanërisht ato në mesin e komunitetit mysliman) kanë luajtur një rol të rëndësishëm për pjesëmarrjen e tyre në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak (Kelmendi, 2018). Në këtë kontekst, studiuesit sugjerojnë që, në vendet me shumicë myslimane nga të cilat vijnë shumica e rekrutëve ISIL / Daesh, gratë mund ta shohin këtë si ofrimin e një lloji të lirisë nga traditat patriarkale dhe një shpëtim nga normat e tyre kufizuese kulturore (Kelmendi, 2018).

Në këtë kontekst patriarkal, shumica e grave shqiptare të shkuara në shtetin Islamik, kanë “legjitimuar” gjithashtu dhe arsyet e largimit të burrave të tyre “për të fituar para dhe për t’i siguruar familjes të ardhura më të mira për një jetesë më të mirë”. Pohimi “Detyra parësore e një bashkëshorti është të fitojë para” mbështetet gjithashtu në nivele të larta dhe nga 48.2% meshkuj e 45.7% e të anketuarve²⁰. Në këto kontekste të diferencimit të theksuar social e ekonomik ndërmjet meshkujve e femrave dhe “të drejtat” që këto të fundit gëzojnë në një kontekst patriarkal, kanë bërë që shumica e grave pasi bashkëshortët u ikën në vendet e luftës mbetën pa përkrahje ekonomike, por edhe familjare. Vetëm një pjesë u përkrahën nga prindërit, një pjesë ngelën tek familja e bashkëshortit me vjehrrin e vjehrrën, herë- herë pa përkrahje. Në këtë situatë ato gjetën si rrugëzgjdhje largimin e bashkimit me bashkëshortin, kudo ku ishte ai²¹.

Dëshmi të tilla, vërehen me kritikë nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile në vend, të cilët vënë theks tek nevoja për tu fokusuar tek roli i grave dhe vajzave, sidomos në zonat rurale, për edukimin e brezit të ri me konceptin e barazisë gjinore, thyerjen e stereotipeve gjinore dhe mbi të gjitha fuqizimin ekonomik dhe arsimimin profesional të grave dhe vajzave. “Ndërhyrje të tilla do të na ndihmojnë të mos ndodhin raste si një vajzë nga një familje e varfër, të cilën e martuan që në moshën 14 vjeçare, në moshën 16 vjeçare u largua për në Siri bashkë me fëmijën e vet për t’iu bashkuar bashkëshortit (i cili vdiq po aty) pasi nuk gjeti përkrahje nga familja e saj. Fatkeqësia e po kësaj vajze shtohet kur e detyruan të martohet sërish dhe të lindë një fëmijë tjetër”²².

Apo edhe rasti i një gruaje tjetër, e rikthyer tashmë, e cila dëshmon se “nuk ka dashur të qëndrojë atje, thjesht i ishte bindur bashkëshortit pasi ai e kishte siguruar se jetesa në Siri ishte e qetë dhe e mirë dhe se shumëshpejt gjendja do të normalizohej”²³.

Analiza e faktorëve në nivel mikro

Individi dhe familja bërthamë

Analiza në këtë raport studimor e faktorëve në nivelin mikro që kanë ndikuar në vendimin e grave shqiptare për t’iu bashkuar shtetit Islamik mbështetet kryesisht në dëshmitë e personave të afërm të grave që kanë shkuar në Siri e Irak, të dëshmisë së gruas së rikthyer si dhe dëshmi të përfaqësuesve të shoqërisë civile e institucioneve shtetërore bazuar në eksperiencat e tyre nga kontaktet me këtë kategori personash. Të dhënat janë ndërthurur gjithashtu dhe me perceptimet e të anketuarve në lidhje me këtë çështje.

Analiza në nivelin mikro është mjaft e rëndësishme dhe siç përshkruhet nga Dr. Alex P. Schmid, nën këtë faktorësh përfshihen: probleme me identitetin, mungesa e integritetit, ndjenja


19 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Vlorës si: Përfaqësues nga shkollat e mesme, mësues, studentë, OSHCE, përfaqësues nga qendrat e strehimit për jetimët, grupe rinore, dhe anëtarë të Këshillit të Sigurimit. (Vlorë, 24 Janar 2020).

20 Anketimi WCDCA 2020

21 Dëshmi nga të afërm të grave të larguara dhe aktualisht në kampet në Siri e Irak

22 Pjesëmarrësit në këtë diskutim në fokus grup ishin përfaqësues nga bashkia e Pogradecit, mësues, nxënës të shkollave të mesme, përfaqësues të institucioneve të kujdesit shëndetësor, gazetarë, përfaqësues të komuniteteve fetare, (Pogradec, 19 janar 2020)

23 Intervistë me gruan e rikthyer Mira (nuk është emri i saj i vërtetë [28 Tetor 2019])



të përjashtimit, marginalizimit, diskriminimit, turpërimit, paragjykitimit dhe të tjera ndjenja të lidhura me moralin (Schmid, 2013).

Nën këtë kategori faktorësh mikro, identifikojmë se gratë shqiptare janë udhëhequr nga motive emocionale dhe perspektiva /struktura e martesës së tyre, e cila është ngushtësisht e lidhur me normat patriarkale dhe pa-barazinë gjinore të shtjelluar në seksionin më sipër. Pothuajse të gjithë dëshmitë në këtë studim e trajtojnë gruan si “viktimë” të bashkëshortëve të tyre dhe të gjendjes ekonomike të rënduar, në pamundësi për të rritur e edukuar fëmijët të vetme, disa prej tyre të gënjerë nga burrat mbi situatën reale në Siri, siç dëshmon gruaja Mira: “Bashkëshorti është larguar 3-4 muaj përpara nesh. Ai më ftoi të shkoj atje duke më thënë se situata ishte e mirë dhe qetë. Nuk i tregova askujt se po ikja, as fëmijët nuk e dinin. Ata mendonin se po iknim në Angli”²⁴. E njëjta dëshmi vjen dhe nga familjarë të një rasti tjetër të cilët theksojnë se “Bashkëshortja jo vetëm që nuk ka patur rol tek vendimi i të shoqit për tu larguar, por thjesht ka ndjekur burrin. Respektoi vendimin e tij se ashtu i takonte”²⁵.

Nën këtë analizë të motiveve personale të grave shqiptare që janë larguar në vendet e luftës, rol të rëndësishëm vërejmë që merr familja bërthamë dhe ndërveprimi i anëtarëve të familjes. Nga informacionet e marra nga intervistat e të afërmeve dhe të njohurve të personave të larguar në Siri e Irak, pothuajse asnjë nga prindërit, motrat apo vëllezërit nuk kanë qenë në dijeni të faktit që meshkujt e familjes në fillim dhe bashkëshortet e tyre në vazhdim do të largoheshin për t’iu bashkuar Shtetit Islamik. Siç është rasti i gruas së rikthyer Mira, familja e së cilës mendonte se ajo po shkonte bashkë me fëmijët tek bashkëshorti i emigruar në Angli. Fakti që Mira kishte shkuar në Siri ishte zbuluar rastësisht nga vëllai i saj një ditë kur Mira kishte aktivizuar vend-ndodhjen në celular. Dëshmitë e marra në këtë raport tregojnë se momenti kur familjarët kanë kuptuar që fëmijët e tyre kanë qenë në Siri ka qenë shokues. Rasti i Mirës mund të konsiderohet rast pozitiv duke qenë se familja e saj arriti ta kthejë në Shqipëri sëbashku me fëmijët. Por jo të njëjtën mundësi e fat kanë pasur e kanë familjarë të tjerë të cilët ende kërkojnë ndihmë nga institucionet shtetërore për tu kthyer fëmijët e nipërit në Shqipëri²⁶. Përtej mungesës së informacionit nga ana e familjarëve mbi këtë fenomen, dhe në brendësi të familjes vërehet sërish forma tradicionale dhe patriarkale e organizimit të familjes, ku djemtë, tashmë të rritur, duhet të jenë ata që duhet t’i dalin për zot jo vetëm gruas dhe fëmijëve, duke krijuar kështu shkëputje të mbështetjes (qoftë edhe morale) të fëmijëve ndaj prindërve, madje në disa raste duke shtuar përgjegjësinë dhe “presionin” e të rinjve meshkuj “për t’i dalë zot dhe prindërve”. Dhe nën këtë mendësi, meshkujt e larguar në vendet e luftës kanë mundur lehtësisht të “gënjejnë” familjet e tyre duke i bërë të besojnë se ata janë duke emigruar drejt vendeve të Evropës Perëndimore, si Anglia, Greqia, Gjermania apo për studime në vendet e Lindjes së Mesme. Kontrolli ndaj radikalizimit si proces dhe roli i familjes bërthamë në ndalimin e këtij fenomeni janë çështje të cilat së fundmi kanë filluar gjithashtu të jenë në vëmendje të aktorëve që trajtojnë ekstremizmin e dhunshëm. Sidoqoftë, deri më tani në Shqipëri, nuk ka asnjë provë të rasteve të familjeve që parandalojnë udhëtimin e fëmijëve të tyre drejt Sirisë ose Irakut.

Nga vështrimet tona për qëllim të këtij studimi, personat (meshkuj e femra) vijnë nga familje me tradita tradicionale të familjes shqiptare sa i përket respektit dhe rolit të burrit në familje si shtylla e familjes, ndërkohë që, të intervistuarit në studim nënvizojnë faktin se struktura e familjes shqiptare që prej viteve 90’ka ndryshuar dhe gjithmonë e më tepër po hasin çështje të cilat çenojnë “qëndrueshmërinë” e saj, për shkak të problemeve socio-ekonomike me të cilat familjet hasen sidomos në zonat rurale, për shkak të uljes së vlerave morale në shoqëri nga të rinjtë dhe mungesa e theksuar perkundrejt prindërve nga ana e fëmijëve (Ramkaj, 2019). Rënia e vlerave morale në shoqëri renditet gjithashtu si një nga çështjet më problematike edhe nga 32.1% e të anketuarve meshkuj dhe 24.6% e të anketuarve femra në anketën e këtij raporti. (Shiko grafikun 5 më lart).

24 Dëshmi e gruas së rikthyer Mira, nuk është emri i saj i vërtetë. [28 Tetor 2019]

25 Dëshmi e familjarëve të Mirës [1 Dhjetor 2019]

26 Intervistë me kumatën e një gruaje e cila ka shkuar në Siri sëbashku me bashkëshortin dhe dy fëmijët. Dy bashkëshortët mendohet se janë vrarë në Siri, ndërkohë që dy fëmijët mendohet se janë ende në kamp në Siri.



BESIMI FETAR DHE IDEOLOGJIA

Indoktrinimi fetar ekstremist, si nxitësi kryesor i shkuarjes së grave shqiptare në Siri dhe Irak


Në analizën e faktorëve që kanë ndikuar në largimin e grave shqiptare në Siri e Irak, faktori ideologjik, përveç atij patriarkal, është mjaft dominant. Mungesa e informacionit të duhur fetar dhe keqinterpretimet fetare rreth Islamit janë mbështetur në Shqipëri si “një dorë e padukshme” nga ndikime të huaja, të cilat kanë nxitur ekstremizmin në vend. (Vurmo, GJ, 2018)

Mbi konceptin e termit të “ideologjisë” nuk ka një përcaktim rigoroz apo të plotë, megjithatë ajo mund të përcaktohet si një sistem idesh e pikëpamjesh politike, filozofike, juridike, estetike, morale e fetare, të cilat shprehin interesat, qëndrimin e kërkesave të një klase, të një grupi shoqëror, të një partie, të një sistemi politiko-shoqëror etj., si pjesë e super-strukturës dhe që pasqyrojnë në fund të fundit, marrëdhëniet ekonomike (Burrowes, 2016). Sidoqoftë, feja dhe ideologjia janë dy terma që shpesh ngatërrohen për shkak të afërsisë në kuptimet dhe konceptet e tyre. Karl Mannheim pretendon se teoritë, normat, besimet, etj, “degenerojnë” në ideologji, kur ato e ndalojnë njeriun të merret me vetveten në një fazë historike të caktuar (Baehr, 2013). Ndërsa Geertz e thekson kontekstin politik dhe kulturor të ideologjizimit të fesë kur i referohet Islamit (Slyomovics, 2012). Karakteristikat kryesore të këtij konteksti janë diskursi i traditave fetare, prishja e konsensusit tradicional, rritja e dyshimit dhe humbja e orientimit të cilat vijnë si pasojë e përhapjes së sekularizmit modern (Norman, 2007). Shqipëria, si vendi më i egër i diktaturës komuniste, e shpalli veten si “I pari vend ateist në botë” më 1976, ku besimi dhe praktikat fetare u ndaluan me Kushtetutë (Bezati, 2019). Padyshim që periudha e mbylljes totale gjatë sistemit komunist ndikoi tek feja dhe tek komunitetet tradicionale, duke krijuar një vakum të madh si nga ana e literaturës (asgjësimi i qindra bibliotekave), te mungesa e mësuesve fetarë e teologëve (mbyllja e shkollave fetare), te pamundësia financiare, mungesa e të ardhurave, e deri te pronat e vakëfeve që akoma ishin të shtetëzuara, të zaptuara apo edhe të tjetërsuara. Në vitet '88-'89 u dhanë shenjat e para të një lehtësimi në trajtimin e feve në Shqipëri, të manifestuara me lejimin e disa klerikëve me origjinë shqiptare që të vizitojnë Shqipërinë, siç është rasti i vizitës së shenjtore Nënë Tereza (Clayer, 2007). Këtu zë fill një nga dallimet kryesore nga pikëpamja organizative midis komuniteteve fetare, e cila mund të thuhet se është një përcaktues i rëndësishëm në mënyrën se si u menaxhuan më pas sfidat e ndryshme.

Në ndryshim nga Kisha Autoqefale Orthodhokse Shqiptare (KOASH) dhe Kisha Katolike, Komuniteti Musliman Shqiptar (KMSH), si një prej komuniteteve më të mëdha fetare në vend, u gjend përballë vështirësive si: mungesa e klerikëve, teologëve dhe fondeve, të cilat filloi t'i plotësojë duke kërkuar ndihma nga vendetë ndryshme si; Libi, Egjipt, Jordani, Siri, Jemen, Arabi Saudite, Katar, Kuvajt, Turqi, e deri në Malajzinë e largët. Shumë shpejt, termat “Wahhabi”, “Salafi”, “radikal”, “fondamentalist”, “terrorist” filluan të përdoren sikur të ishin e njëjta gjë, ndërkohë që shumë pak vëmendje u tregua për të kuptuar menjëherë rrymat e ndryshme që kishin hyrë në vend (Zaimi, 2017).

Radikalizmi fetar, nuk ishte një dukuri “sui generis” që u shfaq në Shqipëri befasisht në vitin 2013, por ai ka qarkulluar ndër vite në Shqipëri, i cili më vonë u gërshetua edhe me rikthimin në vend të disa studentëve me bindje ekstremiste, të cilët krijuan një frymë të radikalizimit fetar në vend (Ramkaj, 2019). Pas kthimit në Shqipëri, disa nga klerikët e studiuar jashtë filluan të mos binin dakord me praktikimin e traditës Islame në vend, por filluan të propagandonin rryma salafiste e wahabiste, nuk pranuan që të ishin nën mbikeqyrjen e KMSH, si dhe filluan të merrnin fonde nga burime të dyshimta (Vrugtman, 2018).

Për më tepër, vakumi dhe padurimi për t'iu afruar fesë në mesin e popullatës krijoi hapësirë të mjaftueshme për sekte të tjera fetare (shpesh radikale) për të hyrë në komunitete duke përdorur mjete të ndryshme, të tilla si aktivitete sportive për të rinjtë, kurse të gjuhëve të huaja, dhe kampe verore për fëmijë apo edhe ndihma ekonomike për familjet me të ardhura të ulëta (Kursani, 2015). Radikalizmi fetar në Shqipëri u nxit më shumë nga Lufta e Irakut në vitin 2003, që krijoi një ndjenjë armiqësie ndaj Perëndimit tek disa të rinj besimtarë dhe krijoi terren që disa imamë dhe të vetëshpallur përmes ligjëratave ekstremiste në xhamitë që drejtonin, të radikalizonin shumë ndjekës. Ata promovuan idenë e “Islami nën rrethim”, duke nxitur perceptimin se Perëndimi po sulmon jo vende të caktuara, por vetë Islamin dhe myslimanët (Hide, 2017). Prania e rrymave radikale, apo dhe e personave apo grupeve të caktuara që nxisin rryma ekstremiste vazhdon të jetë një “kërcënim” për komunitetet vendore në Shqipëri. Siç edhe vërehet nga grafiku nr.11, 17.4% e të anketuarve dakortësojnë se “numri i individëve dhe/apo grupeve radikale në Shqipëri është në rritje”, dhe pohojnë më tepër praninë e individëve me prirje ekstreme, sesa grupe të tilla.



Graf. nr. 11

Prirjet ekstreme në këtë kontekst, jo domosdoshmërisht janë të lidhura me besimet fetare, edhe pse deri më tani në Shqipëri, fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm ka qenë i lidhur me bazë fetare. Forma të ndryshme të ekstremizmit në Shqipëri si, narrativa populiste, radikale e politike (Vurmo, Gj., Sulstarova, E., 2018) janë ende çështje që kërkojnë më tepër hulumtim. Format e ndryshme të shfaqjes së ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri janë ende çështje që kërkojnë më tepër hulumtim, megjithatë, në parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm,



nuk duhet mënjanuar roli i fesë dhe i klerëve të besimeve fetare, qasje e cila mbështetet gjithashtu edhe nga Kombet e Bashkuara (UNIATF, 2018) në kuadër të Agjendës 2030, e cila nënvizon rolin e fesë dhe të liderave fetare në parandalimin e këtij fenomeni.

Eksperienca e deritanishme në Shqipëri dhe dëshmitë e përfutuara mbi personat burra e gra të larguar në vendet e luftës Siri e Irak, rikonfirmojnë që “faktori fetar” për shkak të manipulimit fetar, vlligjërimi kultik i deformuar, mungesa e referencave të sakta fetare, ndikimi i rrjeteve sociale dhe joshja nëpërmjet propaganda, mungesa e orientimit nga institucioni fetar bazuar në doktrinë, influenca e paqartësia mbi atë çka ndodhte në Siri, kanë qenë dominantë (Gjinishi, 2020), siç është rasti i cili u diskutua në takimin që u zhvillua në Tiranë me përfaqësues të shoqërisë civile. Një djalë i ri (rreth të 30-ave) i cili gëzonte pozicion të lartë në punë dhe brenda tre muajsh kishte ndryshuar sjellje e kishte ikur në Siri, apo dhe rasti i një familjeje shkodrane në Austri, shumë mirë ekonomisht²⁷.

Nga ana tjetër, përfaqësues të komuniteteve fetare dhe ekspertët e intervistuar në këtë raport theksojnë se padija fetare çon dhe në rritjen e paragjytimeve brenda për brenda të njëjtit komunitet fetar, ashtu edhe ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare. Këto paragjykime janë më të dukshme në komunitetet e zonave rurale, si komunitete të vogla ku lidhjet ndërmjet njëri-tjetrit dhe traditat janë më të forta²⁸. Ky paragjykim, ka bërë që pothuajse të gjithë gratë e larguara në Siri e Irak të mos u tregojnë të vërtetën të afërmeve të tyre, por të gënjëjnë duke thënë që po shkojnë në emigrim në Angli tek bashkëshortët²⁹. Në analizën e bërë nga të intervistuarit raportohet se paragjykimi dhe faktorët socialë si: diskriminimi, trysnia dhe përjashtimi për shkak të praktikimit të fesë dhe ritualeve që lidhen me kodin e veshjes, kanë qenë një faktorë ndikues duke krijuar trysni në shumicën dërmuese të grave/familjeve që i janë bashkuar ISIS. Ky është për shembull rasti i bashkëshortes e cila vendos të largohet së bashku me familjen e saj nga fshati ku jetonte (fshat me pak popullsi muslimane) për shkak të diskriminimit të lartë nga komuniteti. Disa forma diskriminimi përfshijnë mungesë mundësish për punësim, mungesë mbështetje për integrim shoqëror, jo vetëm nga komuniteti por edhe brenda familjes së burrit të saj. E thënë kjo, në zona të caktuara në vendit, sidomos në zonat e thella rurale, fe të ndryshme po mundohen t’i qasen të rinjve me mënyra bashkëkohore apo dhe me joshje si në para ashtu edhe në ofrimin e kurseve të gjuhëve të huaja, ose nëpërmjet qëndrimit sa më afër të klerit të zonës tek besimtarët. Në takimin diskutues në qytetin e Pogradecit, pjesë të të cilit ishin gjithashtu dhe mësues e psikologë, u theksuar dhe se “Atë që nuk po bën dot shkolla, shoqëria, institucionet, po e bën feja”. Në këtë kontekst, grupet e synuara janë besimtarët e rinj për shkak të mungesës së duhur të formimit fetar, individë që banojnë në zona rurale për arsye të edukimit të pakët dhe kushteve socio-ekonomike, frekuentues të rrjeteve sociale ku përçohen këto ide.³⁰

Roli i komunikimit të klerit është mjaft i rëndësishëm edhe në rastin e vajzave dhe grave besimtare. Por në këtë kontekst, rëndësi të madhe merr rritja e rolit të grave brenda për brenda komuniteteve fetare, si të fesë islame, ashtu edhe të asaj ortodokse e katolike. “Kisha katolike në shumë aspekte është maskiliste. E mira është që të hapet, pra gratë duhet të marrin role të rëndësishme dhe përgjegjësi në organizimin e aktiviteteve të ndryshme në adresimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe në atë të informimit fetar e të bashkëpunimit ndër-fetar. Në këtë mënyrë, vetë gratë do të mund të fitojnë më shumë vetë-besim e do të jenë më aktive” (Valente,

27 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Tiranës si: gazetarë, studentë universitarë, profesorë universitarë, studiues dhe ekspertë të VE. Tiranë, (1 shkurt 2020).

28 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Vlorës si: përfaqësues të shkollës së mesme, mësues, studentë, OSHC, përfaqësues nga strehimoret, grupe rinore, anëtarë të Këshillit të Sigurimit, Vlorë, (24 janar 2020).

29 Intervistë me gruan e kthyer Mira (28 tetor 2019).

30 Pjesëmarrësit në këtë diskutim në fokus grup ishin përfaqësues nga bashkia e Pogradecit, mësues, nxënës të shkollave të mesme, përfaqësues të institucioneve të kujdesit shëndetësor, gazetarë, përfaqësues të komunitetit fetar, Pogradec, (19 janar 2020).



2019). Të njëjtin mendim mbi rolin e grave brenda komunitetit e ndajnë dhe përfaqësuesit e komunitetit musliman, të cilët teksojnë se sektorët e gruas pranë KMSH duhet të jenë më të pranishme në nivel vendor, me qëllim ndërmarrjen e nismave të përbashkëta me organizata të shoqërisë civile, sidomos ato që kanë fokus gratë (Brucaj, 2020).

Si përfundim, Shqipëria, pas rënies së sistemit komunist ka kaluar në një periudhë të gjatë tranzicioni përgjatë tre dekadave e shoqëruar me destabilitet politik, ekonomik dhe kulturor, me një qeverisje të brishtë ku krimi i organizuar, trafikimi i qenieve njerëzore dhe i lëndëve narkotike por edhe fenomene të tjerë negativë dhe faktorë të tjerë psiko-socialë kanë prodhuar akte të ndryshme dhune si brenda por edhe jashtë vendit ku shqiptarët kanë qenë pjesë e krimeve të ndryshme apo rrjeteve kriminale (Azinović, V, Storr, K, 2017). Shfaqja e ekstremizmit të dhunshëm që çon në “terrorizëm” shumë vende i gjeti të papërgatitura me përballjen e këtij fenomeni. Lufta në Siri prej mëse një dekade u bë një vatrë dhe virus për të gjithë botën. Vala e nxehtë e largimit të luftëtarëve të huaj drejt Sirisë nga Shqipëria përkon me periudhën 2010 -2013, periudhë kjo në të cilën organizata e ISIS-it ishte ende e panjohur. Faktorët politikë, socio-ekonomikë, të gërshtuar me faktorin ideologjik, thirrjet e hapura për mbështetjen e popullit sirian i cili ishte në luftë civile, ndikuan / u përdorën për të rekrutuar luftëtarë të huaj burra/ gra. Faktorët që kanë nxitur individë të udhëtojnë drejt zonave të konfliktit janë të ndryshëm, të diktuara gjithashtu dhe nga konteksti vendor. Analiza e këtyre faktorëve konkretisht për gratë shqiptare, nxjerr në pah se këta faktorë, po ashtu edhe roli i grave të larguaradroit vendeve të konfliktit ndryshon si brenda rajonit por edhe më tej. Ndryshe nga gratë e tjera rekrutuese dhe pjesëmarrëse në luftë, roli i grave shqiptare ka qenë pasiv dhe “rekrutimi” i tyre ka ndodhur brenda kontekstit familjar, kryesisht i ndikuar nga bashkëshortët e tyre.

Faktorët mbizotërues në këtë analizë përfshijnë normat patriarkale të cillat jannë ende mbizotëruese në shoqëri dhe familje, kryesisht në zonat rurale të vendit, mungesa e pavarësisë ekonomike të grave dhe si pasojë, “varësia” e tyre nga burrat e tyre, ose arsyet personale që lidhen me ndjenjat, emocionet, struktura e martesës e cila fillon me atë që quhet aleanca martesore e shoqërisë tradicionale shqiptare dhe ideologjisë fetare. Ata varen shumë nga burrat e tyre dhe ndjekin vendimet e tyre ose ‘u binden vendimeve të tyre pavarësisht nga kushtet. (Doja, 2018) Idealizmi që karakterizon jo vetëm gratë, por edhe burrat për një jetë më të mirë si nga ana ekonomike dhe ideologjike bëri të mundur që luftëtarët meshkuj të pasoheshin nga gratë e tyre apo edhe prindërit e tyre. Përsëri, ky fakt nxjerr në pah modelin tradicional të familjes shqiptare dhe të qenit të bashkuar dhe të gatshëm për të luftuar për idealet e njëri-tjetrit. Një e intervistuar (motra e një luftëtari të huaj mashkull) deklaroi se kunata e saj u bashkua në luftë dhe ndoqi burrin e saj së bashku me prindërit e tij (nënë dhe vjehrrin) dhe dy fëmijët. Gruaja e luftëtarit është vrarë dhe prindërit me dy fëmijë kanë mbetur në kampet kurde³¹. E fundit por jo nga rëndësia është presioni dhe paragjyrimi shoqëror, i cili ka ndikuar tek disa grave duke i bërë të ndihen të përjashtuara nga shoqëria për shkak të fesë dhe veshjes së tyre fetare³².

31 Intervistë me motrën e një luftëtari të huaj të vrarë në Siri, (8 Nëntor 2019)

32 Kjo deklaratë theksohet nga pothuajse të gjitha intervistat me të afërmit e grave të kthyer dhe të luftëtarëve të huaj.




DE-RADIKALIZIMI, RI-INTEGRIMI DHE REHABILITIMI I GRAVE NË SHQIPËRI, NDËRMJET FRIKËS DHE SHPRESËS

De-radikalizimi, Rehabilitimi dhe Ri-integrimi (DRR) janë çështje po aq sfiduese dhe komplekse sa edhe parandalimi dhe kundërshtimi i ekstremizmit të dhunshëm, ndaj të cilave qeveritë e vendeve kanë filluar t'i përkushtohen gjithmonë e më shumë të ashtuquajturve “luftëtarë të huaj” apo dhe të rikthyerve nga zonat e luftës, Siria e Iraku. Qysh prej vitit 2015 Forumi Global Kundër Terrorizmit solli në vëmendje nevojën që qeveritë dhe komunitetet duhet të kenë në vlerësimin e rrezikut nga personat e radikalizuar, luftëtarët e huaj dhe në kënd-vështrimin afatgjatë mbi rehabilitimin e ri-integrimit të tyre në shoqëri, pjesë apo jo e sistemit të drejtësisë (GCTF, 2015-2016).

Termi “de-radikalizim” nuk ka ende një përkufizim të saktë dhe një dakortësi akademike, ashtu sikurse dhe termit e “radikalizimit” dhe “ekstremizmit të dhunshëm”. Gjerësisht, “de-radikalizimi” është pranuar si një proces në të cilin refuzohet ideologjia e një grupi ekstremist, ashtu sikurse Dr Alex P. Schmid e përkufizon këtë term si një “ndryshim i mendjes”, me të cilin i referohet refuzimit konjitiv të vlerave, sjelljeve dhe pikëpamjeve të caktuara (Schmid, 2013). Gjithashtu John Horgan e përcakton de-radikalizimin si “Proces social e psikologjik ku, angazhimi, përfshirja e një individi në sjelljet e dhunshme ekstreme është ulur deri në atë masë sa nuk ka më rrezik për ri-përfshirje dhe ri-angazhim në akte ekstremiste” (Horgan, 2008). Nga ana tjetër, vlen të theksohet dhe dallimi e ndryshimi ndërmjet termave të “de-radikalizimit” dhe “shkëputjes” (Horgan, J., Braddock, K., 2012). Pra, “shkëputja” i referohet ndalimit të kryerjes së një veprimi ndërkohë që një person i ashtuquajtur “radikal” mund të ndalojë së kryeri një veprim të dhunshëm ekstrem apo pjesëmarrjen e tij në grupe terroriste, pa vënë në dyshim apo pa u penduar për pikëpamjet radikale (Bertram, 2015). Gjithashtu, “shkëputja” mund të sjellë ndryshime të mëdha në sjelljet shoqërore e konjitive, siç mund të jenë norma shoqërore, vlera, sjellje dhe aspirata të cilat ndaheshin më përpara ndërmjet anëtarëve të të njëjtit grup ndërkohë që de-radikalizimi shkon përtej “shkëputjes” (Horgan, 2008). Ndërkohë që shtetet përgatiten për të adresuar De-radikalizimin, Rehabilitim dhe Ri-integrimit të personave që kanë qenë në zonat e luftës, Bertram argumenton se nuk ka një plan pune standard i cili mund të adresojë këto çështje, por ka një sërë modelesh të cilat mund të përshtaten në kontekste të caktuara dhe mbi të gjitha në individë të caktuar (Bertram, 2015), duke shtuar më tej se në kuadër të programeve individuale të de-radikalizimit, këto të fundit duhet të bazohen në perspektivat e personave, besimet dhe motivet e tyre për t'iu bashkuar një grupi terrorist apo një lloj ideologjieje ekstremiste. Si e tillë, një iniciativë e suksesshme de-radikalizimi duhet të jetë një udhëtim i cili kalon në të njëjtat trajektore në të cilat ka kaluar dhe procesi i radikalizimit.

Me gjithë sfidën dhe kompleksitetin që karakterizon DRR, përsëri gratë kanë mbetur akoma shumë pas e deri më tani, shumica e programeve të de-radikalizimit janë hartuar për burra, dhe ka pasur pak përpjekje për të krijuar programe që adresojnë në mënyrë specifike nevojat e grave të kthyer (Turkington, R., Christien, A., 2018).

Shqipëria është në fazën e hershme të vlerësimit të kërcënimeve të mundshme që mund të sjellin luftëtarët e huaj, ashtu sikurse dhe në hartimin e programeve DRR. Shtuni bën dallimin midis rrezikut dhe kërcënimit që luftëtarët e huaj mund të paraqesin dhe shprehet se “jo të gjithë të kthyerit dhe ata që do të kthehen nga Siria dhe Iraku paraqesin rreziqe të mundshme të sigurisë shoqërore dhe kombëtare” (Shtuni, 2019). Analiza e të kthyerve është thelbësore për hartimin e programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit të luftëtarëve të huaj. Edhe në këtë rast, fenomenet janë komplekse,



për shkak të kompleksitetit të profileve dhe arsyeve pse luftëtarët e huaj kthehen në vendet e tyre të lindjes (Shtuni, 2019). Shtuni thekson se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet grave të kthyer shqiptare, të cilat nuk janë përfshirë në mënyrë aktive në luftime, por ato mund të mbështesin ideologji të caktuara dhe mund të rekrutojnë dhe mobilizojnë të tjerët për t'u bashkuar me organizatat terroriste. Në këtë rast, një rrezik i mundshëm është i lidhur ngushtë me indoktrinimin e fëmijëve. Për më tepër, disa individë kthehen nga zonat e konfliktit me trauma dhe probleme psikologjike dhe nëse nuk diagnostikohen, ata mund të paraqesin një rrezik shoqëror jo domosdoshmërisht të lidhur me terrorizmin (Shtuni, 2019). Një tjetër rrezik i mundshëm që mund të vijë nga mos-hartimi ose hartimi jo i plotë i programeve të DRR është se këta persona mund të kërkojnë të rishkojnë në vendet e luftës apo të kërkojnë tu bashkangjiten sërish grupeve apo ideologjive ekstremiste, kjo për shkak të zhgënjimit që mund të përjetojnë nga mënjanimi shoqëror dhe nga ai shtetit (Tare, 2020). Bazuar në motivet e kthimit të këtyre grave, mund të përcaktohet dhe roli i rëndësishëm që ato do të kenë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duke u bërë modele pozitive, ashtu sikurse dhe mund të ketë gra të cilat mund të kthehen me ideologji ekstremiste e do të mundohen ta përhapin atë³³. Gjithashtu, ri-integrimi jo i duhur mund të forcojë frikën dhe paragjykimin në komunitet, duke nxitur ideologji ekstremiste dhe ri-radikalizim.³⁴

Në Ballkanin Perëndimor, të dhënat ekzistuese tregojnë se kanë udhëtuar në Siri e Irak rreth 190 gra, nga të cilat ka të dhëna që janë kthyer vetëm 17 prej tyre (nga Bosnja, Kosova dhe Mali i Zi) (ICAN, 2019) dhe në krahasim me mesataren evropiane (rreth 35%), gratë dhe fëmijët (jo-luftëtarë) përbëjnë pjesën dërmuese (deri në 55 për qind) të njerëzve të Ballkanit Perëndimor që udhëtuan drejt Sirisë dhe Irakut (UNODC, 2019). Mangësia e të dhënave të sakta mbi numrin e grave të shkuara në zonat e luftës dhe atyre të rikthyer përbën një sfidë si për shoqërinë, ashtu edhe për aktorët shtetërorë e jo-shtetërorë, të cilët duhet të jenë në vijë të parë për hartimin dhe zbatimin e programeve DRR. Konkretisht për Shqipërinë, të dhënat publike tregojnë për rreth 44 gra e fëmijë të kanë udhëtuar në Siri e Irak. Të dhëna jo-zyrtare tregojnë se janë 5 gra që janë kthyer në Shqipëri në periudhën ndërmjet viteve 2013-2014, 5 gra të tjera kanë humbur jetën dhe aktualisht në kampin Al-hol janë rreth 17 gra cilat duan të rikthehen (Kasapi, 2020).

Nga analiza cilësore në këtë studim, e kryer bazuar në dëshmitë dhe intervistat me persona të angazhuar në këtë çështje, tregojnë se arsyeja përse gratë nga Shqipëria duan të kthehen është kryesisht e lidhur me zhgënjimin mbi realitetin që ato kanë gjetur në Siri (tërësisht ndryshe nga ai çfarë u ishte premtuar) ose sepse kanë humbur njerëzit e tyre atje dhe janë detyruar të kthehen ose thjesht kanë qenë me fat që janë kthyer (Hide, 2019). Gjithashtu, zhgënjimi që ato kanë përjetuar shoqërohet me ndjenjë të theksuar pendimi (Gjinishi, 2020). Njëkohësisht, ato kanë përjetuar gjendje të rënduar psikologjike, ndihen fajtores dhe nuk kanë dëshirë të flasin rreth kohës që kanë kaluar në kampet në Siri, siç edhe dëshmon bashkëshorti i gruas së rikthyer Mira: “Unë nuk dëshiroj ta pyes gruan për të kaluarën në Siri, jo vetëm në respektim të figurës së saj, integritetit dhe personalitetit të saj, por edhe sepse nuk dëshiron të flasë rreth asaj periudhe”³⁵.

Dëshmia e grave të Shqipërisë që aktualisht ndodhen në kampi Al-Hol tregon se ato janë tërësisht viktimat në shkuarjen dhe qëndrimin atje dhe kanë një thirrje dëshpëruese për shtetin shqiptar që të paktën të bëjë të mundur kthimin e fëmijëve shqiptarë, nëse shteti ka frikë se ato janë të indoktrinuara dhe ato mund të përbëjnë rrezik për vendin (Kasapi, 2020). Rolin pasiv që gratë e Shqipërisë kanë pasur në Siri e Irak konfirmohet gjithashtu dhe nga një burrë i kthyer nga qyteti i Shkodrës, i cili për gazetarin Taulant Kopliku ka thënë se gratë shqiptare thjesht kanë ndjekur bashkëshortët e kanë ndenjur brenda në shtëpi, ndryshe nga gratë e Republikës së Kosovës, ndërmjet të cilave ka pasur disa raste që kanë qenë pjesë e të ashtuquajturës “Policia e Kalifatit” (Kopliku, 2020). Dëshmitë e deritanishme mbi gratë e fëmijët e Shqipërisë që ndodhen në

33 Intervistë me anëtarë të Këshillit të Sigurisë, Bashkia Korçë (4 Mars 2020)

34 Nga korrespondenca me Melinda Holmes, recensuese e këtij studimi, Korrik 2020.

35 Intervistë me bashkëshortin e gruas së rikthyer Mira (23 Janar 2020)

34 Shqyrtimi i përbërësve gjinorë të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri
Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Shqipëri



kampin Al-hol nxjerrin në pah dëshirën e tyre për tu kthyer në Shqipëri dhe faktin që në kampin famëkeq ato kanë ngelur krejt vetëm dhe absolutisht pa mbështetjen e shtetit shqiptar, çka është konfirmuar dhe nga autoritetet e kampit, të cilët kanë pohuar se nuk kanë qenë të kontaktuar nga autoritetet shqiptare për të bërë të mundur kthimin e këtyre personave (Bajrami, 2019).

Roli që gratë e Shqipërisë kanë luajtur në Siri e Irak është domethënës dhe deri diku përcaktues i ecursisë së procesit të integrimit të tyre në Shqipëri. Së pari, me ndryshimet në Kodin Penal që u ndërmorrën nga qeveria në vitin 2014 si pjesë e masave të marra në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm (Arbnori, 2015), shumica e grave (por edhe e meshkujve) kanë paqartësi mbi mënyrën si do trajtohen nga shteti kur të kthehen dhe druhen ndaj dënimit në bazë të kodit penal. Siç është rasti i gruas Mira, e cila ka arritur të kthehet përpara se të miratoheshin ndryshimet në kodin penal, megjithatë “largimi nga Siria ka qenë një traumë akoma më e madhe se qëndrimi atje. Përveç frikës dhe peripecive të rrugës së kthimit, në qytetin tim u ktheva me një frikë akoma dhe më të madhe, me frikën ndaj shtetit. Frika se nga momenti në moment mund të më merrnin (policia) mua dhe fëmijët, më ka bërë që të jetoj një tmerr të vërtetë”³⁶.

Për këtë qëllim, të kthyerit nga zonat e luftës është e domosdoshme që të trajtohen rast pas rasti dhe të ndahen në kategori të ndryshme, sepse “jo çdo person që ka qenë në ato zona mund të mos përbëjë rrezik, por përgjithësisht gratë shqiptare nuk kanë luajtur rol aktiv në luftime apo në rekrutim” (Dembati, 2020). Megjithatë, përgjithësisht të gjithë të intervistuarit i konsiderojnë gratë shqiptare “viktimat” dhe rekomandojnë se duhet të krijohen programe individuale për secilën prej tyre dhe fëmijët me qëllim ri-integrimit të plotë të tyre në shoqëri. Rëndësia e de-radikalizimit, ri-integrimit dhe rehabilitimit për personat e kthyer nga kampet e Sirisë është thelbësore për sigurinë dhe mirëqenien e familjeve të të rikthyerve dhe për komunitetet. Në të kundërt, lënia e tyre mënjanë nga pikëpamja socio-ekonomike, mos-trajtimi psikologjik, do të rrezikojë që këta persona të rikthehen në gjendjen e mëparëshme apo të përfshihen në aktivitete kriminale, siç është rasti i një luftëtari të rikthyer, i cili u arrestua sepse zotëronte municione luftarake, apo dhe një tjetër në Tiranë që është dënuar nën akuzën e dhunës fizike e psikologjike të ushtruar ndaj gruas së tij (Gjinishi, 2020). Sa i përket kategorisë së femrave, nga intervistat me aktorët e kontaktuar nuk rezulton që të ketë rast të ngjashëm, kjo për shkak edhe të mungesës së informacionit dhe refuzimit të institucioneve përgjegjëse për të dhënë informacion.

Vështirësitë me të cilat gratë mund të përballen në kthimin e tyre dhe perceptime mbi rrezikun që mund të shfaqin ato në Shqipëri

Vështirësitë dhe sfidat me të cilat përballen e do të përballen gratë që kanë qenë në kampet e luftës në Siri e Irak janë të mëdha dhe komplekse, të lidhura me gjendjen e tyre të rënduar psikologjike, me situatën e tyre ekonomike, nivelin e papunësisë, strehimit, edukimit, integrimit të fëmijëve dhe nivelin e pranimit shoqëror.

Mbështetja apo jo e familjes bërthamë është shumë e rëndësishme dhe vendimtare në përballimin e kthimit dhe të jetesës, siç është rasti i Mirës, i cili tregon se sa lehtësuese ka qenë për të mbështetja e dhënë nga familja: “Atë e ka ndihmuar shumë familja e saj. Ajo ishte shumë e lidhur me familjen dhe ka pasur goxha ngrohtësi nga familja e vet. Të kisha ikur unë familja ime nuk do më priste apo përkrahte ashtu. Për atë (Mirën) ka paguar vëllai i saj shumë para që të kthehej, pasi ajo ka udhëtuar e vetme për në Siri dhe është kthyer sërish vetme, pasi burri i vdiq në Siri”³⁷.

E në gjithë kontekstin e rikthimit të këtyre grave e fëmijëve, identifikimi i problematikave sërish kërkon analizë individuale psikologjike e socio-ekonomike (Dembati, 2020). Madje këto


36 Dëshmi e gruas së rikthyer Mira, intervistuar më 16 janar 2020

37 Intervistë me shoqen e ngushtë të gruas Mira, 15 Janar 2020

strategji duhet të ishin hartuar prej kohësh dhe zbatimi jo i suksesshëm i tyre dhe zhgënjimi akoma dhe më i madh që këtyre njerëzve do u vijë nga shteti e nga shoqëria, mund të bëjë që këto gra e fëmijë të bëhen potencial rreziku (Gjura, 2020). Në të kundërt, këto gra mund të bëhen modele pozitive dhe kontribuese me vlerë në edukimin e brezave dhe në parandalimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm (Gajda, 2019).

Një tjetër rrezik i madh është dhe paragjykimi shoqëror “si delja e zezë në komunitet”, çka mund të sjellë pasoja në shëndetin psikologjik, në papunësi e në mungesën e integrimit të tyre dhe të fëmijëve në shoqëri (Bajrami, 2019). Ky përjashtim shoqëror, bën që ata të mos jetojnë më në zonat e mëparshme të banimit, duke bërë që të detyrohen të migrojnë në qytete të tjera për t’i shpëtuar realitetit të qytetit ku kanë lindur e janë rritur përpara largimit në Siri e Irak, siç është rasti i të intervistuarës sonë në këtë studim, e cila shprehet:

“Isha e pafuqishme dhe e lodhur, por vetëm për fëmijët fillova të rindërtoj jetën e vetme. Me ndihmën e familjes rihapa biznesin tim të vogël në qytetin tim, por duke mbajtur peshën e paragjykitimeve të komunitetit dhe e rënduar psikologjikisht. Mendimi se mund të gjykoheja si terroriste më ka përndjekur vazhdimisht. Edhe fëmijët janë përballur me situata të vështira nga bashkëmoshatarët e tyre. Derisa pas 2-3 vitesh në këtë situatë vendosa të ndryshoj qytet”³⁸.



Graf. nr. 12

Një vajzë tjetër që aktualisht ndodhet në kampin në Siri, shprehet se ka frikë se si do të pritët në Shqipëri pas kthimit. “Fatkeqësisht, shoqëria shqiptare do ta ketë të vështirë që t’i pranojë, pasi kam vërejtur që ka shumë urrejtje ndaj personave që ndodhen në kampe, edhe për rastin e Alvin Berishës³⁹ kanë shprehur shumë urrejtje nëpërmjet komenteve në rrjetet sociale. Prandaj mendoj se shoqëria shqiptare është shumë e papërgatitur për t’i pranuar dhe duhet bërë shumë punë parapërgatitore me komunitetet (Kopliku, 2020).


Të anketuarve në këtë raport studimor iu drejtuan dy pyetje në lidhje me perceptimet e tyre nëse personat (meshkuj e femra) të kthyer nga Siria e Iraku përbëjnë kërcënim, së pari për komunitetin e tyre (grafiku nr. 12) dhe së dyti për sigurinë kombëtare në tërësi (grafiku nr. 13). Në të dyja pyetjet, personat që mendojnë se “të kthyerit” përbëjnë kërcënim janë pak a shumë në të njëjtat përqindje dhe nuk vërehet diferencë e lartë sa i përket ndarjes së tyre gjinore.

Ndërmjet dy grafikëve vërehet përqindja më e lartë është vërejtur në lidhje me rrezikun që të kthyerit paraqesin në nivelin e komunitetit krahasuar me rrezikun e mundshëm të këtyre njerëzve për sigurinë kombëtare.

38 Dëshmi e gruas Mira, intervistuar më 16 Janar 2020

39 Fëmija shqiptar i nxjerrë nga Kampi Al-Hol në Nëntor 2019


Sidoqoftë, në të dy rastet, vëzhgimet tregojnë një përqindje të lartë të të anketuarve që nuk kanë informacion mbi këtë çështje. Përqindja më e lartë është vërejtur në lidhje me rrezikun që të kthyerit paraqesin në nivelin e komunitetit (47.3%) krahasuar me rrezikun e mundshëm të këtyre njerëzve për sigurinë kombëtare (38.1%). Kjo përqindje e lartë në mesin e të anketuarve ka të bëjë me mungesën e njohurive dhe informacionit në lidhje me arsyet pse këta njerëz udhëtuan në zonat e luftës, në lidhje me rolin që ata kanë luajtur si dhe qasjen e qeverisë ndaj këtyre njerëzve.⁴⁰



Graf. nr. 13

Informacione nga komunitetet vendore tregojnë se shoqëria ende nuk i ka pranuar të rikthyerit e deritanishëm që përpara vitit 2014, sidomos në zonat rurale, prandaj shumica e tyre janë shpërngulur nëpër qytetet e mëdha, ku e kaluara e tyre nuk njihet dhe nuk paragjykohet, siç është rasti i një gruaje e cila nuk pranon të kontaktohet nga askush prej faktit se mund të shënjestrohet nga shoqëria⁴¹. Komunitetet/ qytetarët kanë shumë pak informacion si mbi personat/ gratë e komunitetit të tyre të larguara në Siri e Irak, ashtu sikurse dhe për rikthimin e tyre. Siç edhe vërehet në grafikun nr 14 vetëm 7.6 % e femrave dhe 8.7% e meshkujve të anketuar janë në dijeni që gra të komunitetit të tyre kanë udhëtuar në fushëbetejat e huaja.


Këto vlera janë pak më të larta në mesin e popullatës së grave të anketuara kur pyeten nëse kanë informacion vetëm për gratë që kanë udhëtuar në Siri / Irak (10.5% të anketuara femra dhe 8% të të anketuarve meshkuj) (shih grafikun 15).



Graf. nr. 14


40 Shënim i autorit: Kjo deklaratë bazohet në mendimet e ndara nga përfaqësuesit e shoqërisë civile gjatë diskutimeve në fokus grupe.

41 Pjesëmarrësit në këtë diskutim në fokus grup ishin përfaqësues nga Bashkia Pogradecit, mësues, nxënës të shkollave të mesme, përfaqësues të institucioneve të kujdesit shëndetësor, gazetarë, përfaqësues të komuniteteve fetare, [9 Janar 2020]



Graf. nr. 15


Nga ana tjetër, një përqindje e lartë e të anketuarve të sondazhit raportojnë se nuk kanë informacion. Për të dy pyetjet, normat janë më të larta se 60% e popullsisë së anketuar. Nga pikëpamja gjeografike e popullatës së anketuar, përqindja më e lartë e anketuesve të cilët kanë më shumë informacion mbi gra që kanë udhëtuar në Siri/Irak është ndërmjet atyre nga zonat urbane (10.7% e të anketuarve), përkundrajt 7.1% e të anketuarve në zonat rurale. Në nivelin rajonal, përqindja më e lartë e të anketuarve që kanë një informacion të tillë është nga rajonet e Dibrës (37.5% e të anketuarve), Korçës (16.1% e të anketuarve), Fier (18.2% e të anketuarve) dhe Tirana (6.3% e të anketuarve në sondazh) (grafiku nr. 16).




Graf. nr. 16



Ndërkohë, në lidhje me informacionin që të anketuarit kanë mbi gra të rikthyera në komunitetet e tyre, vetëm 2.5% e të anketuarve meshkuj dhe 4.8% e të anketuarave femra konfirmojnë se kanë informacion mbi këtë çështje (4.1% e të anketuarve nga zonat urbane dhe 3.2% nga zonat rurale). Sërish, përqindja e popullatës së anketuar që nuk ka informacion mbi këtë çështje është e lartë, mbi 70% (grafiku nr.17).



Graf. nr. 17




Graf. nr. 18


Në përgjigjet e të anketuarve mbi pyetjen nëse kanë kontaktuar me ndonjë person të kthyer nga Siria/Iraku (shiko grafiku nr 18) vërehet përqindje e lartë e tyre që kanë refuzuar të përgjigjen (74.7%-meshkuj dhe 73.8%-femra) përkundrajt atyre që kanë deklaruar që kanë kontaktuar me këta persona, përkatësisht 9.6% e tyre janë meshkuj dhe 2.9% e tyre femra.

Sa i përket nivelit të pranimit të të rikthyerve nga komuniteti, 20.7% e meshkujve të anketuarve dhe 15.7% e femrave mendojnë se janë të mirëpritur. Në nivel më të lartë përqindjeje paraqiten përgjigjet që tregojnë se këta persona nuk janë mirëpritur nga komuniteti (përkatësisht 25.2% e meshkujve dhe 18.7% e femrave) grafiku nr 19. Megjithatë, dhe në këtë rast, ndërmjet të anketuarve përqindje më të lartë zënë meshkujt dhe femrat të cilët nuk kanë aspak informacion

mbi këtë çështje. Nga pikëpamja gjeografike, pjesa më e madhe të anketuarve të cilët mendojnë se gratë e rikthyera nuk janë të mirëpritur nga komunitetet vendore vijnë nga zonat urbane (26.8%), përkundrajt 12.5% e të anketuarve nga zonat rurale (grafiku 20).



Graf. nr. 19



Graf. nr. 20


Pjesëmarrësit në fokus grupe nuk e përjashtojnë rrezikun që mund të shfaqin “të rikthyerit”, i cili mund të shfaqet në formën e nxitjes së urrejtjes, dhunës, dasisë fetare apo dhe rekrutimit të individëve të tjerë, megjithatë, gratë dhe fëmijët i konsiderojnë si një grup i marxhinalizuar, të cilët nuk do të shfaqin rrezik nëse do të ri-integrohen nga komunitetet dhe institucionet shtetërore (Gjoni, 2020). Në fakt, 59.1% e popullsisë së anketuar beson se të kthyerit mund të riintegrohen në shoqëri (shih grafikun nr. 21). Problematikë më e madhe vërehet në zonat rurale, aty ku paragjykimet dhe dallimet fetare janë shumë të theksuara, siç është rasti i një shkolle ndërmjet një fshati me banorë të besimit islam dhe një fshati tjetër me banorë të besimit katolik. Në këtë shkollë ka shpesh paragjykime ndërmjet fëmijëve për shkak të besimit fetar. Për këtë qëllim përfaqësuesve të besimit katolik dhe musliman të zonave përkatëse u është kërkuar herë pas here të kryejnë biseda me fëmijët rreth bashkëjetesës fetare. Në këto kontekste me paragjykime



të larta me bazë fetare, një fëmijë apo familje e rikthyer nga Siria do të gjendet në situatë shumë të vështirë (Valente, 2019).

Rekomandime për përfshirjen e shoqërisë në DRR

Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në vend, të angazhuar më së shumti në komunitetet vendore në lidhje me çështjen e ekstrmizmit të dhunshëm theksojnë se vëmendja nuk duhet vendosur vetëm tek personat e rikthyer me qëllim shmangjen e paragjytimeve të mundshme. Përkundrazi, mesazhet e dhëna kundër EDH dhe për riintegrimin e të rikthyerve, më së shumti përkundrejt grave dhe fëmijëve duhet të shërbejë në ndërgjegjësimin sidomos të komuniteteve vendore dhe të familjeve të të rikthyerve⁴². Këta të fundit janë shtylla kryesore për riintegrimin “Në qoftë se familja nuk i pranon, riintegrimi dështon dhe në këtë kontekst, familjet duhet të jenë aktorët që duhet të kontaktohen që në hapat e parë të hartimit të strategjive të rikthimit, si aleati i parë në punë jo vetëm i institucioneve shtetërore, por edhe i komunitetit dhe organizatave të shoqërisë civile” (Vurmo, 2019).




Graf. nr. 21

DRR kërkon një qasje shumë-aktoriale, duke filluar që nga trajtimi psikologjik i grave, fëmijëve dhe familjeve, krijimi i mundësive për punësim, përfshirja në arsim e edukim të fëmijëve, rritje e kapaciteteve të institucioneve arsimore me përballjen e këtyre kategorive të nxënësve, rritja dhe ofrimi i shërbimit psiko-social në shkollë dhe në familje si dhe ndërgjegjësimi i komunitetit dhe parapërgatitja e tij për këtë fenomen (Gajda, 2019). Përfaqësues të shoqërisë civile theksojnë se shoqëria do të frikësohet dhe se institucionet shtetërore në këtë kontekst duhet të angazhohen për të adresuar këtë çështje pa humbur kohë. Më tej, ata theksojnë se do të jetë shumë e dëmshme nëse këta persona do të lihen që të integrohen vetën në shoqëri. Për përfaqësuesit e OSHC-ve të angazhuara në çështjet për mbrojtjen e të drejtave të grave në Shqipëri thonë se “Këto gra do të vijnë e duhet të kthehen në modele pozitive për shoqërinë e duhet të shuhet paragjykimet apo frikërat që na lindin sapo dëgjojmë fjalën “ISIS”. Në qytetin e Vlorës për shembull, ka pasur shumë hebrenj, ashtu sikurse në gjithë Shqipërinë. Ne i kemi mbrojtur ata sepse e dinim se çfarë kishin kaluar. Pra, nëse ne do të dimë se çfarë kanë bërë këto gra, do tu gjendemi pranë⁴³. Në këtë

⁴² Takim diskutues “Forumi i OSHC-ve në P/EDH”, (20 shkurt 2020)

⁴³ Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Vlorës si: përfaqësues të shkollës së mesme, mësues, studentë, OSHC, përfaqësues nga strehimoret, grupe rinore, anëtarë të Këshillit të Sigurimit, Vlorë (24 Janar 2020)



kontekst, të gjitha rastet e të rikthyerve duhet të analizohen mëvetësisht, duke hartuar programe individuale DRR për secilën prej grave dhe fëmijëve të rikthyer me qëllim adresimin e saktë të nevojave të tyre. Derimë tani në Shqipëri nuk ka shembuj të mbështetjes për gratë e fëmijët e rikthyer. Dëshmi e kësaj mangësie është rasti i gruas Mira, apo edhe i një gruaje tjetër që është rikthyer me dy fëmijët e saj dhe shtatzënë, në gjendje të rënduar psikologjike dhe ekonomike dhe fëmijët ia rriste nëna e vet”⁴⁴.

Ndonëse fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri është mbajtur nën kontroll që nga viti 2014 e deri më sot (Vurmo, 2019), DRR tashmë është një sfidë shumë e afërt të cilën Shqipëria duhet ta përballojë, duke filluar sëpari nga hartimi i një strategjie dhe një plani të qartë veprimi e buxhet përkatës. Në përbërje të këto sfidave (përtej trajtimit psikologjik, ofrimin e mundësive për edukim e punësim) qasja komunitare dhe puna parapërgatitore me komunitetin do të jetë shumë e rëndësishme (Kuko, 2020). Në këtë kontekst, në çdo komuniteti duhet të ngrihen grupe pune me gjithë aktorët vendorë, i cili do të duhet të ndjekë hap pas hapi të gjithë ciklin e menaxhimit të rasteve, shoqëruar me plan individuale pune, zbatim të masave konkrete dhe monitorim rast pas rasti të çështjeve të referuara (Dembati, 2020).

Në përfundim të këtij seksioni, mund të theksojnë se frika ndaj rrezikut që mund të shfaqin gratë që ende ndodhen në kampet e Sirisë për tu kthyer, frika ndaj sjelljeve tek gratë që tashmë ia kanë arritur të kthehen dhe frika në përgjithësi e komuniteteve/qytetarëve ndaj të rikthyerve është e pranishme pikërisht prej faktit të së panjohurës së madhe që ekziston mbi këtë grup grash dhe mbi rolin që ato kanë luajtur në kampet e ISIS. Përgjithësisht aktorët pjesë e këtij raporti studimor konfirmojnë se gratë sëbashku me fëmijët janë viktima të fenomenit dhe se në kampin në Siri kanë pasur rol krejtësisht pasiv, ose të paktën deri tani nuk ka “sinjal alarmi” që mund të ketë gra që janë element aktiv në këtë kuadër. Masat që do të merren në kuadër të DRR së tyre janë ende shumë të panjohura çka bën që njëkohësisht institutionet dhe komunitetet të jenë të papërgatitura mbi qasjen që ata duhet të ndjekin. Njëkohësisht, mësohet fakti se lind nevojë urgjente për hartimin e një strategjie DRR dhe se kjo strategji duhet të jetë e udhëhequr nga një qasje shumë-aktoriale, duke punuar paralelisht dhe me përgatitjen e ndërgjegjësimin e komuniteteve vendore/qytetarëve mbi këta persona, me qëllim mire-pranimin e tyre në shoqëri dhe shmangien e paragjykimëve, të cilat kanë rezultuar të jenë të dëmshme për integrimin e grave në qytetet e tyre të lindjes. Në këtë kontekst, roli i grave të rikthyera në Shqipëri vlerësohet në të dyja anët, si pozitiv ashtu edhe negativ (pra që përbëjnë rrezik) dhe do të jenë krejtësisht të lidhura mbi suksesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve individuale për këta persona.


Ndërkohë që Shqipëria deri më tani ka refuzuar të kthejë personat që ende ndodhen në kampet e Sirisë, shtete të tjera të Ballkanit kanë marrë masa për rikthimin e tyre, përmendim këtu Kosovën, Maqedoninë, Bosnjën (Hoffman, A., Furlan, M., 2020). Përtej përpjekjeve individuale të personave në Siri apo dhe të familjeve të tyre, e vetmja mënyrë që këto gra e fëmijë mund të kthehen është nëpërmjet rrugëve zyrtare, ku përfaqësues të Ministrisë së Jashtme Shqiptare duhet të përgatisin dokumentacionin e duhur për shqiptarët që ndodhen në Siri, të cilët mund të arrijnë kufirin me Kurdistanin apo me Turqinë duke udhëtuar 4-5 pesë orë që nga kampi Al-Hol (Bajrami, 2019). Deri më tani, nga institucionet shtetërore nuk ka një përgjigje se çfarë po bëhet konkretisht me kthimin e këtyre personave, përveç konfirmimit se institucionet përkatëse po punojnë për këtë çështje (Kasapi, 2020).

44 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në Bashkinë e Tiranës si: gazetarë, studentë, profesorë, studiues dhe ekspertë të EDH Tiranë, (1 Shkurt 2020)

ROLI I MEDIAS

Pjesëmarrësit në këtë raport e konsiderojnë median si një pararojë për informimin dhe parapërgatitjen e publikut mbi gratë e fëmijët që duan të kthehen nga kampet e luftës “Shoqëria, komunitetet kanë nevojë për informacion mbi këto gra e fëmijë, promovimi i tyre si modele pozitive do të jetë në ndihmë për të shuajtur paragjykimet dhe për të rritur mirëpranimin në shoqëri”⁴⁵. Nën këtë kontekst, pjesëmarrësit në takimet diskutuese marrin shembull rastit e fëmijës shqiptar, A.B, i cili u trajtua gjerësisht nga media italiane dhe shqiptare duke theksuar se “historia e këtij djali krijoi një opinion të ri në shoqërinë shqiptare për mënyrën e trajtimit të figurave të këtyre personave, qofshin gra e fëmijë”⁴⁶.

Vitet e fundit, përdorimi i medias sociale nga grupet/individë ekstremistë si një mjet për të përhapur propagandën ekstremiste apo për të rekrutuar anëtarë është rritur ndjeshëm. Po këto mjete komunikimi janë përdorur nga ekstremistët edhe për të krijuar “kampe virtuale trajnimi” dhe për të shkëmbyer eksperiencën e njohuri (Avis, 2016). Nga ana tjetër, aktorët e angazhuar në parandalimin dhe kundërshtimin e EDH vitet e fundit kanë filluar të përdorin mediat sociale (kryesisht organizata të shoqërisë civile) por edhe median tradicionale si mjete të kundër-narrativës ekstremiste (Ramkaj, 2019). Kundërshtimi i narrativave ekstremiste përbën gjithashtu dhe një nga fushat kryesore të ndërhyrjes të Strategjisë Kombëtare Kundër EDH në Shqipëri “Kundërvënja ndaj propagandës ekstremiste, duke përkrahur vlerat demokratike”, në të cilën theksohet se do të identifikohen dhe do të përforcohen strategjitë e teknikat efektive për të luftuar kundër përhapjes së mesazheve e të gjuhës ekstremiste. Më konkretisht, shoqëria civile dhe komunitetet fetare, si dhe media do të mbështeten në hartimin e përcimin e mesazheve të fuqishme dhe historive alternative, që përkrahin tolerancën, paqen, të drejtat e njeriut e vlerat demokratike, përmes veprimeve në vijim: a)Konceptimit të fushatave të përshtatura në medien sociale, programeve radiofonike e televizive, si dhe llojeve të tjera të nismave që përhapin mesazhe kundër ekstremizmit, të cilat janë në gjendje të depërtojnë tek audiencat e synuara (National Coordinator P/CVE, Albania, 2018). Megjithatë, në këtë aspekt mungon një hartë e këtyre nismave (deri tani janë zbatuar disa projekte sporadike në këtë fushë nga organizata të shoqërisë civile dhe nga komuniteti musliman), ashtu sikurse mungon dhe analiza e monitorimi i rasteve të suksesit të tyre për të kundërshtuar narrativat ekstremiste.



Graf. nr. 22

45 Pjesëmarrësit në këtë diskutim në fokus grup përfshijnë përfaqësuesit e komuna e Pogradecit, mësime, nxënësit e shkollës së mesme, institucioni i kujdesit shëndetësor, gazetarë dhe komunitetet fetare, (19 Janar 2020).


46 Po aty

Të anketuarve në këtë studim iu drejtuan pyetje në lidhje me kanalet e komunikimit në të cilët ata ndjekin si predikuesit fetarë, ashtu edhe informacionet në përgjithësi mbi të rejtat në vend e në botë. Ndër të anketuarve praktikantë, mesatarisht 34.2% e tyre ndjekin përditë predikuesit fetarë në vendet e shenjta që frekuentojnë, ku 29.7% e këtij grupi të të anketuarve vijnë nga zonat rurale, ndërsa 20.6% janë nga zonat urbane. Ndërkohë që rreth 12.5% (meshkuj e femra) e ndjekin nëpërmjet radios e televizionit e 6.95% e tyre nëpërmjet rrjeteve online e mediave sociale. Ndërkohë, të pyetur mbi burimet në të cilët të anketuarit marrin informacion fetar, 24.75% e të anketuarve pohojnë se e marrin këtë informacion nëpërmjet frekuentimit të objekteve fetare, megjithatë përqindje e konsiderueshme përdorin mediat sociale dhe faqet fetare të internetit për të marrë këto informacione, përkatësisht 7.5% e të anketuarve përdorin mediat sociale dhe 3.8% përdorin faqet fetare të internetit (grafiku nr.22 paraqet këto të dhëna në bazë të ndarjes gjinore të të anketuarve).

Media tradicionale si TV dhe radio zënë përqindjen më të madhe si mjete informimi ndërmjet të anketuarve (grafiku nr 23), ndjekur më tej nga rrjetet sociale me rreth 44.8%. Një ndryshim i dukshëm vërehet midis zonave rurale dhe urbane ku përdorimi i gazetave, mediave sociale dhe portaleve të lajmeve në internet është më i ulët se përdorimi i të njëjtave kanale në zonat urbane. Kanalet e tjera të informacionit, të tilla si TV / Radio dhe lajmet nga njerëz të tjerë, janë më të zakonshme në mesin e komuniteteve në zonat rurale sesa në ato në ato urbane.

Raporti më i fundit “Besimi në qeverisje 2019” tregon se televizioni (57.2%) mbetet burimi mediatik më popullor për marrjen e të reja me më të fundit për aktualitetin, veçanërisht për brezat në moshë të madhe, të punësuarit apo për banorët e zonave rurale (Vrugtman L, Bino, B, 2020). Po i njëjti raport tregon se ka rritje të përdorimit të mediave sociale nga 18% në 2017 në 25% në 2019. Po ashtu, përdorimi i portaleve është rritur nga 7% në 2018 në 12.5% në 2019, kryesisht nga moshat e reja (Vrugtman L, Bino, B, 2020).


Të gjithë të intervistuarit për këtë raport studimor nga një sërë institucioneve si shtetërore dhe ato jo-shtetërore theksojnë rolin e medias në parandalimin e EDH duke e listuar atë ndër aktorët kryesorë në adresimin e fenomenit. Kryesisht vitet e fundit, media është duke u përballur me mos-besimin nga publiku, ku shpesh perceptohen si zëdhënës të aktorëve të fuqishëm ekonomikë dhe politikë (Vrugtman L, Bino, B, 2020). Apo dhe me problematika që lidhen me mungesën e kapaciteteve të gazetarëve për të trajtuar çështjet e ekstremizmit të dhunshëm dhe me mungesën e informacionit dhe të të dhënave nga ana e institucioneve shtetërore, duke i konsideruar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin si çështje me ndjeshmëri të lartë për sigurinë kombëtare e që shpesh përbën një argument nga ata e këtyre institucioneve për të mos bashkëpunuar me median (Çela, E., 2020).



Graf. nr. 23



Nga ana tjetër, media tradicionale⁴⁷, deri më tani perceptohet nga të intervistuarit si një sektor mjaft i rëndësishëm i cili deri më tani që nuk ka luajtur krejtësisht rol pozitiv në lidhje me çështjet që lidhen me EDH⁴⁸. Në këtë kontekst, ajo duhet të përmirësojë rolin e saj duke mos kërkuar sensacionin e duke mos përhapur panik, por përkundrazi duhet të luajnë rol shpjegues të fenomenit, me gjuhë sa më të thjeshtë dhe sa më afër komuniteteve (Çela, 2019). Prandaj ,organizatat të cilat janë të angazhuara me median, duhet të përqendrojnë më tepër punën e tyre jo vetëm me rritjen e kapaciteteve të gazetarëve në çështjet e ekstremizmit të dhunshëm, por edhe mbi ridimensionimin e rolit që ata kanë jo vetëm si informues të publikut por edhe si ndërgjegjëses të publikut mbi këtë fenomen dhe mbi të rikthyerit nga zonat e luftës⁴⁹.



Graf. nr. 24

Nën kontekstin e të rikthyerve, pjesëmarrës nga takimet diskutuese mendojnë që, sidomos komunitetet në zonat e vogla, rurale, të izoluara, aty ku dhe paragjykimet shoqërore janë më të larta, janë mjaft të ndikuar nga informacionet dhe argumentet që jep media në lidhje me këtë çështje. “Shoqëria nuk e përballon luftën mediatike, ose fenomeni i përditshëm mediatik e ka bërë shoqërinë “të mbrohet” përkundrazi luftëtarëve të huaj por jo vetëm kaq, nga kjo është prodhuar dhe një islamofobi e madhe dhe kjo është e dukshme në shoqërinë shqiptare” (Ramkaj, 2019). Ky fakt pohohet dhe nga bashkëshorti i gruas së rikthyer Mira, i cili shprehet se bashkëshortja e tij

47 Televizioni, radioja dhe shtypi i shkruar

48 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në Bashkinë e Tiranës si: gazetarë, studentë, profesorë, studiues dhe ekspertë të EDH Tiranë, (1 Shkurt 2020).

49 Pjesëmarrësit në këtë diskutim në fokus grup përfshijnë përfaqësuesit e komuna e Pogradecit, mësime, nxënësit e shkollës së mesme, institucioni i kujdesit shëndetësor, gazetarë dhe komunitetet fetare, (19 Janar 2020).



e ndjen paragjykimin që përjetojnë muslimanët nga segmente të caktuara të shoqërisë, përfshirë këtu dhe median⁵⁰.

Sikundër dhe u vu re në seksionet e tjera të këtij raporti studimor, shumica e të intervistuarve dhe të anketuarve konsiderojnë gratë si viktimë të fenomenit të EDH, kryesisht për shkak të manipulimit nga bashkëshortët. Si të tilla, pjesëmarrësit në takimet diskutuese janë të mendimit që media duhet t'i shohë përgjithësisht këto gra e fëmijë si "viktimë", sigurisht me ndihmesën e institucioneve për të bërë kategorizimin e tyre (në viktimë apo jo)⁵¹.

Për Shqipërinë ekzistojnë shumë pak studime e analiza në lidhje e radikalizimin online të personave dhe asnjë analizë e ngjashme për radikalizmin online të grave, edhe pse nga të dhënat e disponuara për këtë raport studimor, nuk rezulton ndonjë grua nga Shqipëria e cila ka udhëtuar për në Siri e ndikuar nga propaganda ekstremiste online. Megjithatë, analiza e bërë disa vite më parë e rreth 270 mesazheve të faqeve propagandistike online në gjuhën shqipe, ose të përkthyer në gjuhën shqipe në "Facebook" dhe platforma të tjera online, ka treguar se shqiptarët ishin një ndër grupet më të shenjëstruara për rekrutim nga ISIS, duke përdorur forma të komunikimit si mesazhe video dhe mesazhe specifike vetëm për shqiptarët, ose në raste të tjera për "Muslimanët e Ballkanit Perëndimor" (Zhilli, F., Çibuku, E., Kopliku, I., Graceni, E., Malaj, A., 2015).

50 Bashkëshorti I gruas së rikthyer X (23 Janar 2020)

51 Pjesëmarrësit në këtë diskutim në fokus grup ishin përfaqësues nga Bashkia e Pogradecit, mësues, nxënës të shkollave të mesme, institucione të kujdesit shëndetësor, gazetarë dhe komunitetet fetare, (19 Janar 2020).




QASJA INSTITUCIONALE

Dokumenti politik udhëheqës në të cilin Shqipëria adreson çështjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është Strategjia Kombëtare KEDH e miratuar në 2015 (National Coordinator P/CVE, Albania, 2018), si një përgjigje e parë e vendit përtej sektorit të sigurisë- pas ndryshimeve ligjore që u bënë në kodin penal më 2014. Si e tillë, ajo bazohet në një qasje shumë-sektoriale midis institucioneve të ndryshme duke i vënë theks arsimi, shërbimeve sociale, institucioneve të qeverisjes vendore dhe një game të gjerë aktorësh jo-qeveritarë (siç janë OShC-të dhe Komunitetet fetare) në nivel kombëtar dhe lokal (National Coordinator P/CVE, Albania, 2018). Për këtë qëllim, aktivitetet e zbatuara në kuadër të planit të veprimit të kësaj strategjie kanë arritur ndërgjegjësim masiv tek punonjësit e vijës së parë pranë institucioneve arsimore, institucioneve ligj-zbatuese, përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe të komuniteteve fetare, duke e konsideruar këtë kategori si “zëra të besueshëm” të cilët punojnë më tej në komunitetet përkatëse (Kuko, 2020).

Adresimi i rolit të grave dhe vajzave në ekstremizëm të dhunshëm është i vakët në këtë dokument politikash dhe në planin e saj të veprimit. Strategjia Kombëtare KEDH përmend fuqizimin e grave në kundërshtimin e EDH nën prioritetin e “Shtrirjes dhe angazhimit të komunitetit” duke theksuar: “Mbështetjen e iniciativave publike dhe private që krijojnë mundësi punësimi, sipërmarrje sociale dhe fuqizimin ekonomik të grave në zonat e pikave e nxehta të synuara” (National Coordinator P/CVE, Albania, 2018). Ekspertë të çështjeve gjinore në këtë raport studimor janë të mendimit se “çështjet gjinore nuk është e domosdoshme të jetë të adresuara mëvetësisht” por ato duhet të jenë çështje prioritare që adresohen në të gjitha hallkat e strategjisë (Bozo, 2019). Megjithatë, kjo strategji përmend gratë si kategori vulnerabël vetëm nën titullin e “drejtuesve social-ekonomikë”, duke lënë pas shtytës / faktorë të tjerë ndikues drejt ekstremizmit të dhunshëm (të përmendur në seksionin më sipër).

Nga të dhënat e studimeve të deritanishme për EDH në Shqipëri, rezulton se gratë janë jo thjesht një grup vulnerabël, por ato janë gjithashtu një grup i cili mund të shndërrohet në faktor parandalues shumë të fuqishëm. Ky është një element disi më pak present në strategjinë ekzistuese dhe planin e veprimit, megjithatë nëse shohim veprimet koordinuese të Qendrës Kundër EDH, vihet re një lloj ndjeshmërie në çështjet gjinore (Vurmo, 2019). Ekspertët e fushës evidentojnë rolin e grave brenda familjes në adresimin edhe të fenomeneve të tjera si ai i dhunës në familje, i cili është mjaft shqetësues për shkak edhe të kontekstit patriarkal e tradicional të familjes shqiptare (Hide, 2019) ashtu sikurse dhe si pararoja të ndalimit të largimit të meshkujve të familjes në vendet e luftës, ku këta të fundit (të radikalizuar dhe të keq-informuar në lidhje me fenë islame) duhet të marrin miratimin e familjes, veçanërisht të nënës apo gruas (Hide, 2019). Gjithashtu, gratë duhet të jenë të mirë-informuara mbi procesin e radikalizimit, pasi ato mund të jenë personat “në vijë të parë” që të dallojnë fillesat e radikalizimit⁵². Mangësi në adresimin gjinor të EDH vërehet gjithashtu edhe në mungesën e ndihmesës apo mbështetjes tek gratë që kanë humbur bashkëshortët e tyre në Siri, apo fëmijët e tyre (Gjinishi, 2020). Në këtë kontekst, analiza gjinore në një kontekst të caktuar, bazuar në diferencat ndërmjet mundësive, burimeve, sfidave që hasin mëvetësisht femrat e meshkujt, jo vetëm krijon mundësinë për të kuptuar motive përse këto dy kategori qasen drejt ekstremizmit të dhunshëm, por ndihmon gjithashtu dhe në përpilimin e programeve të duhura me në qendër aspektin gjinor (OSCE, 2019). Kështu që, pas këtij kuptimi të përgjithshëm që gratë luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe se ato duhet të fuqizohen, nuk ka asnjë analizë apo plan veprimi konkret se si gratë mund të kontribuojnë në parandalimin, kundërshtimin e këtij fenomeni, duke

52 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup përfshinin aktorë lokalë në bashkinë Elbasan si: përfaqësues nga komunitetet fetare (myslimanë, katolikë, ortodoksë, protestantë), përfaqësues nga bashkia dhe SH.B.A, këshilli bashkiak i sigurisë, psikologë, mësues, OSHC lokale që punojnë për çështje të grave dhe të rinjve, Elbasan, (20 shkurt 2020).



veshtirësuar në këtë mënyrë zbatimin e strategjisë aktuale nga këndvështrimi gjinor, jo vetëm për arsyet e mësipërme, por edhe për shkak të mungesës së buxhetit në përgjithësi të planit të veprimit (Bozo, 2019).

Përgjithësisht të intervistuarit në këtë raport janë në dijeni dhe shpesh pjesë e aktiviteteve për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë KEDH, veçanërisht pas vitit 2017, kryesisht në aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere, megjithatë, të intervistuarit dhe pjesëmarrësit në grupet diskutuese nënvizojnë faktin se “sensibilizimi dhe parandalimi janë hallka shumë të rëndësishme, por nuk janë të mjaftueshme në adresimin e plotë të fenomenit⁵³”. Në këtë kontekst, rëndësi i kushtohet nevojës për të hartuar strategji e plane veprimi me fokus de-radikalizimin, rehabilitim dhe ri-integrimin e personave të kthyer dhe atyre që do të kthehen nga kampet e luftës, veçanërisht grave dhe fëmijëve, për të cilën ende nuk ka asnjë direktivë institucionale. Vurmo shprehet se “Katër vite pas 2014–2015, fenomeni është mbajtur nën kontroll dhe ka patur vëmendjen e duhur të institucioneve ku strategjia dhe plani i veprimit e kanë luajtur si duhet rolin e vet. Megjithatë, tani ka ardhur koha të kalohet në një qasje më të qëndrueshme në adresimin e EDH, ka nevojë për të punuar më tepër brenda komuniteteve vendore si dhe ka nevojë për të adresuar fenomenin e ri të rikthyerve nga zonat e luftës (Vurmo, 2019).

Duke pasur parasysh punën e bërë deri më tani në kuadër të ekstremizmit të dhunshëm, të anketuarve dhe aktorëve shtetërorë e jo-shtetërorë iu kërkua që të vlerësojnë sipas rëndësisë institucionet përgjegjëse për adresimin e përballjen e këtij fenomeni, bazuar në eksperiencat e tyre.

Sikurse dhe vërehet nga grafiku nr.24, të anketuarit (si femrat dhe meshkujt) i japin rol më të madh familjes (66.2%) dhe autoriteteve vendore (53.4%), ndjekur më tej nga autoritetet në nivel qendror (50.05%) e nga institucionet ligj-zbatuese në nivel vendor (32.3%), në nivele pak më të ulëta më tej renditen komunitetet fetare e organizatat kombëtare, këto të fundit për shkak të mungesës së buxhetit të dedikuar për këtë çështje dhe varësisë ndaj financimeve të huaja.

Përveç institucioneve në nivel qendror që tashmë janë të përfshirë dhe në Strategjinë Kombëtare KEDH (National Coordinator P/CVE, Albania, 2018), si: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, vëmendje ndërmjet të intervistuarve dhe përfaqësuesve përgjatë takimeve diskutuese i kushtohet institucioneve dhe aktorëve jo-shtetërorë në nivel vendor. Problematikat që hasen në nivel vendor, janë të lidhura si më mungesën e kapaciteteve, ashtu edhe me bashkëpunimin e qëndrueshëm ndër-aktorial ashtu siç pohon Çela “Nëse shoqëria civile nëpërmjet projekteve dhe rrjeteve që ka jashtë vendit ka patur mundësitë të rrisë kapacitetet në adresimin e EDH, janë një sërë aktorësh të tjerë si mësuesit, punonjësit socialë, psikologët, të cilët jo vetëm mungojnë por kanë dhe mangësi në kapacitete dhe infrastrukturë (Çela, 2019). Shtirja dhe angazhimi në komunitet është gjithashtu një nga aspektet në të cilët duhet më shumë përqendrim, bazuar dhe në eksperiencat pozitive të deritanishme siç është ajo e forcimit dhe zgjerimit të rrjetit “Shkolla si qendër komunitare” objektiv edhe i Strategjisë Kombëtare KEDH dhe sidomos në zonat problematike (Vurmo, 2019). Forcimi i komuniteteve vendore merr rëndësi të veçantë ndërmjet të gjithë personave të përfshirë në studim veçanërisht në kuadër të riintegritimit dhe rehabilitimit të personave nga zonat e luftës, si dy procese që do të kryhen brenda një komuniteti të caktuar, ku vetë qytetarët/banorët dhe pushteti vendor duhet të jenë udhëheqës në orientimin e mbështetjen e familjeve të kthyer, ndërkohë që institucionet e tjera në nivel qendror dhe OSHC-të duhet të jenë mbështetëse të tyre (Gajda, 2019). Një nga studimet më të fundit mbi angazhimin e shoqërisë civile në kundërshtimin e EDH, thekson se komunitetet vendore kanë mungesë informacioni mbi fenomenin, faktorët, grupet në rrezik dhe mbi të gjitha mbi politikën e masat institucionale në dispozicion (Aliaj, 2018). Nevoja për informacion dhe

53 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Tiranës si: gazetarë, studentë, profesorë, studiues dhe ekspertë të EDH, Tiranë, (1 Shkurt 2020).

për zbatim programesh në kudër të EDH theksohet dhe nga të anketuarit në këtë studim, ku përkatësisht 70.1% e meshkujve dhe 65.8% e femrave pohojnë këtë nevojë (grafiku nr.25)

OSHC të ndryshme në vend janë angazhuar vitet e fundit në projekte mbi adresimin e EDH, megjithatë, fokusi që ato kanë pasur vetëm në disa zona të vendit, duke mos u zgjeruar në gjithë territorin, kanë bërë që rezultatet e këtyre ndërhyrjeve të mos jenë të qëndrueshme dhe afatgjata (Aliaj, 2018). Megjithatë, edhe ndërmjet OSHC-ve nga ana tjetër duhet të ketë më shumë “ndarje të detyrave” dhe koordinim dhe në këtë kontekst, të intervistuarit theksojnë rolin e përfshirjes më të madhe të OSHC-ve që tashmë punojnë me çështjet gjinore, ato që punojnë me fëmijët si dhe komunitetet fetare, mbi të gjitha sektorët e grave të të gjithë besimeve fetare në vend⁵⁴.




Graf. nr. 25

Forcimi i komuniteteve është një nga shtyllat kryesore për parandalimin e fenomenit të EDH me baza të qëndrueshme, si një ndërhyrje kjo mjaft e nevojshme në këtë moment kur Shqipëria tashmë ka kaluar “fazën e emergjencës” (për të cilën iu përgjigj Strategjia KEDH) dhe ku lind nevoja për krijimin e nismave konkrete strategjike të qëndrueshme (Vurmo, 2019). Zgjerimi i aktiviteteve ndërgjegjëse, informuese gjerësisht në Shqipëri e mbi të gjitha grupe të rëndësishme si të rinjtë, gratë, komunitetet fetare, jo domosdoshmërisht vetëm në zonat e ashtuquajtura “të nxehta”, pra aty ku ka patur raste të personave të larguar për në Siri e Irak vlerësohet me rëndësi gjithashtu dhe për nxjerrjen nga izolimi të komuniteteve, ku izolimi i tejskajshëm i disa rajoneve ka qenë gjithashtu një faktor lehtësues për nxitjen e radikalizmit dhe EDH (Hide, 2019).

Bashkëpunimi i deritanishëm i të gjithë aktorëve nga të gjithë të intervistuarit vlerësohet të ketë qenë i mirë, sidomos me OSHC-të, megjithatë më shumë vëmendje duhet t’i kushtohet ndërveprimit dhe bashkë-rendimit të ndërhyrjeve ndërmjet vetë institucioneve, kryesisht atyre në nivel vendor siç edhe shprehet Komisioneri kundër diskriminimit: “Gama e institucioneve është e gjerë, por kjo nuk është thjesht çështje përfshirjeje, është çështje koordinimi mes institucioneve dhe aktorëve të tjerë (Gajda, 2019).

Institucionet arsimore (nëpërmjet qasjes së “Shkollës qendër Komunitare”) ndërmjet të intervistuarve marrin rëndësi të veçantë në zbatimin e një sërë aktiviteteve të cilat mund të përmbledhin njëkohësisht prindër, nxënës, përfaqësues të institucioneve në nivel vendor, organizata të shoqërisë civile si dhe grupe rinore. Nga perspektiva gjinore, në këto aktivitete me

54 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Tiranës si: mësues, punonjës socialë, psikologë, avokatë, anëtarë të Forumit Kombëtar të OSHC-ve në PVE në Shqipëri. Tiranë, (20 Shkurt 2020).



këto institucione mund të mësohet puna me mësuesit (ku në Shqipëri shumica e mësuesve janë femra), me nxënësit padiskutim dhe me nënat, të cilat gjithashtu janë personat që ndjekin më shumë ecurinë e fëmijëve në shkollë⁵⁵.

Përfshirja e grave në të gjitha hallkat e adresimit të EDH, përfshirë këtu dhe sektorin e sigurisë është e domosdoshme sikurse dhe theksohet nga OSBE “Potenciali i veçantë i grave në përballjen me VERLT-in shpesh është anashkaluar dhe ndonjëherë është kufizuar tek role të stereotipizuara” (OSCE ODIHR, 2013). Në kontekstin e adresimit të çështjeve gjinore nga ana e institucioneve ligj-zbatuese, ashtu si dhe për institucionet e tjera apo dhe OSHC-të e intervistuar, kuptueshmëria mbi rolin dhe angazhimin konkret të tyre ka qenë e mirëpranuar në mënyrë të përgjithshme dhe të vagët, kryesisht e lidhur me përkufizimin që gratë bëjnë pjesë tek grupet vulnerabël, ashtu sikurse dhe të rinjtë⁵⁶. Nën qasjen e “policimit në komunitet”, tashmë një qasje me zbatim të gjerë në Shqipëri dhe në fokus gjithashtu edhe të vetë Strategjisë Kombëtare KEDH, të intervistuarit theksojnë nevojën për angazhimin nga vetë agjencitë ligj-zbatuese për të përfshirë sa më shumë gra të komuniteteve si dhe bashkëpunim më i gjerë me organizatat e shoqërisë civile të cilat punojnë me çështjet gjinore⁵⁷. Ky bashkëpunim është i rëndësishëm, si për të marrë informacion nga këto gra si pjesë e komuniteteve në kuadër të parandalimit, ashtu edhe për të rritur kapacitetet e tyre për të adresuar problematika të tjera si ajo e dhunës në familje si një nga çështjet shqetësuese në vend (Dembati, 2020). Agjencive e zbatimit të ligjit në këtë studim sugjerohet që duhet të jetë më bashkëpunuese përkundrejt identifikimit të rasteve të mundshme, bashkë-ndarimit të punëve me institucionet e tjera, sidomos me njësitë e qeverisjes vendore si dhe më e hapur në shpërndarjen e informacionit mi ecurinë e punës e të të dhënave⁵⁸. Mungesa e informacionit mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare KEDH dhe planit të saj të veprimit dhe e të dhënave jo të sakta nga një sërë institucioneve theksohet nga të gjithë të intervistuarit përfaqësues të shoqërisë civile e të medias, herë pas herë krijon konfuzion në informacion ndërmjet qytetarëve apo dhe “padije” mbi atë çka Shqipëria dhe institucionet përkatëse (si në nivel qendror e në nivel vendor) janë duke bërë për të adresuar EDH, aq më tepër DRR (Bajrami, 2019).

Në përfundim, parandalimi i EDH, kundërshtimi i këtij fenomeni, trajtimi i De-radikalizimit, Ri-integritimit dhe Rehabilitimit janë çështje të cilat mund të adresohen me sukses nëpërmjet bashkëpunimit të qëndrueshëm midis institucioneve në nivel qendror dhe sidomos atyre në nivel vendor, sëbashku me OSHC-të, komunitetet fetare e komunitetin. Deri më tani në Shqipëri, dimensionin gjinor në nismat e ndërmarra ka qenë i pranishëm nën kontekstin e “grave si grup vulnerabël”, ku ka munguar gjerësisht puna me këtë grup bazuar në plane veprimi konkrete dhe mbi të gjitha me angazhim konkret të grave dhe vajzave në një territor e komunitet të caktuar (Dembati, 2020).

Nevoja për bashkërendimin dhe bashkëpunimin afat-gjatë e të qëndrueshëm ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë lind jo vetëm për të vazhduar parandalimin e fenomenit të EDH, por, në këtë moment të caktuar të Shqipërisë, edhe për të adresuar sa më mirë çështjen e DRR, e cila tashmë është urgjente për vendin. Në këtë kontekst, adresimi i DRR kërkon bashkëpunimin

55 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë Elbasan si: përfaqësues nga komunitetet fetare (myslimanë, katolikë, ortodoksë, protestantë), përfaqësues nga bashkia dhe SH.B.A, këshilli bashkiak i sigurisë, psikologë, mësues, OShC lokale që punojnë për çështje të grave dhe të rinjve, Elbasan, (20 Shkurt 2020)

56 Intervistë me përfaqësuesin e Këshillit të sigurisë Korçë, (4 Mars 2020)

57 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Vlorës si: përfaqësues të shkollës së mesme, mësues, studentë, OShC, përfaqësues nga strehimoret, grupe rinore, anëtarë të Këshillit të Sigurimit, Vlorë, (24 Janar 2020)

58 Pjesëmarrësit në këtë fokus grup ishin aktorë lokalë në bashkinë e Tiranës si: gazetarë, studentë, profesorë, studiues dhe ekspertë të EDH. Tiranë, (1 Shkurt 2020).



e institucioneve për të plotësuar një sërë nevojash si⁵⁹:

- Mbështetje psikologjike - ku këtu merr rol shërbimi psiko-social për familjet dhe ai pranë institucioneve arsimore;
- Rritje kapacitetesh/edukim profesional dhe punësim për gratë dhe vajzat- ku duhet të përfshihen në aksione të përbashkëta institucionet e arsimit profesional, institucionet e qeverisjes vendore dhe bizneset vendase;
- Mbështetje për strehim - ku rol kryesor marrin institucionet e qeverisjes vendore;
- Mbështetje ndaj sjelljes së komunitetit- ku këtu përfshihen të gjitha institucionet shtetërore vendore përfshirë dhe OSHC e komunitetet fetare;
- Mbështetje për sigurimin e shëndetit- nëpërmjet angazhimit të qendrave shëndetësore; Sigurimi i jetës - ku këtu merr rol si agjencitë ligj-zbatuese ashtu edhe zyrat e dhunës pranë bashkive.
- Të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe sigurinë personale të të rikthyerve që do të kontribuojë në një ri-hyrje të qetë të grave dhe fëmijëve në jetën e komunitetit - si një përgjegjësi e përbashkët e disa aktorëve të tillë si agjencitë e zbatimit të ligjit, organizatat e shoqërisë civile, njësitë e qeverisjes vendore. Në mbështetje të fjalës mësipërme ndërtimi i besimit midis agjencive lokale të zbatimit të ligjit dhe komuniteteve është thelbësor për shkëmbimin e informacionit midis këtyre dy aktorëve dhe adresimin e duhur të sfidave të DRR përsa i përket grave dhe fëmijëve të kthyer.

Përveç përfshirjes së gamës së aktorëve të sipërpërmendur, vëmendje duhet t'i kushtohet dhe monitorimit të ecurisë së këtyre ndërhyrjeve dhe mbi të gjitha nxitja për të vënë në dispozicion buxhetet e duhura për zbatimin e tyre, çka shpesh është arsyeja kryesore për të krijuar mangësi të tilla⁶⁰.

59 Informacioni vijues është përmbledhur nga të gjithë përfaqësuesit në nivel vendor nga takimet diskutuese në kuadër të studimit

60 Intervistë me përfaqësuesin e Këshillit të sigurisë Korçë, (4 Mars 2020)



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport studimor synojnë që të jenë një ndihmesë për përfaqësuesit e institucioneve shtetërore në nivel qendror e vendor përveç atyre të sigurisë, udhëhequr nga qasja e angazhimit ndër-aktorial, duke përfshirë në këtë mënyrë institucione e aktorë që angazhohen me çështje si edukimi, integrimi shoqëror, mbështetja ekonomike, psikologjikë. Gjithashtu, ky raport studimor është një ndihmesë për punën e organizatave të shoqërisë civile, mediave, udhëheqësve të komuniteteve vendore, komunitetet fetare dhe komuniteteve në tërësi për të hartuar programe konkrete bazuar në nevoja dhe sfida përkatëse të zonave të caktuara me qëllim angazhimin dhe fuqizimin e grave dhe vajzave që në hartimin e këtyre programeve e deri në zbatimin e monitorimin e tyre.

Strategjia kombëtare kundër EDH në Shqipëri dhe institucioni përgjegjës për zbatimin e saj – Koordinatori Kombëtar KEDH, qysh prej vitit 2015 ka qenë udhëheqës në adresimin e këtij fenomeni, duke u bërë gjithashtu dhe një model për gjithë rajonin e Ballkanit. Gati 5 vite nga hartimi i saj, sfidat përkundrejt EDH, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera kanë ndryshuar, çka kërkon në vetvete përditësimin e ndërhyrjeve, siç është trajtimi i EDH jo vetëm si një çështje që i përket meshkujve apo dhe hartimi i planeve konkrete për de-radikalizimin, ri-integrimin e rehabilitimin e të rikthyerve, veçanërisht të grave dhe fëmijëve.

Komunitetet vendore marrin një rëndësi të veçantë në këtë kontekst. Të intervistuarit dhe të anketuarit në këtë studim theksojnë nevojën e hartimit të politikave dhe zbatimit të nismave bazuar në qasjen e “shoqërisë gjithë-përfshirëse” (a whole-society approach), si për parandalimin ashtu edhe për DRR ku vetë komunitetet vendore duhet të krijojnë “hapësira të sigurta” (safe spaces) për gratë e fëmijët e kthyer nga zonat e luftës.

Gama e institucioneve përgjegjëse si në nivel qendror e në nivel vendor është e gjerë dhe ajo çka sugjerohet gjerësisht është jo vetëm njohja e rolit të tyre, por edhe nxitja e bashkërendimit të punëve, të koordinimit ndërmjet tyre si dhe bashkëpunim strategjik që siguron qendrueshmërinë e nismave, sidomos në nivel vendor. Vendosja/ shtimi i dimensionit gjinor në planet ekzistuese P/KEDH si dhe në ato të reja në kuadër të DRR, do të shërbejë jo vetëm për parandalimin e rekrutimit, largimit të grave drejt vendeve të luftës, por di të përmirësojë vendin që ato zënë në shoqëri dhe në familje.

Ky raport studimor nxorri në pah se, ashtu sikurse dhe tek burrat, nuk ka një faktor të vetëm i cili ndikon mëvetësisht tek pjesëmarrja e grave shqiptare në zonat e konfliktit në Siri e Irak. Faktorët në nivel makro, si ato socio-ekonomikë e politikë kanë rëndësinë e tyre në shtytjen e grave për tu larguar në zonat e luftës, por jo rol dominant. Faktorë mbizotërues në këtë analizë janë normat patriarkalenë shoqëri e në familjet kryesisht në zonat rurale të vendit, mungesa e pavarësisë ekonomike të grave dhe rrjedhimisht “varësia” e tyre ndaj bashkëshortëve, apo dhe arsye personale të lidhura me ndjenjat, emocionet, strukturën e martesës dhe ideologjinë fetare. Të ndikuar nga mashtrimi, propaganda dhe Idealizmi i cili i karakterizoi jo vetëm gratë por edhe bashkëshortët për një jetë më të mirë dhe të qetë si nga ana ekonomike por edhe ideologjike, bëri që djemve luftëtarë t’iu bashkangjiten edhe trangu i familjes si gratë madje dhe prindërit, çka sërish nxjerr në pah modelin tradicional të familjes shqiptare. E fundit por jo për nga rëndësia është prania e presionit dhe paragjyqimeve shoqërore, i cili ka ndikuar tek disa prej grave të ndihen të përjashtuara në shoqëri për shkak të besimit të tyre fetar islam dhe të veshjes.

Të ndikuar nga mashtrimi, propaganda dhe idealizmi që karakterizonte jo vetëm gratë, por edhe burrat e tyre për një jetë më të mirë dhe më të qetë, si ekonomikisht dhe ideologjikisht, e gjithë familja (gruaja, fëmijët, madje edhe prindërit) u bashkuan me anëtarët e familjeve të tyre




në zonat e konfliktit. Ky fakt nxjerr në pah përsëri modelin tradicional të familjes shqiptare. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është prania e presionit dhe paragjykitimit shoqëror, i cili ka bërë që disa gra të ndihen të përjashtuara nga shoqëria për shkak të besimeve të tyre fetare islame, praktikave fetare, apo edhe menyra e veshjeve fetare. Nga ana tjetër, mungesa e një komuniteti të fortë fetar të grave brenda vete komunitetit mysliman shqiptar ka bërë që gratë të besojnë interpretimet teologjike të burrave të tyre verbërisht. Kjo është edhe për shkak të strukturës së familjes shqiptare, veçanërisht në zonat rurale ku burri merr të gjitha vendimet e rëndësishme.

Për shkak të mungesës së informacionit zyrtar publik në dispozicion dhe të dhënave nga institucionet përkatëse shtetërore, nuk është e qartë nëse, gjatë pjesëmarrjes së tyre në forcat e errëta të ISIS ose grupeve të tjera ekstremiste terroriste në Siri, gratë kanë kryer veprime terroriste. Rezulton se ato ishin thjesht amvisa të thjeshta; ata u penduan që shkuan atje - thjesht ndoqën burrat e tyre - dhe ata nuk kanë pasur asnjë informacion paraprak për realitetin atje. Ata gjithashtu duan të kthehen në vendin e tyre dhe e kanë kuptuar që kanë bërë një gabim duke shkuar atje. Kjo shprehet qartë gjatë intervistave; megjithatë, nuk përbën një argument se këto gra nuk paraqesin rrezik gjatë kthimit të tyre në shoqëri ose se ato nuk janë radikalizuar.

Nën këtë kontekst patriarkal, gratë e Shqipërisë gjerësisht paraqiten si “viktima” të bashkëshortëve të tyre si dhe jo active në kampet e Sirisë. Deri më tani, nuk ka dëshmi që të provojë që gratë që aktualisht janë në Siri (dhe ato që janë kthyer) janë të radikalizuara, përkundrazi, ato tregojnë ndjesi të thelluar pendimi dhe dëshirë të madhe për tu kthyer, të paktën fëmijët e tyre, të cilët janë akoma dhe më shumë të rrezikuar për tu radikalizuar e për tu trajnuar për akte terroriste. Masat që do të merren në kuadër të DRR së grave janë ende shumë të panjohura çka bën që njëkohësisht institucionet dhe komunitetet të jenë të papërgatitura mbi qasjen që ata duhet të ndjekin. Njëkohësisht, mësohet fakti se lind nevojë urgjente për hartimin e një strategjie DRR dhe se kjo strategji duhet të jetë e udhëhequr nga një qasje shumë-aktoriale, duke punuar paralelisht dhe me përgatitjen e ndërgjegjësimin e komuniteteve vendore/qytetarëve mbi këta persona, me qëllim mire-pranimin e tyre në shoqëri dhe shmangjen e paragjykitimeve, të cilat kanë rezultuar të jenë të dëmshme për integritimin e grave në qytetet e tyre të lindjes. Në këtë kontekst, roli i grave të rikthyera në Shqipëri vlerësohet në të dyja anët, si pozitiv ashtu edhe negativ (pra që përbëjnë rrezik) dhe do të jenë krejtësisht të lidhura mbi suksesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve individuale për këta persona.

Eksperiencat dhe dëshmitë e mbledhura për qëllim të këtij raporti studimor, të parin në Shqipëri në adresimin e çështjeve gjinore për parandalimin dhe kundërshtimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, nxorren në pah një sërë rekomandimesh drejtuar institucioneve të ndryshme shtetërore dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë si më poshtë:

1. **Institucionet shtetërore në nivel qendror**, përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare KEDH- nën koordinimin e Qendrës Rajonale KEDH, siç janë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes duhet të analizojnë dhe të vlerësojnë rolin e grave dhe vajzave në planet e tyre aktuale. Në këtë kuadër, dimensionin gjinor duhet të zërë vend të rëndësishëm duke trajtuar gratë jo vetëm si grup vulnerabël i shoqërisë ndaj fenomenit të EDH, por edhe si faktor ndryshimi. Për të bërë këtë, institucionet përkatëse duhet të marrin në analizë nevojat reale të grave dhe vajzave, faktorët udhëheqës drejt EDH si dhe angazhimin konkret të tyre.
2. Edhe pse **arsimi** në vetvete nuk del si një nga faktorët që ka ndikuar tek largimi i grave të Shqipërisë në zonat e luftës, institucionet e arsimit dhe institucioni përgjegjës në nivel qendror- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të vazhdojnë më tej trajnimet me stafet mësimore dhe prindërit, si punonjës të vijës të parë. Nga perspektiva gjinore, këto trajnime duhet të fokusohen në çështje si dhuna në familje, të drejtat e grave, barazia gjinore.

- 
3. Nga ana tjetër, **komunitetet fetare** gjithashtu duhet të bëjnë një përpjekje për të forcuar rolin e grave brenda këtyre komuniteteve. Deri më tani, gratë kanë pasur një rol mbështetës ose dytësor në bashkësitë fetare. Në të njëjtën kohë, është veçanërisht e rëndësishme të trajtohen gratë klerike dhe teologjike se si t'i qasen dhe riintegrohen në komunitetet përkatëse.
 4. **Institucionet qendrore** duhet të fillojnë të marrin në konsideratë kthimin e grave dhe fëmijëve që ende ndodhen në Siri si dhe të hartojnë politika gjithëpërfshirëse për ri-integrimin dhe rehabilitimin e tyre.
 5. **Institucionet në nivel qendror dhe vendor**, sëbashku me komunitetet fetare duhet të angazhohen në hartimin e planeve të përbashkëta për adresimin e procesit të de-radikalizimit.
 6. **Institucionet në nivel qendror e sidomos ato në nivel vendor**, së bashku me aktorë të tjerë jo-shtetërorë duhet të angazhohen në komunikimin me familjet e luftëtarëve të huaj dhe mbështetjen ndaj tyre.
 7. **Koordinatori Kombëtar KEDH**, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse dhe aktorë të shoqërisë civile duhet të nxisë ndërgjegjësimin e komuniteteve mbi rolin e grave në EDH dhe sidomos të rrisë informacionin e tyre mbi DRR.
 8. **Institucionet e qeverisjes vendore si dhe institucionet ligj-zbatuese** në nivel vendor rekomandohet se duhet të fokusohen në analizimin dhe hartimin e programeve specifike për kontekstet vendore përkatëse, duke bërë pjesë integrale të tyre nisma konkrete për gratë dhe vajzat e komuniteteve.
 9. **Media**, si një nga aktorët kryesorë në ndërgjegjësimin dhe informimin e komunitetit duhet të angazhohet më tepër në promovimin e modeleve të suksesshme në shoqëri, përfshirë dhe gratë e rikthyera, me qëllim shmangien e paragjykimëve të larta ekzistuese në komunitetet vendore.
 10. **Zgjerim i ndërhyrjeve në rang kombëtar**, jo vetëm në zona të caktuara si “zona të nxehta”, sidomos në zonat e thella rurale, aty ku izolimi i grave dhe vajzave është më i madh dhe strukturat patriarkale janë më të forta.
 11. **Institucionet përkatëse dhe komuniteti i biznesit** duhet të promovojnë nisma punësimi për fuqizimin ekonomik të grave, veçanërisht duke u përqëndruar në nivelin lokal dhe zonat rurale.

Duke pasur parasysh rolin jetësor që luajnë organizatat e shoqërisë civile me çështje gjinore, ato duhet të ndërtojnë kapacitete në metodat se si të bashkojnë çështjet e grave në kuadrin e PVE, me një fokus të veçantë në nivelin lokal. Sugjerohet gjithashtu që këto organizata, si dhe ato të tjera, duhet të zgjerojnë aktivitetet e tyre në të gjithë vendin (duke mos u përqëndruar në zonat e nxehta) dhe duhet të angazhohen më shumë në monitorimin e nivelit të zbatimit të këtyre iniciativave.



ANEKSI I

Projekti: Shqyrtimi i përbërësve gjinorë të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri
Sondazh i perceptimit publik:

Pyetësi

Përshëndetje! Unë jam _____. Jam duke punuar si anketues / e për Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Shqipëri dhe do ta vlerësojmë shumë nëse do t'u përgjigjeni disa pyetjeve në lidhje me perceptimet dhe qëndrimet fetare në Shqipëri. Pjesëmarrja është vullnetare dhe përgjigjet do të mbahen anonime. Nëse pranoni të merrni pjesë, ju mund të vendosni të mos i përgjigjeni çfarëdo pyetjeje personale, ose mund të vendosni të tërhiqeni nga pjesëmarrja kurdo që të dëshironi, pa pasur ndonjë pasojë.

I gjithë informacioni i siguruar e diskutuar gjatë bisedës sonë është rreptësisht konfidencial dhe nuk do të përdoret në asnjë rrethanë për arsye të tjera përveçse statistike e studimore.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë studim, mund të na kontaktoni në:

womancenterdca@gmail.com ose +355 68 843 3665

Të dhëna për t'u plotësuar nga anketuesi/ja


Pyetësi nr.: _____

Emri i anketuesit/es: _____

Data: _____

Bashkia: _____

Njësia administrative: _____




seksioni i: të dhëna social-demografike

- P1.** Zona e banimit
- a. Rurale
 - b. Urbane
 - c. Peri-urbane
- P2.** Gjinia
- a. Mashkull
 - b. Femër
- P3.** Mosha
- a. _____
- P4.** Arsimi
- a. Pa arsim
 - b. Shkollë fillore
 - c. Shkollë 8/9 vjeçare
 - d. Shkollë e mesme
 - e. Baçelor
 - f. Master ose më lart
 - g. Tjetër _____
- P5.** Gjendja civile
- a. Beqar/e
 - b. I/E martuar
 - c. I/E divorcuar
 - d. I/E ve
 - e. Tjetër _____
- P6.** Numri i fëmijëve (nëse ka)
- a. _____
- P7.** Statusi i punësimit
- a. Punë me kohë të plotë e paguar (punësuar ose vetë-punësuar)
 - b. Punë me kohë të pjesshme
 - c. Pa punë
 - d. Student/e
 - e. Kujdesem për shtëpinë ose fëmijët ose persona të tjerë (punë pa pagesë)
 - f. I/E sëmurë ose invalid/e i/e përhershëm/e
 - g. Pensionist/e
 - h. Tjetër _____
- P8.** Sektori i punësimit (nëse jeni në punë)
- a. Publik
 - b. Privat
 - c. Tjetër _____



- P9.** Si ndiheni për të ardhurat tuaja familjare në lidhje me nivelin e jetesës së përditshme?
- a. Jetoj rehat me të ardhurat e tanishme
 - b. E përballoj me të ardhurat e tanishme
 - c. E kam të vështirë me të ardhurat e tanishme
 - d. E kam shumë të vështirë me të ardhurat e tanishme
- P10.** A përfitoni ndihmë ekonomike?
- a. Po
 - b. Jo
 - c. Refuzim
- P11.** Sa janë të ardhurat tuaja personale mujore (neto)?
- a. Pa të ardhura
 - b. Nën 23 000 Lekë
 - c. Nga 23 001 Lekë në 50 000 Lekë
 - d. Nga 50 001 Lekë në 70 000 Lekë
 - e. Nga 70 001 Lekë në 90 000 Lekë
 - f. Mbi 90 001 Lekë
 - g. Refuzim
- P12.** A i përkisni ndonjë minoriteti?
- a. Po
 - b. Jo
 - c. Refuzim
- Q13.** Nëse po, ju lutemi të specifikoni
- a. Greke
 - b. Maqedonase
 - c. Arumune
 - d. Roma
 - e. Egjiptiane
 - f. Malazeze
 - g. Boshniake
 - h. Serbe
 - i. Bullgare
 - j. Refuzim



seksioni ii: besimi dhe feja

P1. E konsideroni veten një...?

- a. Mysliman/e
- b. Orthodhoks/e
- c. Katolik/e
- d. Bektashi/je
- e. Protestant/e
- f. Tjetër _____
- g. Refuzim
- h. Nuk e konsideroj veten t'i përkas ndonjë feje

VETËM NËSE ËSHTË PËRZGJEDHUR OPSIONI H

“Nuk e konsideroj veten t'i përkas ndonjë feje” KALONI NË PYETJEN P2

P2. Në këtë rast, a do të thonit se jeni duke kërkuar për një fe që do ishte e përshtatshme për ju?

- a. Po, jam duke kërkuar një fe të përshtatshme
- b. Jo, nuk jam duke kërkuar për ndonjë fe
- c. Nuk e di
- d. Refuzim

NË QOFTË SE I ËSHTË DHËNË PËRGJIGJE PYETJES P2

KALONI NË SEKSIONIN III

P3. A i përkisni të njejtës fe si familja juaj?

- a. Po
- b. Jo
- c. Tjetër _____
- d. Refuzim

P4. A e konsideroni veten si një person që e praktkon fenë në mënyrë aktive?

- a. Po
- b. Jo
- c. Refuzim

P5. Sa shpesh shkoni në vendet e shenjta? *(Ndihmë: si psh. xhami, kishë, tempull etj.)*

- a. Më shumë se një herë në javë
- b. Një herë në javë
- c. Një herë në muaj
- d. Vetëm në ditë festash të veçanta
- e. Rrallë
- f. Kurrë
- g. Refuzim

P6. A i dëgjoni klerikët e besimit fetare të cilit I përkisni (predikuesit) në jetën tuaj të përditshme? *(Ndihmë: në vende të shenjta si psh. xhamitë, kishat, etj.)*

- a. Po, në vendet e shenjta që frekuentoj
- b. Po, online nëpërmjet mediave sociale apo mjeteve të tjera
- c. Po, nëpërmjet TV ose radios
- d. Jo
- e. Refuzim



P7. Sa shpesh mund të thoni se luteni/faleni?

- a. Çdo ditë
- b. Më shumë se një herë në javë
- c. Një herë në javë
- d. Të paktën një herë në muaj
- e. Disa herë në vit
- f. Rrallë
- g. Kurrë
- h. Refuzim

seksioni iii: perceptimet mbi fenë

P1. Cilat janë tri problemet më të mëdha të Shqipërisë që personalisht ju shqetësojnë më shumë? (*Mund të përzgjidhni deri në tre përgjigje*)

- a. Pabarazia midis të pasurve e të varfërve
- b. Rënia e vlerave morale në shoqërinë tonë
- c. Papunësia e rinisë
- d. Cilësia e shërbimeve publike
- e. Korrupsioni
- f. Konfliktet politike
- g. Krimi
- h. Konfliktet midis grupeve fetare
- i. Ekstremizmi i dhunshëm
- j. Dhuna ndaj grave
- k. Tjetër_____

P2. Nga informoheni për të ditur se çfarë ndodh në botë? (*Mund të përzgjidhni disa përgjigje*)

- a. Transmetimet e lajmeve në TV ose radio
- b. Gazetat
- c. Rrjetet sociale
- d. Portalet e lajmeve online
- e. Njerëz të tjerë (psh: të afërm, miq, të njohur)
- f. Tjetër_____

P3. Cili burim informacioni është më i besueshmi për ju? (*Ndihmë: Që meriton t'i besohet*)

- a. Nga mediat kryesore
- b. Nga portale të veçanta
- c. Informacioni zyrtar nga organizma qeveritare
- d. Nga njerëzit me reputacion/autoritet
- e. Nga shokët/tënjohurit
- f. Tjetër_____

P4. Sa i/e informuar mund të thoni se jeni mbi fenë tuaj?

- a. Aspak i/e informuar
- b. Jo shumë i/e informuar
- c. Disi i/e informuar
- d. Shumë i/e informuar

P5. Nga cilat burime merrni informacion fetar mbi Zotin dhe fenë? (Ndihmë: Si informoheni?)

- Nuk marr ndonjë informacion mbi këtë temë
- Nga xhamia/kisha, etj., që frekuentoj
- Nga komunikimi me dijetarë/lider fetarë lokalë
- Nga faqe interneti fetare
- Nga media sociale
- Nga Librat e Shenjtë
- Tjetër_____

P6. Ju lutemi tregoni sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme.

Deklaratat a-i	Nuk jam aspak dakord	Nuk jam dakord	Jam dakord	Jam plotësisht dakord	Nuk e di/ Nuk kam mendim
6a. Feja ime është burimi kryesor i udhëheqjes morale në jetën time.	1	2	3	4	99
6b. Ka më shumë se një mënyrë të vërtetë për të interpretuar mësimet e fees sime.	1	2	3	4	99
6c. Kam mënyrën time për t'u lidhur me Zotin pa ndihmën e riteve/shërbimeve fetare.	1	2	3	4	99
6d. Të gjitha fetë mund të të shpien në parajsën e përjetshme.	1	2	3	4	99
6e. E ndaj me të tjerët besimin tim apo pikëpamjet e mia mbi Zotin.	1	2	3	4	99
6f. Është më mirë për ne nëse shoqëria jonë përbëhet nga njerëz me kombësi, fe e kultura të ndryshme.	1	2	3	4	99
6g. Njerëzit me besime fetare shumë të forta janë shpesh jo tolerantë me të tjerët.	1	2	3	4	99
6h. Do ta pranoja që një person nga një fe e ndryshme të martohej me një të afërm timin.	1	2	3	4	99
6i. Edhe nëse një ligj do të binte ndesh me parimet dhe mësimet e mia fetare, do ta zbatoja ligjin.	1	2	3	4	99

P7. Ju lutemi tregoni sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme.

Deklaratat a-f	Nuk jam aspak dakord	Nuk jam dakord	Jam dakord	Jam plotësisht dakord	Nuk e di/ Nuk kam mendim
7a. Është përgjegjësi parësore e qeverisë të kujdeset për njerëzit shumë të varfër të shoqërisë, që nuk mund të kujdesen për veten.	1	2	3	4	99
7b. Demokracia është më e mirë se çdo formë tjetër qeverisjeje.	1	2	3	4	99
7c. Qeveritë nuk duhet të ndërhyjnë në përpjekjet që cilado fe bën për të përhapur besimin e saj.	1	2	3	4	99
7d. Ligjet e një vendi nuk duhet të bazohen në asnjë fe.	1	2	3	4	99
7e. Politikat qeveritare duhet të mbështesin përhapjen e vlerave dhe besimeve fetare në vendin tonë.	1	2	3	4	99
7f. Fetë sjellin më shumë paqe se konflikt.	1	2	3	4	99



P8. Ju lutemi tregoni sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme.

Deklaratat a-e	Nuk jam aspak dakord	Nuk jam dakord	Jam dakord	Jam plotësisht dakord	Nuk e di/ Nuk kam mendim
8a. Institucionet fetare në Shqipëri i bashkojnë njerëzit dhe forcojnë lidhjet shoqërore.	1	2	3	4	99
8b. Institucionet fetare në Shqipëri fokusohen së tepërmi tek paratë dhe pushteti.	1	2	3	4	99
8c. Institucionet fetare në Shqipëri fokusohen së tepërmi tek rregullat.	1	2	3	4	99
8d. Klerikët e zones ku unë banjo kanë shumë pushtet.	1	2	3	4	99
8e. Klerikët e zones ku unë banjo fokusohen së tepërmi tek rregullat.	1	2	3	4	99

seksioni iv: perceptimet e fokusuara në pabarazinë dhe diskriminimin gjinor

P1. Ju lutemi tregoni sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme.

Deklaratat a-f	Nuk jam aspak dakord	Nuk jam dakord	Jam dakord	Jam plotësisht dakord	Nuk e di/ Nuk kam mendim
1a. Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave.	1	2	3	4	99
1b. Fetë janë zakonisht pengesë për barazinë midis burrave dhe grave.	1	2	3	4	99
1c. Fetë i trajtojnë në mënyrë të barabartë burrat dhe gratë.	1	2	3	4	99
1d. Detyra parësore e një bashkëshorti është të fitojë para.	1	2	3	4	99
1e. Dhuna në familje ndaj grave është e pranueshme në disa rrethana të caktuara.	1	2	3	4	99
1f. Kur vendet e punës janë të kufizuara, burrat duhet të kenë më shumë të drejtë për një vend pune se sa gratë.	1	2	3	4	99

seksioni v: perceptimet mbi ekstremizmin e dhunshëm

P1. Në çfarë mase ka probleme me ekstremizmin e dhunshëm (çdo lloj forme të tij) në komunitetin tuaj lokal?

- Nuk ka probleme
- Ka pak probleme
- Ka probleme deri në një farë mase
- Ka shumë probleme
- Nuk e di/Nuk kam mendim

P2. Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Pyetjet a-h	Po	Jo	Nuk e di	Refuzim
2a. A ka ndonjë grup në komunitetin tuaj lokal, që ka prirje për ekstremizmin e dhunshëm?	1	2	3	99
2b. A ka individë në komunitetin tuaj lokal, që kanë prirje për ekstremizmin e dhunshëm?	1	2	3	99
2c. A besoni se numri i individëve dhe/apo grupeve radikale në Shqipëri është në rritje?	1	2	3	99
2d. A keni dijeni për ndonjë burim në komunitetin tuaj, që u bën thirrje njerëzve që të bëhen më radikalë?	1	2	3	99

2e. A dini të ketë pasur persona nga komuniteti juaj lokal, që shkuan në fushëbetejat e huaja (Irak, Siri)? /NËSE PËRZGJIDHET OPSIONI "Jo" KALONI NË PYETJEN 2G	1	2	3	99
2f. A dini të ketë pasur gra nga komuniteti juaj lokal, që shkuan në fushëbetejat e huaja (Irak, Siri)?	1	2	3	99
2g. A dini nëse dikush që ka shkuar në fushëbetejat e huaja është kthyer në komunitetin tuaj lokal? / NËSE PËRZGJIDHET OPSIONI "Jo" KALONI NË PYETJEN P5	1	2	3	99
2h. A dini nëse ndonjë grua që ka shkuar në fushëbetejat e huaja është kthyer në komunitetin tuaj lokal?	1	2	3	99

P3. A keni pasur kontakt me një person të tillë (që *është* kthyer nga Siria, Iraku etj)?

- Po, shumë herë
- Po, një here në javë
- Po, një herë
- Refuzim

P4. Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Pyetjet a-c	Po	Jo	Nuk e di	Refuzoj
4a. A janë mirëpritur në komunitetin tuaj personat e kthyer nga vendet e luftës (Siria, Iraku, Etj)	1	2	3	99
4b. A përbëjnë kërcënim për sigurinë e komunitetit tuaj personat e kthyer nga fushëbetejat e huaja?	1	2	3	99
4c. A përbëjnë kërcënim për sigurinë në Shqipëri personat e kthyer nga fushëbetejat e huaja?	1	2	3	99

P5. Cilat mendoni se janë tri arsyet më të rëndësishme që njerëzit largohen nga Shqipëria për të luftuar në vendet e huaja? (*Mund të përzgjidhni deri në tre përgjigje*)

- Mungesa e mundësive ekonomike dhe varfëria
- Besimet fetare/ideologjike
- Probleme të shëndetit mendor
- Për aventurë
- Probleme personale/familjare
- Përfitime financiare
- Për të ndjekur familjarët / shokët e tyre
- Tjetër _____
- Nuk e di/Refuzim

P6. Cilat mendoni se janë tri arsyet më të rëndësishme që gratë janë larguar nga Shqipëria për të luftuar në vendet e huaja? (*Mund të përzgjidhni deri në tre përgjigje*)

- Mungesa e mundësive ekonomike dhe varfëria
- Besimet fetare/ideologjike
- Probleme të shëndetit mendor
- Për aventurë
- Probleme personale / familjare
- Përfitime financiare
- Për të ndjekur bashkëshortin
- Tjetër _____
- Nuk e di/Refuzim



- P7.** Çfarë do të bënit ju nëse dikush pranë jush (psh. një shok, i afërm apo familjar) interesohet për të shkuar për të luftuar në vende të huaja?
- Do të përpiquesha t'i flisja atij/asaj për ta mbajtur jashtë asaj rruge
 - Do ta mbështesja vendimin e tij/saj
 - Do ta denoncoja në polici
 - Do të informoja autoritetin fetar për këtë
 - Do të flisja me familjen e tij/saj
 - Nuk do të ndërhyja
 - Tjetër _____
 - Nuk e di/Refuzoj
- P8.** Cilat janë tri institucionet kryesore që duhet të jenë përgjegjëse *për* ri-integrimin e të kthyerve nga vendet e huaja (si Siria, Iraku) në shoqërinë shqiptare? *(Mund të përzgjidhni deri në tre përgjigje)*
- Autoritetet vendore
 - Policia vendore
 - Autoritetet qendrore
 - Familja
 - Organizatata lokale
 - Organizatata ndërkombëtare
 - Institucionet e komuniteteve fetare
 - Tjetër _____
 - Nuk e di/Refuzim
- P9.** A do ta mbështesnit rehabilitimin dhe ri-integrimin e të kthyerve nga vendet e luftës (si Siria e Iraku) në shoqërinë shqiptare?
- Po
 - Jo
 - Nuk e di
 - Refuzim
- P10.** A besoni se është i mundur ri-integrimi i të kthyerve nga vendet e luftës (si Siria e Iraku)?
- Po
 - Jo
 - Nuk e di
 - Refuzim
- P11.** A mendoni se në Shqipëri ka nevojë për zbatimin e programeve për parandalimin e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit?
- Po
 - Jo
 - Nuk e di
 - Refuzim
- P12.** A do të merrnit pjesë në këto programe për të ndihmuar në zbatimin e tyre?
- Po
 - Jo
 - Nuk e di
 - Refuzim



ANEKSI II

Pyetësor për gratë e kthyer

Tema 1: Jeta e kaluar

- Pyetja 1.1. Ju lutemi flisni për jeten tuaj. Cili është niveli juaj arsimor? Nga sa anëtarë përbëhej familja juaj nga babai? Çfarë shkolle keni mbaruar? A keni ndjekur kurse ose trajnime specifike? A flisni gjuhë të huaj?

Tema 2: Jeta e tanishme

- Pyetja 2.1. Ju lutemi përshkruani familjen tuaj. Statusi juaj aktual martesor. Nëse jeni i martuar, sa kohë jeni martuar? Kur dhe si e keni takuar partnerin tuaj të tanishëm? Cili është statusi i tij i punës? A keni ndonjë fëmijë?
- Pyetja 2.2. Cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat jeni përballur / përballeni si familje? Po në lidhje me marrëdhënien tuaj me familjen tuaj?
- Pyetja 2.3. A jeni aktualisht e punësuar? Nëse po, ku jeni e punësuar? Nëse jo, pse? Çfarë do të dëshironit të bënit?
- Pyetja 2.4. Si do ta përshkruanit marrëdhënien që keni me komunitetin ku jetoni? A kontribuoni dhe si kontribuoni për komunitetin tuaj lokal? A i ndihmoni njëri-tjetrit nëse dikush ka nevojë për ndihmë? A e ndjeni se i përkisni komunitetit lokal?

Tema 3: Feja

- Pyetja 3.1. Kur filluat të praktikoni në mënyrë aktive Islamin? Si mësuat për Islamin? A e praktikojnë prindërit tuaj islamin? Në cilat mënyra praktika e tyre ishte / është e ndryshme? Po në lidhje me burrin tuaj?
- Pyetja 3.2. Sa e informuar jeni për fenë tuaj? Nga cilat burime merrni informacion fetar? A shkoni në xhaminë pranë banimit tuaj? A përdorni internet dhe media sociale si burim informacioni?
- Pyetja 3.3. Cili mendoni se është mendimi i përgjithshëm në lidhje me praktikën tuaj të Islamit në komunitetin lokal ku jetoni? A ndikon mendimi i tyre për mënyrën tuaj të praktikimit të Islamit në ndjenjën tuaj të përkatësisë në bashkësinë lokale?
- Pyetja 3.4. Çfarë mendoni për Komunitetin Musliman në Shqipëri?

Tema 4: Mekanizmat e diskriminimit dhe kompensimit

- Pyetja 4.1. Deri ne çfarë mase jeni në gjendje të praktikoni lirisht fenë tuaj në Shqipëri? Nëse nuk jeni, pse mendoni se është arsyeja dhe si?
- Pyetja 4.2. Mendoni përsëri nëse keni qenë / ndjeheni diskriminuar për shkak të bindjeve tuaja. Në çfarë mënyrash ndodhte? A ishte diskriminim nga familja, bashkëmoshatarët,



institucionet apo të tjerët?

- Pyetja 4.3. Cfarë lloj diskriminimi tjetër keni përjetuar? Gjinorë, etnike, tjetër? Nëse po, në cilat mënyra keni trajtuar situatën? A e raportove? Nëse po, ku dhe si reagoi institucioni i referuar? Nëse jo, pse nuk e raportove?
- Pyetja 4.4. Në çmasë besoni se institucionet qeveritare mund t'ju mbrojnë nëse përballeni në situata të ngjashme?
- Pyetja 4.5. Nëse do të keni ndonjë shqetësim në lidhje me sigurinë tuaj ose nëse do të ndjeheni nën presion, çfarë do të bënit?
- Pyetja 4.6. A jeni të vetëdijshëm nëse ndonjë mekanizëm i parashikuar nga ligji mund t'ju mbështesë ose mbrojtur?
- Pyetja 4.7. Në çmasë mendoni se jeni të informuar për të drejtat tuaja, të garantuara me ligjin në Shqipëri?
- Pyetja 4.8. A jeni përballur ndonjëherë me dhunën familjare më parë? Nëse po, a e keni raportuar rastin diku?

Tema 5: Shtigjet dhe përvoja

- Pyetja 5.1. Ju kujtohet kur kenid ëgjuar për here të parë për konfliktin në Siri dhe Irak?
- Pyetja 5.2. Si u informuat për rrethanat në Siri / Irak? (Ndoshta burri, miqtë / të afërmit, anëtarët e familjes, lajmet.)
- Pyetja 5.3. Keni pasur ndonjë informacion ose i keni ditur këto vende para se të udhëtoni atje?
- Pyetja 5.4. Si u frymëzuat për here të parë për të udhëtuar në Siri / Irak?
- Pyetja 5.5. Cilat janë disa nga arsyet që ju bënë të udhëtoni atje?
- Pyetja 5.6. Kush ishte personi më me ndikim që ndikoi në vendim?
- Pyetja 5.7. Cili ishte reagimi i familjes dhe miqve tuaj pasi u komunikuat atyre vendimin për t'u larguar nga vendi? A ishin ata mbështetës?
- Pyetja 5.8. Dëshironi të shpjegoni shkurtimisht përvojën tuaj të udhëtimit?
- Pyetja 5.8.1. Kur udhëtuat dhe në cilën rrugë kaluat?
- Pyetja 5.8.2. Sa kohë zgjati udhëtimi?
- Pyetja 5.8.3. E dinit ku po shkonit?
- Pyetja 5.8.4. Çfarë prisje kur të mbërrije?
- Pyetja 5.8.5. A të kishin udhëzuar si të silleni, çfarë do të bënit dhe ku do të qëndronit?
- Pyetja 5.9. Kush ju ndihmoi në logjistikë?
- Pyetja 5.9.1. Keni udhëtuar vetëm apo me një anëtar tjetër të familjes?
- Pyetja 5.9.2. A e dini se kush do t'ju priste?
- Pyetja 5.9.3. Kush të ka pritur atje?
- Pyetja 5.9.4. Sa e kushtueshme ishte për të udhëtuar atje?
- Pyetja 5.10. Si do ta përshkruanit qëndrimin tuaj atje?



- Pyetja 5.11. Çfarë keni parë ndërsa jetonit atje?
- Pyetja 5.12. Sa kohë qëndruat atje? A i ndryshove vendet e jetesës?
- Pyetja 5.13. Gjatë qëndrimit tuaj atje, keni pasur kontakte me familjarët në Shqipëri?
- Pyetja 5.14. Si e përshkruan rolin tuaj atje? Mund të na përshkruani si i keni kaluar ditët atje?
- Pyetja 5.15. A keni qenë në kontakte dhe me grate tjera që jetojnë atje? A keni takuar ndonjë tjetër nga Shqipëria?
- Pyetja 5.16. A shkoi ndonjë nga miqtë tuaj dhe / ose anëtarët e familjes tuaj në Siri dhe Irak? A dini nëse persona të tjerë në zonën tuaj lokale po planifikojnë të shkojnë atje?

Tema 6: Kthimi dhe ri-integrimi

- Pyetja 6.1. Cilat ishin arsyet që ju bënë të ktheheni përsëri në Shqipëri?
- Pyetja 6.2. Kush ishte personi më vendimtar ose faktori / situata specifike që ndikoi në vendim? (Përvoja familjare / e keqe / sfidat financiare / jo ajo që prisnit / etj).
- Pyetja 6.3. Kush ju ndihmoi në logjistikë? A keni hasur ndonjë vështirësi?
- Pyetja 6.4. Si ishte rikthimi juaj në Shqipëri? Në çmasë u mirëpritët pas kthimit tuaj? (A keni përdorur të njëjtën rrugë për t'u rikthyer në Shqipëri?)
- Pyetja 6.5. Me kë kontaktuat pasi u kthyet në Shqipëri?
- Pyetja 6.6. A keni ndjerë ndonjëherë se komuniteti, familja apo lagjia nuk ju pranuan pas kthimit tuaj? Në çfarë mënyre?
- Pyetja 6.7. A keni marrë ndonjë mbështetje nga shteti apo institucionet e tjera qeveritare? A ju kanë kontaktuar juve? (p.sh. policia, bashkia, organizatat e shoqërisë civile etj. A ndjeheni të vërtetuar nga policia?)
- Pyetja 6.8. A ju ka mbështetur komuniteti fetarë? Nëse po, në cilat mënyra? Nëse jo, mendoni se duhet t'ju kishin?
- Pyetja 6.9. Si është jeta juaj aktuale tani dhe çfarë ju mungon? A jeni penduar që keni shkuar në Siri / Irak?
- Pyetja 6.10. A keni qenë pjesë e ndonjë programi fillestar ose ri-integrimi pas kthimit tuaj? (Kuptimi i programeve të ri-integrimit që duhet të shpjegohen me terma të thjeshtë)

A keni ndonjë koment shtesë që ne nuk kemi diskutuar tashmë?



Lista e intervistave

- Bajrami, A. *Gazetar, A2CNN* (16 Dhjetor 2019).
- Bardhi, V. *Përfaqësuese e Departamentit të Gruas, Myftinia Pogradec* (01 Nëntor 2019).
- Bozo, A. *Drejtori Ekzekutiv i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare* (26 Dhjetor 2019).
- Brucaj, S. *Përfaqësuesi i Komunitetit Mysliman Shqiptar* (3 Shkurt 2020).
- Cela, A. *Drejtor Ekzekutiv dhe Shef e Programit Evropian në Institutin Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare* (26 Dhjetor 2019).
- Gajda, R. *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, (3 Dhjetor 2019).
- Gjinishi, E. *Studiues, teolog, Komuniteti Mysliman*, (6 Qershor 2020).
- Gjoni, I. *Përfaqësues i komunitetit protestant, Elbasan* (10 Shkurt 2020).
- Gjura, V. *Përfaqësuese e Departamentit të Gruas, Myftinia Elbasan* (4 Shkurt 2020).
- Hide, E. *Pedagog, ekspert dhe studiues* (16 Dhjetor 2019).
- Kasapi, J. *Gazetar A2CNN* (4 Maj 2020).
- Kopliku, T. *Gazetar Canale 5* (6 Maj 2020).
- Kuko, R. *Zëvendëvendës Ministre, Ministria e Brendshme*, (21 Janar 2020).
- Ramkaj, A. *Kryetar i IRCC* (7 Nëntor 2019).
- Vurmo, Gj. *Drejtori i Programeve, IDM* (9 Dhjetor 2019).



Bibliografia

- Aliaj, I., 2018. CIVIL SOCIETY IN PREVENTION AND COUNTERING OF VIOLENT EXTREMISM IN ALBANIA - Mapping Report, Tirana: Center for Legal Civic Initiatives.
- Alison, L., Alison, E., Noone, G., Elntib, S., Christiansen, P., 2013. Why Tough Tactics Fail and Rapport Gets Results: Observing Rapport-Based Interpersonal Techniques (ORBIT) to Generate Useful Information from Terrorists. *Research Gate*, November.
- Arbnori, P., 2015. *Speaker of the Parliament*. Albania: EURALIU.
- Avis, W. R., 2016. The role of online/social media in countering violent extremism in East Africa, UK: GSDRC.
- Azinović, V., 2017. Between Salvation and Terror: Radicalization and the Foreign Fighter Phenomenon in the Western Balkans. Sarajevo: School of Political Sciences, University of Sarajevo.
- Bertram, L., 2015. How Could a Terrorist be De-Radicalised? *JOURNAL FOR DERADICALIZATION*.
- Bezati, V., 2019. *Reporter.al*. [Online]
Available at: <https://www.reporter.al/si-u-be-shqiperia-vendi-i-pare-ateist-ne-bote/>
- Bhulai, R., Peters, A., Nemr, C., 2016. From Policy to Action: Advancing an Integrated Approach to Women and Countering Violent Extremism. Australia, GLOBAL CENTER ON COOPERATIVE SECURITY.
- Çela, E., 2020. Media coverage and reporting of violent extremism and terrorism. Assessment of the needs of journalists, journalism students and spokespersons of public institutions”, Tirana: Albania Media Institute.
- Clayer, N., 2007. *HAL-Sciences de l’Homme et de la Société*. [Online]
Available at: <https://halshs.archives-ouvertes.fr/halshs-00189819/document>
- CODEXTER, 2016. “The roles of Women in Daesh” Discussion Paper. Strasbourg, Council of Europe.
- COMMISSION, E., 2019. COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT: Albania 2019 Report, Brussels: EUROPEAN COMMISSION.
- Council, U. N. S., 2000. *United Nations Peacemaker*. [Online]
Available at: https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/SC_ResolutionWomenPeaceSecurity_SRES1325%282000%29%28english_0.pdf
- Council, U. N. S., 2015. *S/RES/2242. (2015) – Women and peace and security*. [Online]
Available at: [https://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/RES/2242%20\(2015\)](https://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/RES/2242%20(2015))
- CVE, C., 2018. ALBANIAN NATIONAL STRATEGY COUNTERING VIOLENT EXTREMISM, Tirana: CVE CENTER.
- De Bruijn, B., Filipi, Gj., Nesturi, M., Galanxhi, E., 2015. *Quarterly Labor Force Survey*, Tirana: INSTAT.
- Dembati, B., 2020. Representative of the State Institution - Chief Police in Elbasan [Interview] (20 January 2020).



- Dufour-Genneson, S. Alam, M., 2014. *Women and Countering Violent Extremism*. Washington, DC, Georgetown Institute for Women, Peace and Security.
- Eggert, J. P., 2018. *The Roles of Women in Counter-Radicalisation and Disengagement (CRaD) Processes: Best Practices and Lessons Learned from Europe and the Arab World*, Berlin: Berghof Foundation.
- EPRS | European Parliamentary Research Service Anita Orav, R. S. & A. R., 2018. *Radicalization and counter – radicalization: A gender perspective*, s.l.: s.n.
- GCTF, 2015-2016. *GCTF* [Online]
Available at: <https://www.thegctf.org/Initiatives/Initiative-to-Address-the-Life-Cycle-of-Radicalization-to-Violence>
- Hoffman, A., Furlan, M., 2020. *“Challenges posed by returning foreign fighters,”* Washington: GW Program on Extremism.
- Holmer, G., Bauman, P., 2018. *Taking Stock “Analytic Tools for Understanding and Designing P/CVE Programs,”* Washington, DC: UNITED STATES INSTITUTE OF PEACE.
- Horgan, J., Braddock, K., 2012. *“Terrorism Studies.”* 1 ed. Oxon: Routledge.
- Horgan, J., 2008. “Deradicalization or Disengagement? A Process in Need of Clarity and a Counterterrorism Initiative in Need of Evaluation.” *Perspectives on Terrorism*, 2(Deradicalization or Disengagement?).
- ICAN, U., 2019. *Invisible Women*, New York, NY: UNDP.
- IDM, 2015. “Religious Radicalism and Violent Extremism in Albania,” Tirana: IDM.
- INSTAT, 2019. 2018 NATIONAL POPULATION SURVEY: Violence Against Women and Girls in Albania, s.l.: UN WOMEN.
- INSTAT, 2020. Gender Equality Index Report for Albania, Tirane: INSTAT.
- Jakupi, R., Kelmendi, V., 2017. *“Women in violent extremism: lessons learned from Kosovo,”* Prishtina: Kosovar Center for Security Studies.
- Kamberi, G., Çela, A., 2019. *YOUTH STUDY ALBANIA*, Berlin: Friedrich-Ebert-Stiftung e.V.
- Kelmendi, V., 2018. *“Not Just Victims: Women in Terrorism from the Western Balkans.”* [Online]
Available at: <https://extremism.gwu.edu/sites/g/files/zaxdzs2191/f/Not%20Just%20Victims-%20Women%20in%20Terrorism%20from%20the%20Western%20Balkans.pdf>
- Kursani, S., 2015. Report on the causes and consequences of the involvement of Kosovo citizens as foreign fighters in Syria and Iraq, Kosovo: KSSC.
- Md Didarul, I., 2019. “De-radicalisation of Terrorists: Theoretical Analysis and Case Studies.” *Research Gate*.
- Orav, A., Shreeves, R., Radjenovic, A., 2018. *Radicalization and counter-radicalization: A gender perspective*, s.l.: EPRS | European Parliamentary Research Service.
- OSCE ODIHR, 2013. Women and Terrorist Radicalization Final Report, Vienna: OSCE.
- OSCE, 2019. Understanding the Role of Gender in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism: Good Practices for Law Enforcement”. Vienna: OSCE.



- Raghavan, S., Balasubramaniyan, V., 2014. Evolving Role of Women in Terror Groups: Progression or Regression? *Journal of International Women's Studies*.
- Schmid, A. P., 2013. "Radicalisation, De-Radicalisation, Counter-Radicalisation: A Conceptual Discussion and Literature review, Hague: ICCT.
- Shtuni, A., 2019. "Ballkani përballë një sfide afatgjatë me luftëtarët e huaj" [Interview] (15 Aprile 2019).
- Slyomovics, S., 2012. "*Clifford Geertz in Morocco*". Reprint ed. London, United Kingdom: Taylor & Francis Ltd.
- Tare, E., 2020. Specialist of the Commissioner of the Anti-Discrimination Office [Interview] (4 March 2020).
- Turkington, R., Christien, A., 2018. Women, Deradicalization, and Rehabilitation: Lessons from an Expert Workshop, WASHINGTON D.C: GIËPS.
- Tushi, G., 2020. /*Ora News.tv*/. [Online]
Available at: <https://www.oranews.tv/article/krimi-ne-familje-sociologu-vetem-shtazet-vrasin-grate>
- UNIATF, 2018. Annual report of the United Nations inter-agency task force on engaging faith-based actors for sustainable development - e, s.l.: s.n.
- UNODC, 2019. Foreign Terrorist Fighters Manual for Southeast European Judicial Training Institutes South-Eastern Europe, Vienna: UNODC.
- Vale, G., 2019. *Women in Islamic State: From*. S.l. ICCT Policy Brief.
- Valente, D. E., 2019. *Priest of Catholic Community* [Interview] (12 December 2019).
- Vrugtman, L., Bino, B., 2019. *Opinion poll: Trust in governance*, Tirana: IDM, UNDP.
- Vurmo, Gj., Sulstarova, E., 2018. *Violent Extremism in Albania*, Tirana: IDM.
- wiiw, World Bank Group, 2019. *Western Balkans Labor Market Trends 2019*, s.l.: Jobs Gateëay in South-Eastern Europe.
- Zhilla, F., Çibuku, E., Kopliku, I., Graceni, E., Malaj, A., 2015. *Public relation online strategies of ISIS in Albania*, Tirana: ASP.
- Zhllima, E., Merkaj, E., Tahsini, I., Imami, D., Çela, E., 2016. "National study on Economic Diversification for Women Living in Albanian Rural Areas", Tirana: UN Women.



Lista e grafikëve

Grafiku nr. 1	Ndarja gjinore e të anketuarve sipas vendbanimeve (rurale / urbane)	17
Grafiku nr. 2	Grupmosha e të anketuarve sipas ndarjes gjinore	18
Grafiku nr. 3	Niveli i arsimimit të të anketuarve sipas gjinisë	18
Grafiku nr. 4	Identifikimi fetar i të anketuarve	18
Grafiku nr. 5	Çështjet më problematike që ju shqetësojnë më shumë në Shqipëri	20
Grafiku nr. 6	Ndjenja e të anketuarve për të ardhurat e tyre.	21
Grafiku nr. 7	Arsyet kryesore pse njerëzit u larguan nga Shqipëria për të luftuar në vendet e huaja.	23
Grafiku nr. 8	Arsyet kryesore pse gratë shqiptare kanë ikur në zonat e luftës.	23
Grafiku nr. 9	Në shoqërinë shqiptare ekziston barazia midis grave dhe burrave.	25
Grafiku nr. 10	Dhuna në familje është e arsyeshme në rrethana të caktuara.	26
Grafiku nr. 11	Perceptime mbi praninë e individëve / grupeve që mbështesin EDH.	30
Grafiku nr. 12	A përbëjnë ndonjë rrezik për komunitetin gratë dhe burrat nga Siria?	36
Grafiku nr. 13	A përbëjnë ndonjë rrezik për sigurinë kombëtare gratë dhe burrat nga Siria?	37
Grafiku nr. 14	A keni informacione për burra dhe gra që kanë udhëtuar në Siri / Irak?	37
Grafiku nr. 15	A njihni ndonjë grua nga komuniteti juaj që ka udhëtuar në Siri / Irak?	38
Grafiku nr. 16	A keni informacion mbi gratë nga komuniteti juaj që kanë udhëtuar në Siri / Irak?	38
Grafiku nr. 17	A keni informacion mbi gratë në komunitetin tuaj që janë kthyer nga Siria / iraku?	39
Grafiku nr. 18	A keni qenë në kontakt me ndonjë person që kthehet nga Siria / Iraku?	39
Grafiku nr. 19	A mendoni se të kthyerit janë të mirëpritur brenda komunitetit ku jetoni?	40
Grafiku nr. 20	Niveli i pranimi të të kthyerve në nivelin e komunitetit sipas ndarjes urbane / rurale.	40
Grafiku nr. 21	A besoni se të kthyerit mund të ri-integrohen?	41
Grafiku nr. 22	Nga cilat burime merrni informacione fetare rreth Zotit dhe fesë?	43
Grafiku nr. 23	Cili është kanali më i rëndësishëm që ju përdorni për të marrë informacion në lidhje me atë që ndodh në botë?	44
Grafiku nr. 24	Cilat janë aktorët më të rëndësishëm në adresimin e EDH?	45
Grafiku nr. 25	A mendoni se ka nevojë për zbatimin e programeve P / CVE në Shqipëri?	49



Shqyrtimi i përbërësve gjinorë të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri

Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, Shqipëri

Organizatë jofitimprurëse në Elbasan, Shqipëri



@womancenter2010



womancenter.al



+355 68 84 33 665



wcdc.al